



LOGOS

REVISTË SHKENCORE



Kolegji Universitar "LOGOS"
Adresa: Rr:"Dritan Hoxha"
përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi"
Tiranë, Albania

E-mail: info@kulogos.edu.al
Cel: 00355693030277
www.kulogos.edu.al

"LOGOS" REVISTË SHKENCORE

6

TIRANË, 2024

6



REVISTA LOGOS

Nr. 6

Tiranë, 2024

Bordi i Revistës

Kryeredaktor:

Prof. Dr. Ilia Ninka

Anëtarë

Prof. Dr. Artur Ribaj

Prof. Dr. Erleta Mato

Dr. Emira Spahaj

Prof. Asoc. Dr. Marsela Harizaj

Prof. Asoc. Dr. Ridvana Mediu

Prof. Asoc. Dr. Alma Barbullushi

MSc. Violeta Plepi

Redaktorë dhe korrektorë letrarë

Prof. Dr. Erleta Mato

Prof. Asoc. Dr. Marsela Harizaj

PËRMBAJTJA

SHKENCA MJEKËSORE

Dr. Dorina Minxuri, Dr (proc.). Entela Kostrista

Ndikimi i faktorëve ushqimorë në tiroiditin kronik autoimun Hashimoto 4

SHKENCA EKONOMIKE

Dr (proc.). Malvina Hysa, Prof. Asoc. Dr. Dori Risilia, Dr (proc.). Edisela Mena

Menaxhimi i riskut financiar post covid-19 22

SHKENCA EDUKIMI

Prof. Dr. Erleta Çelmeta, Prof .Asoc. Nazmi Xhomara, MSc. Jora Mato,

Filozofitë arsimore dhe praktikat pedagogjike në shkollat e mesme të përgjithshme..... 30

Mp. Besjona Dunga & Dr. Blerta Avdia

Sfida e rrjeteve profesionale mes risisë dhe traditës në sistemin parauniversitar..... 48

Prof. Asoc. Dr. Edo Sherifi

Trajtimi i fëmijëve autikë me programe të edukimit individual..... 59

SHKENCA TEOLOGJIKE

Dr (proc.). Vlash Plepi

Martesa kanonike ortodokse në raport me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi..... 75

SHKENCA GJUHËSORE

Dr (proc.). Aida Zoto

Vlerësimi i tipareve leksikore tek fëmijët shqip- dhe greqishtfolës: testi matës i fjalorit si mjet vlerësimi gjuhësor..... 100

Ph.D Nikos Mathioudakis

Le të flasim për gjuhën greke!..... 109

MSc. Theano Kostoli, Vasil Kasneci, Fatjon Postolli, Mateo Tauzi, Dorina Verushi & Prof. Dr. Anna Anastasiadis-Symeonidis

Reverse dictionary of the Albanian language 123

**NDIKIMI I FAKTORËVE USHQIMORË NË TIROIDITIN KRONIK AUTOIMUN
HASHIMOTO**

Dr. Dorina (Shuraja) Minxuri

*Departamenti i Shkencave të Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale, Fakulteti i Shkencave të
Aplikuara, Kolegji Universitar “Logos”*

Dr (proc.). Entela Kostrista

*Departamenti i Informatikës së Zbatuar dhe Statistikës, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara,
Kolegji Universitar “LOGOS”*

ABSTRAKT

Hyrje dhe Qëllimi: Tiroidi Hashimoto (HT) është një sëmundje e shpeshtë e tiroides, e karakterizuar nga prania e antittrupave kundër peroksidazës së tiroides (anti-TPO) dhe tiroglobulinës (anti-TG), duke çuar në hipotiroidizëm. Dieta mund të ndikojë në nivelet e antittrupave dhe zhvillimin e HT, megjithëse roli i saktë i saj mbetet i paqartë. Faktorë ushqimorë si seleni, vitamina D, mungesa e hekurit dhe teprica e jodit mendohet të stimulojnë auto imunitetin e tiroides. Ndërkohë, konsumimi i frutave dhe perimeve të freskëta, fibrave dhe yndyrave të shëndetshme ka një rol mbrojtës kundër HT.

Qëllimi i këtij studimi ishte vlerësimi i rolit të grupeve të ndryshme ushqimore në zhvillimin e HT.

Materialet dhe Metodat: Në këtë studim morën pjesë gjithsej 465 individë, ku 81% ishin femra (376 individë) dhe 19% ishin meshkuj (89 individë). U morën mostra gjaku nga të gjithë pjesëmarrësit dhe u analizuan për hormonin stimulues të tiroides (TSH), tiroksinën e lirë (FT4), tri-iodotironinën e lirë (FT3), antitrupat anti-TPO dhe anti-TG. Pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe: rastet (42%) me antitrupa pozitivë anti-TPO dhe/ose anti-TG dhe grupi i kontrollit (58%) me teste hormonale normale dhe antitrupa negativë. Zakonet ushqimore u

vlerësuan përmes një pyetësoi që maste frekuencën e konsumit të grupeve të ndryshme ushqimore në një bazë javore ose ditore. U krye një analizë statistikore për të identifikuar nëse kishte ndryshime të rëndësishme në modelet ushqimore midis dy grupeve.

Rezultatet: U vërejtën dallime të rëndësishme në zakonet e të ushqyerit midis individëve me (HT) dhe grupit të kontrollit për disa ushqime:

Vezët ($t = -7.355$, $p < .05$), fast food ($t = -2.585$, $p < .05$), ëmbëlsirat ($t = -3.155$, $p < .05$), bishtajoret ($t = -2.269$, $p < .05$), dhe qumështi ($t = -3.293$, $p < .05$) konsumoheshin më shpesh nga grupi HT. Ndërkohë, grupi i kontrollit konsumonte më shumë perime ($t = 7.411$, $p < .05$) dhe fruta ($t = 3.544$, $p < .05$). Nuk u gjet një lidhje midis duhan pirjes ose miellit të grurit dhe tiroidit it Hashimoto.

Diskutime dhe Përfundime: Këto gjetje sugjerojnë që një dietë e pasur me perime dhe fruta, me reduktim të konsumit të ushqimeve potencialisht inflamatorë, mund të mbështesë shëndetin dhe terapinë tek individët me (HT). Nevojitet hulumtim i mëtejshëm për të eksploruar mekanizmat fizpatologjikë dhe përfitimet terapeutike të ndryshimeve dietike në menaxhimin e sëmundjeve auto imune të tiroides.

Fjalë kyçe: *Tiroidit Hashimoto, dietë anti-inflamatore, faktorë ushqimorë*

Hyrje

Tiroiditi kronik Hashimoto (HT) është patologjia më e shpeshtë auto imune e tiroides, e karakterizuar nga infiltrimi limfocitar i gjëndrës tiroide, shkatërrimi i gradual dhe zëvendësimi me ind fibrozë. U përshkrua për herë të parë nga Hakaru Hashimoto, një kirurg japonez në shekullin e 19-të në Berlin, gjatë studimit të rasteve që ai kishte operuar. Karakteristika kryesore biokimike është prania në serum të antitropave kundër dy antigjeneve të gjëndrës tiroidë: peroksidazës së tiroides (TPO) dhe tiroglobulinës (TG). Funksioni i gjëndrës tiroidë varion nga hiperfunksioni, në funksion normal dhe në shumicën e rasteve në hipofunksion. HT është shkaku më i zakonshëm i hipotiroidizmit në vendet me mjaftueshmëri jodi. Incidenca vjetore mesatare globale është e vlerësuar të jetë 30-150 raste për 100,000 individë (Vanderpump et al., 1998). Megjithatë, incidenca ndryshon në zona të ndryshme gjeografike dhe popullata me nivele të ndryshme jodi. Në vendet me nivele të mjaftueshme jodi, hipotiroidizmi autoimunitar raportohet me 350 raste të reja për 100,000 banorë për vit në femra dhe 60 raste të reja për 100,000 banorë në meshkuj. Ndërkohë, në zonat

me mungesë jodi, raportohen 44 raste të reja për 100,000 banorë në femra dhe 12 raste të reja për 100,000 banorë në meshkuj (Wiersinga, 2018).

Prevalenca ndryshon në varësi të zonës gjeografike dhe nivelit socio-ekonomik, duke u luhatur nga 4.8% deri në 25.8% në femra dhe nga 0.9% deri në 7.9% në meshkuj. Ky problem prek kryesisht racën e bardhë dhe grup moshat e mesme, por mund të paraqitet në çdo moshë, përfshirë fëmijët (Ragusa et al., 2019).

Klinikisht, HT mund të paraqitet në disa forma siç janë struma apo gusha, tirotoksikoza kalimtare, hipotiroidizmi subklinik, hipotiroidizmi kronik dhe tiroiditi atrofik kronik. Simptomat e hipertiroidizmit të lehtë vërehen në fazën e hershme të sëmundjes. Ulja e funksionit të gjëndrës tiroide ndodh gradualisht, por në 20% të pacientëve është e pranishme që në momentin e diagnozës. Simptomat e hipotiroidizmit janë jo specifike dhe përfshijnë rënie flokësh, lëkurë të thatë, konstipacion, shtim në peshë të cilat mund të imitojnë patologji të tjera. Simptomat e hipotiroidizmit më të avancuar përfshijnë intolerancën ndaj të ftohtit, zë të ngjirur, presion në qafë, lëvizje të ngadalshme, çrregullime të ciklit menstrual, humbje të kujtesës, dhimbje artikulare dhe krampe muskulare.

Faktorë të ndryshëm ambientale dhe endogjenë mund të ndërveprojnë për të induktuar auto imunitetin në gjëndrën tiroidë tek individët që kanë predispozita gjenetike.

Me gjithë studimet e shumta, mekanizmat imunologjikë të saktë përgjegjës për zhvillimin e sëmundjes nuk janë kuptuar plotësisht.

Korrelacione të rëndësishme janë vërejtur midis HT dhe seksit femër, tepricës së jodit, mungesës së vitaminës D, mungesës së seleniumit, infeksioneve virale, medikamenteve dhe ekspozimit ndaj disa kimikateve. Ndërkohë, një dietë e pasur me perime, fruta, yndyrna të pangopura dhe fibra ka një efekt mbrojtës anti-inflamator. (Danailova et al., 2022)

Faktorët e Rrezikut dhe Roli i Ushqimit në Tiroiditin Hashimoto

Studimet familjare dhe të binjakëve kanë treguar një predispozitë të fortë gjenetike ndaj HT. Familjarët e shkallës së parë të individëve me HT kanë një rrezik më të lartë për të zhvilluar sëmundjen krahasuar me popullatën e zakonshme (Bothra et al., 2017). Antitruapat ndaj gjëndrës tiroide janë raportuar në 56% të vëllezërve dhe motrave të pacientëve me sëmundje auto imune të tiroides (Hall & Stanbury, 1967; Hollowell et al., 2002).

Nga studimet epidemiologjike, antitrukat pozitivë të tiroides hasen deri në tre herë më shpesh tek femrat se sa tek meshkujt. Studimi i madh, National Health and Nutrition Examination Survey (NHANES III), tregoi që femrat ishin pozitive për antitrukat TPO dhe TG në 7% dhe 15.2% të rasteve, përkatësisht, ndërsa meshkujt ishin pozitive vetëm në 8.7% dhe 7.6% të rasteve (Lazarus, 2011).

Në gjysmën e grave shtatzëna me anti-TPO pozitiv, tiroiditi Hashimoto përkeqësohet në periudhën pas lindjes. Ky është një fenomen që shfaqet brenda vitit të parë pas lindjes dhe zakonisht paraqitet me hipertirozë kalimtare, ndërsa hipotiroidizmi i përhershëm mund të zhvillohet në rreth një të tretën e grave (Springer et al., 2017; Nguyen CT).

HT mund të nxitet pas infeksioneve virale nga virusi i herpes simplex, virusi Epstein Barr, rubella, parvovirusi dhe virusi limfotropik i njeriut 1 (Tomer, 2010; Desailoud & Hober, 2009). Po ashtu, një numër toksinash si hidrokarburet poliaromatike dhe biphenylat polihalogjenet janë lidhur me prani të antitrupeve ndaj tiroides dhe përkeqësimin e funksionit të saj (Duntas, 2014; Boas et al., 2012; Zheng et al., 2017).

Marrja e Jodit

Marrja e jodit ka një rol të rëndësishëm në funksionimin e gjëndrës tiroide. Mungesa e rëndë e jodit shkakton zhvillimin e hipotiroidizmit, ndërsa një mungesë e lehtë deri në mesatare e jodit rrit prevalencën e gushës dhe nodujve të tiroides (Zimmermann & Boelaert, 2015; Duntas, 2008; Effraimidis & Wiersinga, 2014; Laurberg P et al., 2010). Disa studime epidemiologjike kanë treguar lidhjen mes marrjes së lartë të jodit dhe rritjes së prevalencës së tiroiditit autoimun. Shtimi i jodit në popullatat që vuajnë nga mungesa e tij përmes jodizimit të ushqimeve rrit rrezikun e zhvillimit të autoimunitetit të tiroides (Luo et al., 2014; Zaletel et al., 2011; Camargo et al., 2008; Teng X et al., 2011). Një rritje katërfish e prevalencës së antitrupeve kundër tiroides është vënë re në popullatat me mungesë jodi pas fortifikimit të ushqimeve me jod (Pedersen IB, Knudsen N et al., 2011). Mekanizmat përmes të cilave vazhdimi i marrjes së jodit të shtuar në dietë shkakton tiroidit autoimunitar nuk janë të qarta. Në individët me predispozitë gjenetike, ekspozimi ndaj jodit mund të rrisë imunitetin ndaj tiroglobulinës ose të stimulojë paraqitjen antigjenike të tiroцитеve. Në fund, sasia e tepërt e jodit mund të shkaktojë hipotiroidizëm përmes efektit të Wolff-Chaikoff në sintezën e hormoneve (Markou et al., 2001). Për të shmangur rrezikun e HT, është e rëndësishme të sigurohet marrja e jodit sipas

niveleve të rekomanduara për të arritur një përqendrim mesatar të jodit në popullatë prej 100-200 mg/L (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2007).

Seleniumi

Seleniumi është një mineral i rëndësishëm, gjurmë që është prezent në 25 selenoproteina, të cilat kanë një gamë të gjerë funksionesh nga vetitë antioksiduese dhe anti-inflamatore deri te prodhimi i hormoneve të tiroides (Ermakov, 1992). Selenoproteinat e gjetura në tirocite përfshijnë izoenzimët deiodinase, peroksidazat e glutationit, tioredoksinat dhe selenoproteinat 15, P, M dhe S. Studimet krahasuese midis popullatave me marrje të ndryshme të seleniumit tregojnë që individët me nivele më të larta të seleniumit në serum kanë më pak gjasa të kenë tiroidit autoimuni, hipotiroidizëm subklinik dhe gushë. (Ëu et al., 2015; Derumeaux et al., 2003; Rasmussen et al., 2011; Bülow Pedersen et al., 2013). Megjithatë, të dhënat mbi efektet e përdorimit të seleniumit në HT janë kontradiktore dhe jo gjitha studimet kanë treguar përfitime nga përdorimi i seleniumit në tiroiditin autoimun (van Zuuren et al., 2013; Wang et al., 2015; Duntas & Benvenga, 2014). Në këtë kontekst, nëse ka pak burime të seleniumit në dietën e pacientit, sugjerohet suplementimi me dozë të ulët 50-100 mcg/ditë. Seleniumi është toksik për trupin kur merret në sasi të tepërta, dhe praktika ka treguar që edhe në doza normale si 200 mcg/dite është i lidhur me dermatit, alopeci dhe karcinomën e qelizave skuamoze (Stranges et al., 2007).

Vitamina D

Injektimi i dozave të larta të vitaminës D tek minjtë përmirësoi strukturën e gjëndrës tiroide dhe riktheu balancën midis citokinave Th1/Th2 (Fournier et al., 1990). Një studim tek pacientët me tiroidit Hashimoto tregoi se nivelet e ulëta të vitaminës D 25 OH ishin të lidhura me praninë e antitropave TPO. Pas suplementimit me Vitaminë D3 për një periudhë 4-mujore, nivelet e antitropave anti-TPO u ulën ndjeshëm (Liontiris & Mazokopakis, 2017). Ndërkohë, studime të tjera raportojnë se përqendrimi i vitaminës D 25(OH) në serum të pacientëve me HT nuk ishte më i ulët se në grupin e kontrollit (D'Aurizio et al., 2015). Kundërshtitë në rezultatet e këtyre studimeve mund të atribuohen ndryshimeve në rajonin gjeografik, ekspozimin ndaj diellit, etnicitetin, indeksin e masës trupore dhe metodave laboratorike të përdorura

Mungesa e hekurit

Nga studimet e kryera, pacientët me HT kanë nivele më të ulëta hekuri në gjak krahasuar me individët e shëndetshëm. HT shpesh shoqërohet me sëmundje auto imune të tjera, dhe një pjesë e konsiderueshme e pacientëve me HT kanë celiaki ose gastrit auto imun, faktorë që kontribuojnë drejtpërdrejt në uljen e absorbimit të hekurit nga trakti gastrointestinal. (Fisher et al., 2008; Checchi et al., 2010; Tozzoli et al., 2010). Nga ana tjetër, mungesa e hekurit ndikon në metabolizmin e gjëndrës tiroidë pasi ul aktivitetin e enzimës që varet nga hekuri, peroksidazës së tiroides (TPO). Si rezultat, prodhimi i hormoneve të tiroides T4 dhe T3 zvogëlohet. (Beard et al., 1998; Hess et al., 2002)

Dieta ushqimore dhe disbioza e zorrëve

Ushqimet e pasura me antioksidantë kanë efekte anti-inflamatore dhe ndihmojnë në ruajtjen e funksionit të zorrëve, ndërsa ushqimet pro-inflamatore si sheqernat e thjeshta, ushqimet e përpunuara, kripa e shtuar, ushqimet e skuqura, pijet me gaz dhe alkooli nxitin lirimin e mediatorëve inflamatorë, duke favorizuar patologjitë e lidhura me inflamacionin kronik si sindroma metabolike, diabeti, sëmundjet auto imune, kanceri, etj. Dëmtimi i florës mikrobiologjike normale të zorrëve, e njohur ndryshe si disbioza, ndikohet nga inflamacioni kronik si dhe përdorimi i antibiotikëve, toksinave dhe profili gjenetik i individëve. Disbioza mund të çojë në rritjen e permeabilitetit të zorrëve, duke favorizuar shpërthimin ose përparimin e HT. Dëmtimi i mikrobiotës i influencuar nga stili i jetesës mendohet të jetë një nga faktorët që nxit përgjigjen auto imune dhe tiroiditin Hashimoto (Cayres et al., 2021).

METODOLOGJIA

Në këtë studim morën pjesë gjithsej 465 individë, ku 81% ishin femra (376 individë) dhe 19% ishin meshkuj (89 individë). Marrja e gjakut u krye përmes venipunkturës me sistemin vacutainer në tuba me xhel 5 cc. Serumet u analizuan me metodën e elektrokemiluminescencës (ECLIA) për hormonin stimulues të tiroides (TSH), tiroksinën e lirë (FT4), triiodotironinën e lirë (FT3), antitrukat anti-TPO dhe anti-TG.

Pjesëmarrësit u ndanë në dy grupe: rastet (42%) me antitruka pozitivë anti-TPO dhe/ose anti-TG dhe grupi i kontrollit (58%) me teste hormonale normale dhe antitruka negativë. Zakonet ushqimore u vlerësuan përmes një pyetësoi që maste frekuencën e konsumit të grupeve të

ndryshme ushqimore në një bazë javore ose ditore. Grupet ushqimore të përfshira në pyetësor ishin:

- Peshk dhe ushqime deti
- Mish
- Bishtajore (fasule, bizele, qiqra, etj.)
- Vezë
- Fruta
- Perime
- Fruta të thata (arrat, bajamet, etj.)
- Produkte qumështi dhe yndyrna shtazore (qumësht, kos, djathë, gjalpë)
- Bukë, produkte brumi
- Ushqime të përpunuara dhe të paketuara (snacks)
- Ëmbëlsira

Frekuenca e konsumit për ushqime të ndryshme ishte:

- Një herë në ditë
- Një herë në javë
- Rrallë
- Kurrë

Pyetësi nuk ishte i destinuar për të përcaktuar sasinë ditore të konsumimit të grupeve të ndryshme ushqimore. Megjithatë, klasifikimi i grupeve ushqimore u bë bazuar në karakteristikat e tyre ushqimore dhe praninë e elementeve që ndikojnë në funksionin e tiroides, si jodi, seleni, vitamina D dhe hekuri. Për shembull, peshku dhe ushqimet e detit janë burime të jodit. Arrat, ushqimet e detit dhe mishi janë burime të seleniumit. Vitamina D është e pranishme në disa lloje peshqish, vezë, qumësht të pasuruar dhe drithëra. Mishi, frutat e thata, bishtajoret dhe perimet e gjelbra janë burime hekuri. Ndërkohë, ushqimet e përpunuara, ëmbëlsirat dhe produktet e bukës nuk janë të pasura me mikronutrientët e përmendur më lart dhe, për më tepër, janë të njohura për efektin e tyre pro-inflamator. Ushqime të tjera si soja dhe bishtajat mund të kenë një efekt pengues në sintezën e hormoneve të tiroides. Ndërkohë, perimet dhe frutat kanë veti antioksiduese dhe anti-inflamatore (Babiker et al., 2020; Hess & Zimmermann, 2004). Duhan pirja gjithashtu u përfshi në pyetësor bazuar në të dhënat e literaturës ku disa studime tregojnë një lidhje inverse midis duhan pirjes dhe HT (Ëiersinga, 2013).

Përpunimi dhe analiza e të dhënave statistikore

Të dhënat nga pyetësit dhe ekzaminimet laboratorike u mbledhën në një bazë të dhënash sipas kategorive të përcaktuara paraprakisht dhe më pas u transferuan në SPSS 26 për të kryer analizën statistikore. Mesatarja, devijimi standard, minimumi, maksimumi, frekuenca dhe përqindja u përdorën për të paraqitur një pamje të rezultateve të pyetësit në formë tabele dhe grafike. Përcaktimi i dallimeve midis dy grupeve u bë duke përdorur testin χ^2 dhe analizën e variancës (ANOVA). U llogarit koeficienti i korrelacionit të Pearson për të parë lidhjet midis variabëlve të ndryshëm. Analiza e regresionit logjistik u përdor për të përcaktuar nëse kishte një lidhje të rëndësishme midis pranisë së tiroidit Hashimoto (HT) dhe konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve.

REZULTATET

Nga analiza e të dhënave, u gjet se në popullatën shqiptare të studiuar, grupet e ushqimeve që konsumoheshin më pak ishin peshku dhe produktet e detit, me një frekuencë mesatare prej **1.3 herë në javë**. Nga ana tjetër, **ushqimet e përpunuara (snack)** dhe **vezët** konsumoheshin më shpesh, me një mesatare prej **3 herë në javë**, siç tregohet në **Tabelën 1**.

Tabela 1: Frekuenca e konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve (herë/në javë)

Grupi ushqimor Stand	N	Minimum	Maksimum	Mesatare	Dev.
Peshk dhe produkte deti/javë	465	0	4	1.23	.745
Bishtajore/javë	465	0	3	1.39	.818
Fruta të thata/ javë	465	0	4	1.93	.912
Embëlsira/ javë	465	0	7	2.39	1.675
Mish/ javë	465	1	5	2.95	.773
Snacks/ javë	465	0	7	3.04	1.340

Tabela paraqet të dhëna për grupet e ushqimeve që konsumoheshin disa herë në javë. Grupet e ushqimeve janë renditur sipas konsumimit mesatar në javë, nga grupi më pak i konsumuar (**peshk dhe ushqime deti**, $M = 1.23$, $ds = 0.745$) deri tek grupi më shpesh i konsumuar (**vezë**, $M = 3.32$, $ds = 0.866$). Kjo analizë shërben si bazë për të kuptuar zakonet ushqimore të

popullsisë së studiuar, të cilat mund të ofrojnë njohuri për lidhjet e mundshme midis konsumimit të ushqimit dhe prevalencës së tiroidit Hashimoto.

Ndër grupet e ushqimeve të konsumuar çdo ditë, **buka dhe produktet e brumit** kishin frekuencën më të lartë të konsumit, **2.8 herë/në ditë**, siç shihet në **Tabelën 2**.

Tabela 2: Frekuenca e konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve (herë/në ditë)

Grupi ushqimor	N	Minimum	Maksimum	Mean	Dev. Standard
Fruta/ditë	465	1	4	2.02	.782
Bulmet/ ditë	465	0	4	2.08	.765
Perime/ ditë	465	1	4	2.35	.758
Bukë dhe produkte brumi/ ditë	465	1	6	2.81	.942


Tabela paraqet të dhëna për produktet ushqimore që konsumohen herë/në ditë. Grupet e ushqimeve janë renditur sipas konsumimit mesatar, nga grupi më pak i konsumuar, **frutat** ($M = 2.02$, $ds = 0.782$), deri te grupi më shpesh i konsumuar, **bukë dhe produkte brumi** ($M = 2.81$, $ds = 0.942$).

Tabela paraqet një krahasim të frekuencës së konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve dhe ndihmon për të kuptuar zakonet ushqimore të popullsisë së studiuar. Vihet re se buka dhe produktet e brumit konsumohen më shpesh se grupet e tjera të ushqimeve, siç janë frutat, perimet dhe mishi, në popullatën e studiuar. Ky konsum i lartë mund të pasqyrojë zakone dhe preferenca të zakonshme të të ushqyerit, të cilat mund të kenë pasoja për marrjen e lëndëve ushqyese, veçanërisht në lidhje me shëndetin e gjëndrës tiroide. Konsumi i tepërt i bukës dhe produkteve të brumit, veçanërisht atyre me karbohidrate të rafinuara, mund të ketë efekte pro-inflamatore, të cilat përkeqësojnë tiroiditin Hashimoto. Prandaj, moderimi dhe balancimi i konsumit të këtyre ushqimeve është i rëndësishëm për menaxhimin e patologjive auto imune të tiroides dhe ruajtjen e shëndetit në përgjithësi.

Frekuenca e konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve u krahasua mes dy grupeve: HT dhe kontroll.

Grafiku 1 paraqet frekuencën e konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve në dy grupet e studimit: individët me HT dhe ata të kontrollit. Frekuenca e konsumimit është shprehur si vlera mesatare për secilin grup ushqimor në herë/në ditë ose herë/në javë.

Ky grafik mundëson një paraqitje të qartë të ndryshimeve të konsumimit të ushqimeve midis dy grupeve dhe ndihmon në identifikimin e ndonjë modeli ose tendence të mundshme që mund të lidhet me zhvillimin e tiroidit Hashimoto.



Grafiku 1: Ndryshimi në shpeshtësinë mesatare të konsumit të grupeve të ndryshme ushqimore midis individëve me HT dhe kontrolleve

Duke marrë si referencë kriterin e sinjifikancës ($p \leq .05$) pas analizës së të dhënave, rezultoi se kishte dallime të rëndësishme në frekuencën e konsumit të grupeve të ndryshme të ushqimeve midis rasteve (HT) dhe kontrolleve (për perimet ($t = 7.411$, $p \leq .05$) dhe frutat ($t = 3.544$, $p \leq .05$)), të cilat u konsumoheshin më shpesh nga individët në grupin e kontrollit krahasuar me individët me tiroidit Hashimoto. Po ashtu, dallime të rëndësishme midis grupeve u vërejtën edhe në konsumimin e vezëve ($t = -7.355$, $p \leq .05$), snacks ($t = -2.585$, $p \leq .05$), ëmbëlsirave ($t = -3.155$, $p \leq .05$), bishtajoreve ($t = -2.269$, $p \leq .05$) dhe produkteve të qumështit ($t = -3.293$, $p \leq .05$), të cilat konsumoheshin më shpesh nga individët me tiroidit Hashimoto krahasuar me grupin e kontrollit, siç paraqitet në **Tabelën 3**.

Tabela 3. T-test për dallimet në mesataren e frekuencës së konsumit të grupeve të ndryshme të ushqimeve midis individëve me Hashimoto dhe grupit kontroll. Ushqimet që rezultuan me dallim statistikisht të rëndësishëm midis rasteve (individët HT) dhe grupit të kontrollit janë të shënuara me ngjyrë të verdhë.

Ushqimi	Kontrolle (N = 240)		Individë me HT (N = 187)		Diferenca mes rasteve HT dhe kontrolle ve	Diferenca mes rasteve HT dhe kontrolle ve	HT Kundrejt Kontrolleve
	M	ds	M	ds	T	P	
Peshk dhe produkte deti/javë	1.18	0.68	1.29	0.81	-1.476	.141	
Fruta të thata/javë	1.91	0.93	1.96	0.88	-0.509	.611	
Perime/ditë	2.57	0.67	2.05	0.76	7.411	.000	HT < Kontrolle
Fruta/ditë	2.14	0.81	1.87	0.73	3.544	.000	HT < Kontrolle
Mish/javë	2.90	0.87	3.00	0.62	-1.328	.185	
Vezë/javë	3.07	0.87	3.65	0.74	-7.355	.000	HT > Kontrolle
Snacks/javë	2.89	1.21	3.24	1.47	-2.585	.010	HT > Kontrolle
Bukë dhe prodhime brumi/javë	2.76	0.92	2.88	0.96	-1.293	.197	
Ëmbëlsira/javë	2.16	1.44	2.69	1.90	-3.155	.002	HT > Kontrolle
Bishtajorë/javë	1.31	0.78	1.49	0.85	-2.269	.024	HT > Kontrolle
Bulmet/ditë	1.97	0.73	2.22	0.79	-3.293	.001	HT > Kontrolle

Analiza e regresionit logjistik univariante: Marrëdhënia midis Konsumimit të Ushqimeve dhe HT

Analiza e regresionit logjistik univariante u realizua për të përcaktuar nëse kishte një lidhje të rëndësishme midis pranisë së tiroidit Hashimoto (HT) dhe konsumimit të grupeve të ndryshme të ushqimeve, duke llogaritur raportet e mundësive (OR) për secilin. Rezultatet e analizës së të dhënave janë paraqitur në Tabelën 4.

Tabela 4: Raportet e Mundësive (Odds ratio OR) për Grupet Ushqimore dhe tiroiditin Hashimoto

Grupi ushqimor	P	OR	95% C.I. për OR	
			I sipërm	I poshtëm
Peshk dhe produkte deti/javë	.13 3	1.21 8	.942	1.576
Fruta të thata/javë	.61 0	1.05 6	.856	1.303
Perime/ditë	.00 0	.375	.281	.500
Fruta/ditë	.00 1	.634	.490	.821
Mish/javë	.20 3	1.17 6	.917	1.509
Vezë/javë	.00 0	2.46 9	1.885	3.233
Snacks/javë	.00 9	1.21 4	1.049	1.404
Bukë dhe prodhime brumi/javë	.19 7	1.14 4	.933	1.403
Ëmbëlsira/javë	.00 1	1.20 9	1.076	1.359
Bishtajorë/javë	.02 3	1.31 6	1.038	1.669
Bulmet/ditë	.00 1	1.54 2	1.187	2.004

- **Perimet:** Pacientët që konsumojnë perime kanë 62.5% më pak mundësi të preken nga HT (OR = 0.375), krahasuar me grupin e kontrollit .
- **Frutat:** Pacientët që konsumojnë fruta kanë 36.6% më pak mundësi të preken nga HT (OR = 0.634) krahasuar me grupin e kontrollit.
- **Vezët:** Pacientët që konsumojnë vezë kanë 2.5 herë më shumë mundësi (OR = 2.469) të preken nga HT krahasuar me grupin e kontrollit.
- **Fast Food :** Pacientët që konsumojnë fast food kanë 1.2 herë më shumë mundësi (OR = 1.214) të preken nga HT krahasuar me grupin e kontrollit.

- **Bishtajore:** Pacientët që konsumojnë legume kanë 1.3 herë më shumë mundësi (OR = 1.316) të preken nga HT krahasuar me grupin e kontrollit.
- **Prodhime qumështi:** Pacientët që konsumojnë produkte qumështi kanë 1.54 herë më shumë mundësi (OR = 1.542) të preken nga HT krahasuar me grupin e kontrollit.

Këto rezultate tregojnë se një dietë e pasur me perime dhe fruta mund të ofrojë një efekt mbrojtës kundër HT, ndërsa konsumimi i vezëve, fast food, bishtajoreve dhe bulmetit mund të rrisë mundësinë e zhvillimit të sëmundjes.

DISKUTIME DHE PËRFUNDIME

Faktorët ushqimorë si seleni, vitamina D, mungesa e hekurit dhe teprica e jodit mendohet të stimulojnë auto imunitetin e tiroides. Ndërkohë, konsumimi i frutave dhe perimeve të freskëta, fibrave dhe yndyrnave të shëndetshme ka një rol mbrojtës ndaj HT. Disa specialistë rekomandojnë eliminimin e laktozës për shkak të ndërveprimit të saj me absorbimin e levotiroksinës ose intolerancës ndaj laktozës, për të cilën pacientët me HT mund të jenë më të prirur. Po ashtu, ka sugjerime për eliminimin e glutenit për shkak të mundësisë së ndërveprimit të gliadinës me antigjenet e tiroides (Krysiak et al., 2018).

Ky studim tregoi se ëmbëlsirat, ushqimet e përpunuara, fast food, bulmeti dhe bishtajoret konsumoheshin më shumë nga pacientët me HT sesa nga grupi i kontrollit. Ndërsa, perimet dhe frutat konsumoheshin më pak nga pacientët me HT sesa nga grupi i kontrollit. Rezultati më i rëndësishëm i studimit ishte konsumimi i bulmetit nga pacientët me HT krahasuar me grupin e kontrollit. Teorikisht, ky efekt mund të shpjegohet nga sasia e lartë e yndyrnave shtazore në këto produkte ose intoleranca ndaj laktozës. Dietat me përmbajtje të lartë yndyrnash shtazore mund të kontribuojnë në inflamacionin kronik dhe përparimin e patologjive kronike në trup, përfshirë tiroiditin Hashimoto.

Eliminimi i laktozës nga dieta është i lidhur me faktin që rreth 75% e individëve me HT kanë intolerancë ndaj laktozës. Intoleranca ndaj laktozës ul ndjeshëm absorbimin e levotiroksinës nga trakti gastrointestinal. Prandaj, individët me HT që kanë nevojë të marrin levotiroksinë duhet të testohet për intolerancë ndaj laktozës dhe të eliminojnë laktozën nga dieta nëse rezultojnë pozitivë. Reduktimi i yndyrnave shtazore ose dietat pa laktozë nuk duhet të rekomandohen domosdoshmërisht për të gjithë pacientët me tiroidit Hashimoto, por duhet të merren parasysh karakteristikat individuale dhe faktorët e rrezikut të secilit individ.

Konsumimi i ëmbëlsirave dhe ushqimeve të përpunuara është gjithashtu i njohur për vetitë e tij pro-inflamatore dhe lidhjen me sëmundjet kronike. Nga kjo pikëpamje, këto grupe ushqimesh mund të ndikojnë në përkeqësimin e tiroidit Hashimoto. Zëvendësimi i ushqimeve të shëndetshme me këto lloje ushqimesh rezulton në një konsum më të vogël të lëndëve ushqyese që nevojiten për funksionimin e gjëndrës tiroide siç janë jodi, seleni, vitamina D dhe hekuri.

Konsumimi i glutenit gjithashtu mund të paravendosë për auto imunitet në përgjithësi dhe HT. Mekanizmi mendohet të jetë një ndërveprim mes elementeve të tiroides dhe gliadinës (Ratajczak et al., 2017). Individët me HT shpesh kërkojnë eliminimin e glutenit nga dieta për shkak të bashkekzistencës me intolerancën ndaj glutenit, e cila është dhjetë herë më e shpeshtë tek individët me HT sesa në popullatën e përgjithshme (Sharma et al., 2016). Në studimin tonë, buka dhe produktet e brumit ishin grupi i ushqimeve që konsumoheshin më shpesh nga popullata, dhe nuk u vërejt ndonjë ndryshim statistikor i rëndësishëm midis grupit HT dhe grupit të kontrollit në frekuencën e konsumimit të këtyre ushqimeve. Prandaj, nuk rekomandojmë një dietë pa gluten për çdo individ me HT, por vetëm për ata individë që testohen pozitive për intolerancë ndaj glutenit.

REFERENCA

- Boas, M., Feldt-Rasmussen, U., & Main, K. M. (2012, May). Thyroid effects of endocrine disrupting chemicals. *Molecular and Cellular Endocrinology*, 355(2), 240–248. <https://doi.org/10.1016/j.mce.2011.09.005>
- Bothra, N., Shah, N., Goroshi, M., Jadhav, S., Padalkar, S., Thakkar, H., Toteja, G. S., Shivane, V. Lila, A., & Bandgar, T. (2017, May 31). Hashimoto's thyroiditis: relative recurrence risk ratio and implications for screening of first- degree relatives. *Clinical Endocrinology*, 87(2), 201–206. <https://doi.org/10.1111/cen.13323>
- Bülow Pedersen, I., Knudsen, N., Carlé, A., Schomburg, L., Köhrle, J., Jørgensen, T., Rasmussen,
- L. B., Ovesen, L., & Laurberg, P. (2013, March 27). Serum selenium is low in newly diagnosed Graves' disease: a population-based study. *Clinical Endocrinology*, 79(4), 584–590. <https://doi.org/10.1111/cen.12185>
- Büloë Pedersen, I., Laurberg, P., Knudsen, N., Jørgensen, T., Perrild, H., Ovesen, L., & Rasmussen,
- L. B. (2007, August 1). An Increased Incidence of Overt Hypothyroidism after Iodine Fortification of Salt in Denmark: A Prospective Population Study. *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 92(8), 3122–3127. <https://doi.org/10.1210/jc.2007-0732>

- Camargo, R. Y. A., Tomimori, E. K., Neves, S. C., G S Rubio, I., Galvão, A. L., Knobel, M., & Medeiros-Neto, G. (2008, September). Thyroid and the environment: exposure to excessive nutritional iodine increases the prevalence of thyroid disorders in São Paulo, Brazil. *European Journal of Endocrinology*, 159(3), 293–299. <https://doi.org/10.1530/eje-08-0192>
- P., Lengert, A. V. H., Biondi, A. P. C., Sargentini, L. D. B., Brisotti, J. L., Gomes, E., & de Oliveira, G. L. V. (2021, March 5). Detection of Alterations in the Gut Microbiota and Intestinal Permeability in Patients With Hashimoto Thyroiditis. *Frontiers in Immunology*, 12. <https://doi.org/10.3389/fimmu.2021.579140>
- D'Aurizio, F., Villalta, D., Metus, P., Doretto, P., & Tozzoli, R. (2015, May). Is vitamin D a player or not in the pathophysiology of autoimmune thyroid diseases? *Autoimmunity Reviews*, 14(5), 363– 369. <https://doi.org/10.1016/j.autrev.2014.10.008>
- Derumeaux, H., Valeix, P., Castetbon, K., Bensimon, M., Boutron-Ruault, M., Arnaud, J., & Hercberg, S. (2003, March 1). Association of selenium with thyroid volume and echostructure in 35- to 60-year-old French adults. *European Journal of Endocrinology*, 309–315. <https://doi.org/10.1530/eje.0.1480309>
- Desailoud, R., & Hober, D. (2009). Viruses and thyroiditis: an update. *Virology Journal*, 6(1), 5. <https://doi.org/10.1186/1743-422x-6-5>
- Duntas, L. H. (2014, October 8). Chemical contamination and the thyroid. *Endocrine*, 48(1), 53– 64. <https://doi.org/10.1007/s12020-014-0008-4>
- Y., Xu, S., Zhang, H., Cao, W., Wang, K., Chen, G., Di, H., Cao, M., & Liu, C. (2014). Selenium Supplementation for Autoimmune Thyroiditis: A Systematic Review and Meta-Analysis. *International Journal of Endocrinology*, 2014, 1–8. <https://doi.org/10.1155/2014/904573>
- Duntas, L. H. (2008, July 8). Environmental factors and autoimmune thyroiditis. *Nature Clinical Practice Endocrinology & Metabolism*, 4(8), 454–460. <https://doi.org/10.1038/ncpendmet0896>
- Effraimidis, G., Tijssen, J. G. P., & Wiersinga, W. M. (2009, April 1). Discontinuation of Smoking Increases the Risk for Developing Thyroid Peroxidase Antibodies and/or Thyroglobulin Antibodies: A Prospective Study. *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 94(4), 1324–1328. <https://doi.org/10.1210/jc.2008-1548>
- Hall R, Stanbury JB. (1967) Familial studies of autoimmune thyroiditis. *Clin. Exp. Immunol.*;2:719– 725.
- Hollowell, J. G., Staehling, N. W., Flanders, W. D., Hannon, W. H., Gunter, E. W., Spencer, C. A., & Braverman, L. E. (2002, February). Serum TSH, T4, and Thyroid Antibodies in the United States Population (1988 to 1994): National Health and Nutrition Examination Survey (NHANES III). *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 87(2), 489–499 <https://doi.org/10.1210/jcem.87.2.8182>
- Krysiak, R., Szkróbka, E., & Okopień, B. (2018, July 30). The Effect of Gluten-Free Diet on Thyroid Autoimmunity in Drug-Naïve Women with Hashimoto's

Thyroiditis: A Pilot Study. *Experimental and Clinical Endocrinology & Diabetes*, 127(07), 417–422. <https://doi.org/10.1055/a-0653-7108>

- Laurberg, P., Cerqueira, C., Ovesen, L., Rasmussen, L. B., Perrild, H., Andersen, S., Pedersen, I. B., & Carlé, A. (2010, February). Iodine intake as a determinant of thyroid disorders in populations. *Best Practice & Research Clinical Endocrinology & Metabolism*, 24(1), 13–27. <https://doi.org/10.1016/j.beem.2009.08.013>
- Lazarus, J. H. (2011, March 1). The Continuing Saga of Postpartum Thyroiditis. *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 96(3), 614–616. <https://doi.org/10.1210/jc.2011-0091>
- Luo, Y., Kawashima, A., Ishido, Y., Yoshihara, A., Oda, K., Hiroi, N., Ito, T., Ishii, N., & Suzuki, K. (2014, July 21). Iodine Excess as an Environmental Risk Factor for Autoimmune Thyroid Disease. *International Journal of Molecular Sciences*, 15(7), 12895–12912. <https://doi.org/10.3390/ijms150712895>
- Nguyen, C. T., & Mestman, J. H. (2019, June). Postpartum Thyroiditis. *Clinical Obstetrics & Gynecology*, 62(2), 359–364. <https://doi.org/10.1097/grf.0000000000000430>
- Organization, W. H. (2007, January 1). Assessment of iodine deficiency disorders and monitoring their elimination : a guide for programme managers. Assessment of Iodine Deficiency Disorders and Monitoring Their Elimination : A Guide for Programme Managers. <https://apps.who.int/iris/handle/10665/43781>
- Pedersen, I. B., Knudsen, N., Carlw, A., Vejbjerg, P., Jørgensen, T., Perrild, H., Ovesen, L., Rasmussen, L. B., & Laurberg, P. (2011, June 10). A cautious iodization programme bringing iodine intake to a low recommended level is associated with an increase in the prevalence of thyroid autoantibodies in the population. *Clinical Endocrinology*, 75(1), 120–126. <https://doi.org/10.1111/j.1365-2265.2011.04008.x>
- Prummel, M. F., & Wiersinga, E. M. (2005, March). Thyroid peroxidase autoantibodies in euthyroid subjects. *Best Practice & Research Clinical Endocrinology & Metabolism*, 19(1), 1–15. <https://doi.org/10.1016/j.beem.2004.11.003>
- Ragusa, F., Fallahi, P., Elia, G., Gonnella, D., Paparo, S. R., Giusti, C., Churilov, L. P., Ferrari, S. M., & Antonelli, A. (2019, December). Hashimotos' thyroiditis: Epidemiology, pathogenesis, clinic and therapy. *Best Practice & Research Clinical Endocrinology & Metabolism*, 33(6), 101367. <https://doi.org/10.1016/j.beem.2019.101367>
- Rasmussen, L. B., Schomburg, L., Köhrle, J., Pedersen, I. B., Hollenbach, B., Hög, A., Ovesen, L., Perrild, H., & Laurberg, P. (2011, April). Selenium status, thyroid volume, and multiple nodule formation in an area with mild iodine deficiency. *European Journal of Endocrinology*, 164(4), 585–590. <https://doi.org/10.1530/eje-10-1026>
- Ratajczak, A., Moszak, M., & Grzymisławski, M. (2017, December 29). Dietary recommendations for hypothyroidism and Hashimoto's disease. *Nursing and Public Health*, 7(4), 305–311. <https://doi.org/10.17219/pzp/76716>

- Sharma, B., Joshi, A., Varthakavi, P., Chadha, M., Bhagwat, N., & Pawal, P. (2016). Celiac autoimmunity in autoimmune thyroid disease is highly prevalent with a questionable impact. *Indian Journal of Endocrinology and Metabolism*, 20(1), 97. <https://doi.org/10.4103/2230-8210.172241>
- Springer, D., Jiskra, J., Limanova, Z., Zima, T., & Potlukova, E. (2017, January 19). Thyroid in pregnancy: From physiology to screening. *Critical Reviews in Clinical Laboratory Sciences*, 54(2), 102–116. <https://doi.org/10.1080/10408363.2016.1269309>
- Stranges, S., Marshall, J. R., Natarajan, R., Donahue, R. P., Trevisan, M., Combs, G. F., Cappuccio, F. P., Ceriello, A., & Reid, M. E. (2007, August 21). Effects of Long-Term Selenium Supplementation on the Incidence of Type 2 Diabetes. *Annals of Internal Medicine*, 147(4), 217. <https://doi.org/10.7326/0003-4819-147-4-200708210-00175>
- Teng, X., Shan, Z., Chen, Y., Lai, Y., Yu, J., Shan, L., Bai, X., Li, Y., Li, N., Li, Z., Ėang, S., Xing, Q., Xue, H., Zhu, L., Hou, X., Fan, C., & Teng, Ė. (2011, June). More than adequate iodine intake may increase subclinical hypothyroidism and autoimmune thyroiditis: a cross-sectional study based on two Chinese communities with different iodine intake levels. *European Journal of Endocrinology*, 164(6), 943–950. <https://doi.org/10.1530/eje-10-1041>
- Tomer, Y., & Huber, A. (2009, May). The etiology of autoimmune thyroid disease: A story of genes and environment. *Journal of Autoimmunity*, 32(3–4), 231–239. <https://doi.org/10.1016/j.jaut.2009.02.007>
- Van Zuuren, E. J., Albusta, A. Y., Fedorowicz, Z., Carter, B., & Pijl, H. (2013, June 6). Selenium supplementation for Hashimoto's thyroiditis. *Cochrane Database of Systematic Reviews*, 2013(6). <https://doi.org/10.1002/14651858.cd010223.pub2>
- Vanderpump, M. P. J., Tunbridge, W. M. G., French, J. M., Appleton, D., Bates, D., Clark, F., Evans, J. G., Hasan, D. M., Rodgers, H., Tunbridge, F., & Young, E. T. (1995, July). The incidence of thyroid disorders in the community: a twenty-year follow-up of the Ėhickham Survey. *Clinical Endocrinology*, 43(1), 55–68. <https://doi.org/10.1111/j.1365-2265.1995.tb01894.x>
- Wang, Z., Zhang, Q., Lu, J., Jiang, F., Zhang, H., Gao, L., & Zhao, J. (2010, August 1). Identification of Outer Membrane Porin F Protein of *Yersinia enterocolitica* Recognized by Antithyrotropin Receptor Antibodies in Graves' Disease and Determination of Its Epitope Using Mass Spectrometry and Bioinformatics Tools. *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 95(8), 4012–4020. <https://doi.org/10.1210/jc.2009-2184> Ėith Graves' patients. *European Journal of Endocrinology*, 164(5), 789–794. <https://doi.org/10.1530/eje-10-1172>
- Wiersinga, W. M. (2013, May 11). Smoking and thyroid. *Clinical Endocrinology*, 79(2), 145–151. <https://doi.org/10.1111/cen.12222>
- Wu, Q., Rayman, M. P., Lv, H., Schomburg, L., Cui, B., Gao, C., Chen, P., Zhuang, G., Zhang, Z.,

- Peng, X., Li, H., Zhao, Y., He, X., Zeng, G., Qin, F., Hou, P., & Shi, B. (2015, November). Low Population Selenium Status Is Associated With Increased Prevalence of Thyroid Disease. *The Journal of Clinical Endocrinology & Metabolism*, 100(11), 4037–4047. <https://doi.org/10.1210/jc.2015-2222>
- Zaletel, K., Gaberšček, S., Pirnat, E., Krhin, B., & Hojker, S. (2011, October). Ten-year follow-up of thyroid epidemiology in Slovenia after increase in salt iodization. *Croatian Medical Journal*, 52(5), 615–621. <https://doi.org/10.3325/cmj.2011.52.615>
- Zheng, J., He, C. T., Chen, S. J., Yan, X., Guo, M. N., Wang, M. H., Yu, Y. J., Yang, Z. Y., & Mai, B. X. (2017, May). Disruption of thyroid hormone (TH) levels and TH-regulated gene expression by polybrominated diphenyl ethers (PBDEs), polychlorinated biphenyls (PCBs), and hydroxylated PCBs in e-waste recycling workers. *Environment International*, 102, 138–144. <https://doi.org/10.1016/j.envint.2017.02.009>

SHKENCA EKONOMIKE

MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR POST COVID-19

Dr (proc.). Malvina Hysa

Kolegji Universitar "LOGOS", Tiranë,

malvina.hysa@kulogos.edu.al

Prof. Asoc. Dr. Dori Risilia

Universiteti Bujqësor i Tiranës

drisilia@ubt.edu.al

Dr (proc.). Edisela Mena

Kolegji Universitar "LOGOS", Tiranë

edisela.mena@kulogos.edu.al

ABSTRAKT

Përhapja në mbarë botën e virusit arriti në përmasa pandemike dhe shkaktoi një sërë masash emergjente: ulje normash, mbështetje likuiditeti, shtyrje në kohë të taksave, ndalime udhëtimi, mbylljet e bizneseve, kufizime në tubime për të kufizuar përhapjen. Edhe pse

Veçanërisht familjet dhe bizneset e vogla dhe të mesme (SME), u përballën me rënie të të ardhurave, ndërprerje të zinxhirit, kushte më të shtrënguara kreditimi, si dhe u përballën me një krizë të theksuar likuiditeti.

Të gjitha së bashku, këto çojnë në vonesa në dërgimin e mallrave dhe pagesave dhe shkaktojnë humbje të vendeve të punës dhe, si rezultat, mbyllje dhe falimentimin e bizneseve.

Kjo periudhë reflektoi në rënien e përfitimeve, rënien e cilësisë së aktiveve dhe ngadalësim të kredisë

Ekonomia globale u përball me një destabilitet të theksuar në tregjet financiare.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të evidentojë dhe pasqyrojë masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse, për menaxhimin e situatës dhe sesa efikase kanë rezultuar këto masa të ndërmarra.

Fjalët kyçe: risk, Covid-19, menaxhim financiar, stabilitet financiar, likuiditet

1.1 SISTEMET FINANCIARE DHE NDIKIMI I TYRE NË KATËR KANALET KRYESORE

Ndikimi i krizës në sektorin financiar varet nga aftësia e këtij sektori për të zbutur katër rreziqe:

a) Risku i tregut:

Luhatjet akute në ndjeshmërinë e investitorëve, të kombinuara me rritjen e pasigurisë, mund të rrisin koston e financimit, si dhe në tregjet e huaja. si ato të brendshme, për qeverinë dhe sektorin privat.

b) Risku i likuiditetit:

Paqëndrueshmëria e tregjeve rriti kërkesën për likuiditet.

Për më tepër, problemet me flukset monetare të firmave të prekura dhe ndryshimi i kërkesës publike për para shtrënguan kushtet e financimit dhe likuiditetit për bankat, duke ndikuar kështu në kreditimin e sektorit privat.

Rritja e kërkesës për instrumente valutore mund të shkaktojë një krizë reale likuiditeti.

c) Risku i kredisë:

Dobësimi i perspektivës ekonomike rriti nivelin e kredive nën standard dhe do të pengojë institucionet bankare dhe jo bankarë nga kreditimi për të mbështetur aktivitetin real. Rreziqet e kredisë ndërlikohen më tej kur firmat dhe familjet me likuiditet të zvogëluar kanë borxhe për të shlyer, por nuk arrijnë të gjejnë financim kalimtar për të mbuluar humbjen e të ardhurave.

d) Risku për fitimet dhe qëndrueshmëria:

Risqet dobësuan fitimet dhe rentabilitetin në sektorin financiar.

Këto rreziqe kanë një ndikim më të madh në tregjet në zhvillim si Ballkani Perëndimor, sistemet financiare të cilëve janë më pak të përgatitur për të përballuar goditjet.

Qeveritë duhet të përballen me tregje të paqëndrueshme financimi pasi shohin një rritje të nevojave financiare dhe kostove të financimit, daljet e kapitalit të huaj dhe një rritje të paparashikueshmërisë së sjelljes së investitorëve.

Daljet e portofolit nga ekonomitë evropiane në zhvillim ishin rreth 4.8 miliardë dollarë, nga të cilat 3.4 miliardë dollarë kapital neto dhe 1.4 miliardë dollarë dalje borxhi.

Pandemia e COVID-19 shkaktoi gjithashtu humbje të rënda në tregjet e kapitalit, me një rënie 10 % në vlerën e aksioneve evropiane dhe një rënie prej 25 % .

1.2 RITJA E KREDITIMIT

Rritja e kreditimit ishte pozitive deri në fund të vitit 2019, kur kreditimi për klientët familjarë u rrit më shpejt se për klientët e biznesit, gjë që kërkonte monitorim të ngushtë. Në veçanti, kreditimi për klientët familjarë është zgjeruar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha vendet e rajonit, mbështetur nga norma rekord të ulëta interesi, kushte të qëndrueshme kredie bankare dhe besim i fortë konsumator.

Deri në fund të vitit 2019, teprica totale e kredive për individët në rajon u rrit mesatarisht me 9 % dhe 6 % për bizneset. Me këtë rritje të lartë të kredisë për individë dhe me afatet e gjata të shlyerjes së kredive konsumatore në disa vende, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet risqeve të vazhdueshme dhe dobësive.

1.3 SEKTORI FINANCAR MUND TË BËJË SHUMË QË TË NDIHMOJË PËR TË ZBULUAR EFEKTIN QË PATI NË EKONOMINË REALE COVID-19.

Financimi tranzitor bankar dhe ristrukturimi i kredive për huamarrësit solidë që janë përballur me mungesën e parave të gatshme mund t'i ndihmojë ata të zbusin efektet e krizës, të përshtaten me mjedisin e ri në të cilin veprojnë dhe, në fund të fundit, të kontribuojnë në fazën e rimëkëmbjes. Këtu, linjat e kreditit dhe garancitë e pjesshme të kredisë mund të ofrojnë financim shtesë për të mbajtur në këmbë, sipërmarrjet fitimprurëse dhe për të rikuperuar flukset e kredisë. Gjatë fazës së rimëkëmbjes, do të përfitonin edhe eksportuesit dhe firmat e zinxhirit

të furnizimit nga financimi i përshtatur për eksportet, shlyerja e borxhit dhe mekanizmat e sigurimit të kredisë.

Masat e sektorit financiar për të mbështetur ekonominë duhet të jenë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të shpejtë, duke ruajtur ekuilibrin me shqetësimet për stabilitetin financiar.

Masat urgjente duhet të jenë në kohë dhe të kenë strategji të qarta daljeje.

Në të njëjtën kohë, stresi financiar i zgjatur do të duhet të marrë masa për të parandaluar akumulimin e rreziqeve të stabilitetit financiar.

Bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë më intensivisht treguesit financiarë, veçanërisht zhvillimet e kredisë dhe likuiditetit.

Për të parandaluar pasojat e një raundi të dytë në ekonomi dhe për të mbështetur stabilitetin financiar, do të jetë thelbësore të krijohen korniza për rrjetet e makro-mbikëqyrjes, falimentimit dhe mbrojtjes financiare.

Menaxhimi i krizës për të trajtuar në mënyrë efektive institucionet e dobëta financiare plus një kornizë falimentimi që mund të zgjidhë problemet e firmave me probleme do të ndihmojë shpejt në zbutjen e mospagimeve shkatërruese të vlerës së shtuar në të gjithë zinxhirin e furnizimit, mund të lehtësojë stresin financiar dhe mund të sigurojë vazhdimësinë e huadhënies në mbështetje të ekonomisë.

1.4 POLITIKA MONETARE DHE BANKA QENDRORE

Për sa i përket politikës monetare, bankat qendrore të Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë kanë ulur normat e interesit. Serbia gjithashtu ka prezantuar një program për mbështetjen e likuiditetit për bankat përmes transaksioneve të riblerjes dhe shkëmbimit të normave të interesit, dhe Maqedonia e Veriut ka ndryshuar kërkesat ligjore për rezervat e dinarit për kreditë e reja dhe të ri strukturuar dhe ka vonuar zbatimin e kërkesave ligjore për likuiditet për t'u mundësuar bankave të fokusohen në huadhënien për bizneset dhe familjet.

Banka e Shqipërisë ka hequr tavanin e huave të marra nga bankat qendrore për bankat e nivelit të dytë dhe ka deklaruar se nëse ka kufizime të mëtejshme likuiditeti, mund të përdorë lehtësim sasior, për shembull nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë të qeverisë dhe përdorimit të rezervave brenda kufijve ligjorë.

Qeveritë e Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë kanë njoftuar gjithashtu mbështetje financiare të drejtpërdrejtë për bizneset përmes garancive të kredisë, të

cilat do të shpërndahen përmes institucioneve financiare të zhvillimit, фондеве të reja të garancisë dhe sistemit bankar.

Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë

Sipas INSTAT-it, rritja ekonomike u përshpejtua në 3.8% në këtë periudhë, krahasuar me prej 2.5% të regjistruar në gjysmën e parë. Ritmi më i lartë i rritjes ekonomike është ndikuar kryesisht nga sezoni i mirë turistik, nga rritja e prodhimit industrial, si dhe nga shuarja e efektit negativ të prodhimit të ulët të energjisë elektrike. Gjithashtu, tregu i punës ka vijuar të përmirësohet në tremujorin e tretë, duke e çuar normën e papunësisë në nivelin më të ulët historik prej 11.4%. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.3% në tremujorin e katërt, duke shënuar rënie krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ulja e inflacionit në këtë tremujor i atribuohet rënies së çmimeve të qirave dhe karburanteve. Nga ana tjetër, çmimet e ushqimeve të përpunuara janë rritur, ndërsa çmimet e mallrave të tjera të shportës kanë ruajtur një kontribut të ulët pozitiv në inflacion. Inflacioni i ulët është ndikuar nga rritja e ngadaltë e kostove në ekonominë e brendshme dhe nga presionet e dobëta nga mjedisi i jashtëm.

Rritja e pagave dhe kostove të prodhimit nuk mjaftojnë ende për ta kthyer inflacionin në objektiv. Në pasqyrimin e tyre, inflacioni bazë mbetet i ulët. Gjithashtu, inflacioni i importuar mbetet i ulët, duke reflektuar çmimet e ulëta në tregjet ndërkombëtare dhe mbiçmimin e kursit të këmbimit. Kushtet e financimit dhe aktiviteti kreditues kanë ruajtur trendin në përmirësim edhe në fund të vitit. Kjo ecuri reflekton ecurinë lehtësuese të politikës monetare. Kushtet financiare për bizneset dhe individët vazhdojnë të karakterizohen nga norma të ulëta interesi dhe prime të reduktuara të rrezikut. Gjithashtu, mbiçmimi vjetor i kursit të këmbimit ka ardhur në rënie, duke ulur ndikimin shtrëngues në kushtet e financimit. Kushtet e favorshme të financimit kanë ndihmuar në zgjerimin e portofolit të kredisë për sektorin privat.

I rregulluar për kreditë jashtë bilancit dhe kurset e këmbimit, ky portofol shënoi një rritje vjetore prej 7.5% në muajin dhjetor. Rritja e kredisë për sektorin privat u mbështet nga financimi më i lartë i biznesit. Në tremujorin e fundit, ka pasur një përshpejtim të kreditimit në monedhën vendase, duke ndihmuar në balancimin më të mirë të portofolit të kredisë.

Raporti i kredisë në lekë ndaj totalit të kredisë për sektorin privat është rritur në 48.7%. Informacioni i ri ekonomik dhe financiar sugjeron se tendencat e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë mbeten pozitive.

Megjithatë, perspektiva afatshkurtra për zhvillimet ekonomike dhe financiare do të përcaktohet në një masë të konsiderueshme nga pasojat e tërmetit të 26 nëntorit. Në afat të shkurtër, ndikimi i tërmetit në treguesit makroekonomikë parashikohet të jetë negativ.

Efektet e tij mund të transmetohen në ekonomi përmes një reduktimi të mundshëm të konsumit të investimeve private, turizmit dhe aktiviteteve të tjera ekonomike në zonat e prekura. Nga ana tjetër, programi i rindërtimit do t'i japë një shtysë pozitive sektorit të ndërtimit.

Nisur nga skenari bazë i këtyre parashikimeve, politika monetare duhet të ruajë kursin akomodues të këmbimit në periudhën afatmesme. Stimulimi monetar është i nevojshëm për të mbështetur rritjen e kërkesës agregate dhe forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Parashikimet makroekonomike në këtë raport janë përditësuar në kontekstin e pasigurisë së shtuar. Megjithatë perspektivat afatmesme të zhvillimit të ekonomisë shqiptare janë të qëndrueshme, ecuria ekonomike në periudhën afatshkurtër mbetet subjekt i shkallës së materializimit të pasojave të tërmeteve në treguesit makroekonomikë. Veçanërisht i rëndësishëm për dinamikën afatmesme të kërkesës agregate dhe prodhimit është impulsi i krijuar nga programi i rindërtimit. Madhësia dhe struktura e financimit, si dhe shpërndarja kohore e shpenzimeve të rindërtimit mund të kenë efekte të rëndësishme në performancën e prodhimit dhe inflacionit. Banka e Shqipërisë vlerëson se në gjysmën e dytë të vitit 2020 aktiviteti i sektorit bankar është zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme. Ndërmjetësimi financiar ka vijuar me ritme të mira; cilësia e kredisë është ruajtur në nivele të pranueshme; depozitat u rritën ndjeshëm; dhe tregues të tjerë të qëndrueshmërisë financiare kanë mbetur në nivelet e duhura. Masat publike në fushën fiskale, monetare dhe të kujdesshme, ndihmuan performancën e kreditimit, zbutën ndikimin e pandemisë dhe ndihmuan në kontrollin e rreziqeve.

Pavarësisht pritshmërive për një progres më të qëndrueshëm, pasiguritë mbeten të rëndësishme. Bankat duhet të vazhdojnë të jenë vigjilente, veçanërisht në lidhje me monitorimin nga afër të aftësisë paguese të klientëve të tyre huamarrës. Ashtu si edhe më parë, Banka e Shqipërisë mbetet e gatshme të marrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas ligjit, për të mbështetur veprimtarinë bankare dhe për të kontribuar në stabilitetin e sistemit financiar.

1.5 MENAXHIMI I RISKUT

Rreziqe të tjera lindin nga kufizimet monetare dhe menaxhimi i krizës dhe nga dobësitë e borxhit të sektorit privat. Për sa i përket parandalimit të krizës, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi kanë shumë pak kontroll mbi politikën e tyre monetare, gjë që e bën të

vështirë për ta menaxhimin dhe mbështetjen e likuiditetit. Edhe pse ka pasur përmirësime të rëndësishme gjatë dekadës së fundit, ka ende dobësi në të gjithë rajonin në kornizat ekzistuese për menaxhimin e krizave, mbikëqyrjen dhe ndërhyrjen emergjente. Gjithashtu, dobësitë e sektorit privat kanë lindur nga kombinimi i faktorëve si niveli i borxhit të sektorit të biznesit dhe familjes, sektori dhe monedha dhe struktura e amortizimit të borxhit. Në veçanti, shëndeti financiar i kompanive është shqetësues pasi ende nuk ka zgjidhur borxhet nga kriza e viteve 2008-2009.

Niveli i kredive nën standard ka rënë në të gjitha vendet, por dobësimi i perspektivës ekonomike pritet të ndikojë negativisht në cilësinë e aktiveve dhe të pengojë bankat nga kreditimi. Gjatë gjithë vitit 2019, niveli mesatar rajonal i kredive nën standard ra sërish, në 5.3% të totalit të kredive, duke iu afruar nivelit para krizës financiare globale prej rreth 4.4%. Niveli i kredive nën standard në Kosovë është më i ulëti në rajon, por edhe pse me trend në rënie, kreditë nën standarde janë ende të larta në Shqipëri (8.4 %) dhe Bosnje dhe Hercegovinë (7.7%). Reformat e fundit kanë ndihmuar në uljen e ndjeshme të kredive nën standard, ndërkohë që Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia vazhdojnë të mbeten pa bilanc dhe të shesin kredi nën standard. Në Shqipëri, në entitetin Republika Serpska të Bosnjë-Hercegovinës dhe në Kosovë, ka ligje të reja falimentimi. Në korrik 2019, Banka e Shqipërisë miratoi një kuadër për ristrukturimin vullnetar jashtëgjyqësor të kredive të mëdha nën standarde. Mali i Zi ka zgjeruar mbulimin e regjistrimit të kredive për të rritur kapacitetin e kreditimit për vlerësimin e rrezikut të kredisë dhe ka harmonizuar rregulloren e tij të menaxhimit të rrezikut të kredisë me standardet e Autoritetit Bankar Evropian. Por ka të dhëna se në shumë vende, pavarësisht përmirësimeve të vërejtura në nivelin e raportuar të kredive nën standard, gjendja financiare e huamarrësve të sektorit privat vazhdon të jetë problematike. Do të jetë edhe më i rëndësishëm forcimi i regjimeve të falimentimit të kompanive dhe konsumatorëve për t'i dhënë zgjidhje rasteve të mospagimit të kredive.

Autoritetet e sektorit financiar në të gjithë rajonin kanë vepruar tashmë për të kufizuar pasojat ekonomike dhe për të ruajtur stabilitetin financiar. Ata po monitorojnë nga afër zhvillimet e likuiditetit dhe kreditimit, bazuar në shqetësimet në rritje për stabilitetin financiar. Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mali i Zi dhe Serbi kanë marrë masa të tilla si moratoriumet e ri pagimit të kredive dhe ndryshimet në klasifikimin e rrezikut të kredisë (Bosnjë dhe Hercegovinë). Banka Kombëtare e Maqedonisë së Veriut ka zgjatur afatin pas të cilit një kredi konsiderohet nën standarde, ndërsa agjencitë mbikëqyrëse

në Shqipëri, Bosnje- Hercegovinë dhe Mal të Zi kanë pezulluar shpërndarjen e dividendëve dhe dhënien e bonuseve.

1.6 PËRFUNDIME

- Bankat qendrore dhe autoritetet mbikëqyrëse duhet të monitorojnë më intensivisht treguesit financiarë, veçanërisht zhvillimet e kredisë dhe likuiditetit.
- Për të parandaluar pasojat e një raundi të dytë në ekonomi dhe për të mbështetur stabilitetin financiar, do të jetë thelbësore të krijohen korniza për rrjetet e makro-mbikëqyrjes, falimentimit dhe mbrojtjes financiare.
- Menaxhimi i krizës për të trajtuar në mënyrë efektive institucionet e dobëta financiare plus një kornizë falimentimi që mund të zgjidhë problemet e firmave me probleme do të ndihmojë shpejt në zbutjen e mospagimeve që shkatërrojnë vlerën në të gjithë zinxhirin e furnizimit, mund të lehtësojë stresin financiar dhe mund të sigurojë vazhdimësinë e huadhënies në mbështetje të ekonomisë
- Masat e tjera, veçanërisht pezullimi i vlerësimit të kredisë dhe provizionimi, mund të krijojnë shpejt rreziqe serioze për bankat dhe klientët, pa përmendur vështirësinë e përgjigjeve mbikëqyrëse nëse ato nuk janë të përkohshme dhe të monitoruara nga afër. Prandaj, këto lloj masash duhet të vlerësohen rast pas rasti.
- Autoritetet rregullatorë dhe mbikëqyrëse në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi kanë marrë masa të tilla si moratoriumet e ri pagimit të kredisë dhe ndryshimet në klasifikimin e rrezikut të kredisë (Bosnjë dhe Hercegovinë).
- Bazuar në skenarin bazë të këtyre parashikimeve, politika monetare duhet të ruajë kursin akomodues të këmbimit në periudhën afatmesme.

REFERENCA

- https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Sistemi_Raportues_Statistikor/ (Banka e Shqipërisë)

- https://www.bankofalbania.org/Rreth_Bankes/Funksionet/Politika_monetare.html
(Banka e Shqipërisë)
- [http://www.instat.gov.al/\(Instat\)](http://www.instat.gov.al/(Instat))
- Menaxhimi i Riskut dhe Sigurimi, Scott Harrington & Gregory R.Niehaus. Botimi i Dytë, (2004)
- Njohuritë bazë për riskun dhe drejtimin e tij, Orfea Dhuci, Tiranë, (2011).

**FILOZOFITË ARSIMORE DHE PRAKTIKAT PEDAGOGJIKE NË SHKOLLAT E
MESME TË PËRGJITHSHME**

Prof. Dr. Erleta Çelmeta,

Kolegji Universitar "LOGOS"

Prof. Asoc. Dr. Nazmi Xhomara,

Universiteti Luarasi

MSc. Jora Mato,

Bologna, Itali

ABSTRAKT

Artikulli që po parashtrojmë në faqet e kësaj reviste mbështetet në një studim të gjerë që tenton të sjellë të dhëna të reja rreth dy praktikave pedagogjike të përdorura në shkollat e mesme të përgjithshme në vendin tonë; asaj tradicionale dhe asaj progresiste. Dy pjesët e para të studimit i kushtohen karakteristikave të disa filozofive arsimore, si dhe standardeve specifike të praktikave tradicionale dhe progresiste, duke nxjerrë në pah pikat e forta dhe të dobëta të këtyre standardeve që tashmë aplikohen në të gjitha sistemet e edukimit në botë. Ne po publikojmë për interesa akademike çfarë praktikohet në shkollat tona të mesme nga mësuesit dhe nxënësit.

Hyrje

Është e pamundur të kuptojmë se çfarë po ndodh në sistemin tonë të arsimit pa pasur ndonjë njohuri të dy filozofive kontradiktore që ndikojnë në politikën arsimore. Këto zakonisht përshkruhen si filozofi tradicionale dhe progresive. Duhet të theksohet se ata që mbështesin filozofinë tradicionale nuk janë të modës së vjetër, krahut të djathtë apo reaksionar: përshkrime

të tilla janë terma abuzimi të përdorur nga përkrahësit e progresivizmit për të minuar kundërshtarët e tyre. Gjithashtu duhet të theksohet se ndoshta më shumë se çdo gjë tjetër, edukatorët progresivë kanë frikë nga testimi objektiv, sepse ata e dinë se matja e sinqertë e rezultateve nxjerr në pah mangësitë e filozofisë së tyre dhe metodat e saj të mësimdhënies. Parimet kryesore të filozofisë tradicionale janë listuar më poshtë me ekuivalentet progresive së bashku. Fjalët kyçe janë të shënuara në italicë: (Roy Colby, Massachusetts, 1972)

Tradicional	Progresiv
Arsimi duhet të jetë në mënyrë të arsyeshme autoritare dhe <i>hierarkike</i>	Arsimi duhet të jetë i barabartë (<i>egalitar</i>)
Kurrikula duhet të jetë me qendër tek <i>lëndët</i>	Fëmija duhet të jetë në qendër dhe me mjaft <i>rëndësi</i>
Theksi duhet të jetë në <i>përmbajtje</i>	Theksi duhet të jetë në <i>aftësitë</i>
(Libri) <i>njohja</i> dhe saktësia janë thelbësore	<i>Përvoja</i> , eksperimenti dhe mirëkuptimi janë më të rëndësishme
Duhet të mbizotërojë racionaliteti dhe <i>shqyrtimi i fakteve</i>	Kreativiteti dhe <i>ndjenjat</i> janë më të rëndësishme se sa faktet
Njohja e së <i>drejtës</i> dhe e <i>gabimit</i>	E drejta dhe e gabuara varen nga <i>pikëpamja</i> e një personi
Duhet të ketë një <i>produkt</i>	Është <i>procesi</i> që ka rëndësi
Produkti, ose njohja e përmbajtjes, duhet të <i>testohet</i> ose <i>matet objektivisht</i>	Kriteret sigurojnë një kornizë për detyrat ose të <i>vlerësimit subjektiv</i> bazuar në aftësitë
<i>Konkurrenca</i> është e mirëpritur	<i>Bashkëpunimi</i> duhet të ketë përparësi
<i>Zgjedhja</i> në mes të kurrikulave të ndryshme dhe / ose llojeve të ndryshme të shkollës është thelbësore për të maksimizuar pikat e forta individuale	<i>E drejta</i> për të gjithë zëvendëson zgjedhjen dhe diferencimin; <i>mundësitë e barabarta</i> mund të përdoren për të ndërtuar barazinë e rezultatit

METODOLOGJIA

1.1. Qasja kërkimore dhe dizajnimi

Studimi i fokusuar mbi filozofitë e edukimit është i tipit eksplorues përshkrues. Metodologjia e përdorur në studimin mbi filozofitë e edukimit në shkollat e mesme bazohet në qasjen kërkimore sasiore. Studimi u disenjua në disa faza. Në fazën e parë u identifikua problemi kërkimor dhe u formuluan pyetjet kërkimore bazuar në shqyrtimin e literaturës. Dy pyetjet kryesore kërkimore, mbi të cilat u fokusua studimi përfshijnë:

(1) Në çfarë raporti qëndrojnë filozofitë kryesore të edukimit në lidhje me njohjen dhe besueshmërinë e mësuesve të shkollave të mesme?

(2) Cilat janë filozofitë më kryesore mbi të cilat mbështeten mësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme për të strukturuar mësimdhënien e tyre? Në fazën e dytë u eksplorua instrumenti i kërkimit, një instrument i standardizuar sipas Cohen (1999). Në fazën e tretë u përcaktua dhe u përzgjedh popullata dhe kampioni i studimit. Në fazën e katërt u zhvilluan instrumentet me mësues dhe me nxënës të shkollave të mesme të përgjithshme. Në fazën e pestë u përpunuan të dhënat statistikore në programin SPSS 20.0 dhe në fazën e gjashtë u hartua raporti kërkimor, i cili përmban bazat teorike të filozofive të edukimit, si edhe rezultatet dhe përfundimet empirike mbi njohjen dhe zbatimin në strukturimin e mësimdhënies në shkollat e mesme.

1.2. Instrumenti

Instrumenti i studimit i përdorur për grumbullimin e të dhënave sasiore me mësues dhe me nxënës, i referohet Cohen (1999). Instrumenti është një pyetësor i strukturuar specifik për eksplorimin e filozofive të edukimit në mësimdhënie. Instrumenti përfshin dy dimensione kryesore. Dimensioni i parë ka të bëjë me identifikimin e filozofive të edukimit të cilat besojnë më së shumti mësuesit e shkollave të mesme. Dimensioni i dytë ka të bëjë me strukturimin e mësimdhënies nga ana e mësuesve bazuar në një apo më shumë filozofi edukimi. Instrumenti Cohen (1999) u përkthye dhe u përdor për mësuesit me të gjitha pohimet që përmban, ndërsa u përshtat për nxënësit. Me anë të instrumentit u matën tetë filozofitë kryesore dhe më të përhapura në edukim: perenializmi, esencializmi, rikonstruksionizmi, procesimi i informacionit, progresivizmi, bihevizmi, konjitivizmi/konstruktivizmi, si dhe humanizmi. Gjithashtu me anë të instrumentit u mat strukturimi i mësimdhënies nga ana e mësuesve të shkollave të mesme, i mbështetur në një apo më shumë filozofi edukimi.

1.3 Popullata dhe kampioni

Kampioni i studimit përbëhet nga mësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme më kryesore në vend, si edhe nga nxënësit e klasave të 10, të 11, dhe të 12 të shkollave publike në vend.


Përzgjedhja e respondentëve në zhvillimin e pyetësorëve ishte rastësor klastër duke përfshirë si mësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme, ashtu edhe nxënësit që studionin në shkollat e mesme kryesore të vendit. Më konkretisht, kampioni i mësuesve (N= 211) përbëhej nga mësuesit e shkollave të mesme të përgjithshme publike në arsimin parauniversitar të përzgjedhur në 14 rrethet kryesore (qendra të qarqeve)dhe me numër më të madh popullsie të Shqipërisë. Kampioni i nxënësve (N= 1341) përbëhej nga nxënësit e shkollave publike në arsimin parauniversitar të përzgjedhur në 14 rrethet kryesore (qendra të qarqeve)dhe me numër më të madh popullsie të Shqipërisë. Shkollat e përzgjedhura në çdo rreth kishin karakteristika të ndryshme me njëri tjetrin: (a) shkolla të mesme të qendrës- shkolla të periferisë, (b) shkolla urbane - shkolla rurale, (c) shkolla të vjetra- shkolla të reja, (d) shkolla të mesme të përgjithshme me arritje të spikatura- shkolla problematike. Përzgjedhja e respondentëve mësues në çdo shkollë ishte: të gjithë mësuesit që japin mësim në shkollat e përzgjedhura në klasat 10- 12, ndërsa kriter përjashtues: mësuesit që janë në vitin e parë të punës. Përzgjedhja e respondentëve nxënës u bë si më poshtë: në shkollën e mesme të përgjithshme 1: 10 A, 11B, 12C... (në varësi të numrit të klasave dhe të numrit të nxënësve për klasë), në shkollën 2: 10C, 11B, 12A...

Popullata dhe kampioni i mësuesve

Tabela 1: Kampioni i mësuesve të shkollave të mesme të përgjithshme

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		2	.9	.9	.9
	1 M	67	31.8	31.8	32.7
	2 F	142	67.3	67.3	100.0
	Total	211	100.0	100.0	

Vlerat e frekuencave sipas gjinisë tregojnë se kampioni i respondentëve të mësuesve të shkollave që morën pjesë në studim përbëhet nga 67.3 % femra dhe 31.8% meshkuj.




Grafiku 1: Kampioni i mësuesve të shkollave të mesme të përgjithshme

Si konkluzion, kampioni i studimit, i cili përfaqëson rreth popullatën e mësuesve të shkollave të mesme më kryesore në vend dhe më me peshë në sistemin tonë arsimor parauniversitar tregon një disekuilibër gjinor në favor të mësueseve femra.

Tabela 2: Vlerat e frekuencave të arsimimit

Arsimimi					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1 BA	21	10.0	10.0	10.0
	2 MA	173	82.0	82.0	91.9
	3 Dr	17	8.1	8.1	100.0
	Total	211	100.0	100.0	

Vlerat e frekuencave sipas nivelit të arsimimit tregojnë se nga kampioni i respondentëve të mësuesve të shkollave të mesme që morën pjesë në studim rezulton se 10% e tyre zotërojnë diplomë bachelor, 82% e tyre zotërojnë diplomë master, dhe 8.1% e tyre zotërojnë doktoraturë.




Grafiku 2: Vlerat e frekuencave të arsimimit

Kjo tregon që shumica e mësuesve të shkollave të mesme që përbëjnë kampionin e studimit zotërojnë diplomë master.

Tabela 3: Vlerat e frekuencave të eksperiencës

Eksperienca					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		3	1.4	1.4	1.4
	1 0-5	17	8.1	8.1	9.5
	2 6-10	88	41.7	41.7	51.2
	3 11-20	61	28.9	28.9	80.1
	4 21-30	29	13.7	13.7	93.8
	5 30+	13	6.2	6.2	100.0
	Total	211	100.0	100.0	

Vlerat e frekuencave të eksperiencës në mësime tregojnë se nga kampioni i respondentëve të mësuesve të shkollave të mesme që morën pjesë në studim rezultoi se 8.1% e tyre kanë 1 deri në 5 vite eksperiencë, 41.7% e tyre kanë 6-deri në 10 vite eksperiencë, 28.9% e tyre kanë 11 deri në 20 vite eksperiencë, 13.7% e tyre kanë 21 deri në 30 vite eksperiencë dhe 6.2% e tyre kanë më shumë se 30 vite eksperiencë në mësime.



Grafiku 3: Vlerat e frekuencave të eksperiencës


Si konkluzion, bazuar në kampionin e studimit, rezulton se rreth 50% e mësuesve të shkollave të mesme kanë deri në 10 vite eksperiencë në mësimsdhënie, dhe rreth 50% e tyre kanë më shumë se 10 vite eksperiencë në mësimsdhënie.

Popullata dhe kampioni i nxënësve

Tabela 4: Kampioni i nxënësve të shkollave të mesme

Klasa		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Klasa	1	.1	.1	.1
	X Klasa e dhjetë	89	6.5	6.5	6.6
	XI Klasa e njëmbëdhjetë	351	25.6	25.6	32.1
	XII Klasa e dymbëdhjetë	931	67.9	67.9	100.0
	Total	1372	100.0	100.0	

Vlerat e frekuencave sipas klasave tregojnë se nga kampioni i respondentëve të nxënësve të shkollave të mesme që morën pjesë në studim rezulton se 6.5% e tyre studiojnë në klasën e 10, 25.6% e tyre studiojnë në klasën e 11, dhe 67.9% e tyre studiojnë në klasën e 12 të shkollës së mesme.



Grafiku 4: Kampioni i nxënësve të shkollave të mesme


Si konkluzion, rezulton se përqindjen më të lartë të kampionit (67.9%) e zë kampioni i nxënësve të klasave të 12, ndërsa kampioni i nxënësve të klasave të 10 dhe të 11 zë masën 31.1%.

Tabela 5: Kampioni i nxënësve të shkollave të mesme sipas bashkive

Bashkia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
	Bashkia	1	.1	.1	.1
	BERAT	86	6.3	6.3	6.3
	DIBER	59	4.3	4.3	10.6
	DURRES	41	3.0	3.0	13.6
	ELBASAN	21	1.5	1.5	15.2
	FIER	38	2.8	2.8	17.9
	GJIROKASTER	46	3.4	3.4	21.3
	KORCE	72	5.2	5.2	26.5
	KUKES	81	5.9	5.9	32.4
	LEZHE	72	5.2	5.2	37.7

LUSHNJE	80	5.8	5.8	43.5
SHKODER	80	5.8	5.8	49.3
TIRANE	659	48.0	48.0	97.4
VLORE	36	2.6	2.6	100.0
Total	1372	100.0	100.0	

Vlerat e frekuencave sipas bashkive tregojnë se nga kampioni i respondentëve të nxënësve të shkollave të mesme që morën pjesë në studim rezulton se 48 % e kampionit u përzgjedh në Tiranë, ndërsa 52% e kampionit të nxënësve në bashkitë e tjera që ishin objekt i studimit.



Grafiku 5: Kampioni i nxënësve të shkollave të mesme sipas bashkive

Si konkluzion, shpërndarja e kampionit të nxënësve është më së shumti e përqendruar në Tiranë, si qendra më e madhe dhe ku është përqendruar edhe numri më i madh i mësuesve dhe nxënësve të shkollave të mesme në vend.

1.4. Analiza e të dhënave dhe kufizimet e studimit

Për përpunimin e të dhënave të mbledhura me anë të pyetësorit të strukturuar, u përdor analiza deskriptive statistikore. Të dhënat e përfuara përfshinin si frekuencat e vlerave të variabëlve në studimi, ashtu edhe vlerat e tendencës qendrore, si vlerat e mesatares, medianës, modës, dhe devijimit standard. Gjithashtu u përdor metodologjia Cohen (1999) për të njehsuar vlerat e filozofive të edukimit. Vlerat e frekuencave, vlerat e tendencës qendrore, si edhe vlerat e

njehsuara të filozofive të edukimit, të përftuara nga respondentët mësues dhe nxënës, u analizuan dhe u krahasuan për të nxjerrë përfundimet.

Një nga kufizimet e studimit përfshin instrumentet vet raportuese të zbatuara në studim, si pyetësi i strukturuar. Gjithashtu, nga vetë specifika e studimit, filozofitë e edukimit, mësuesit dhe nxënësit patën vështirësi në nivelin e të kuptuarit të përmbajtjes së pohimeve të pyetësit. Nëse të dhënat do të gjeneroheshin me anë të instrumenteve të tjerë mund të sugjeronin rezultate dhe përfundime alternative.

ANALIZA E REZULTATEVE

2.1. Rezultatet e mbështetjes së kurrikulës, mësimeve dhe të nxënësve në filozofitë e edukimit

Pyetja kërkimore # 1:


Në çfarë raportit qëndrojnë filozofitë kryesore të edukimit në lidhje me njohjen dhe besueshmërinë e mësuesve të shkollave të mesme?

Vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit

Tabela 6: Vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas mësuesve

Nr.	Filozofitë e Edukimit	Rezultatet
1	Perenializmi	20.03
2	Esencializmi	18.92
3	Progresivizmi	20.22
4	Rekonstrukcionizmi	20.45
5	Procesimi i Informacionit	18.73
6	Bihejviorizmi	19.91
7	Konjitivizmi/Konstruktivizmi	21.57
8	Humanizmi	20.83

Duke u bazuar në vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas mësuesve, rezultojnë se vlera më e lartë i referohet konjitivizmit / konstruktivizmit, ndërsa vlera më e ulët i referohet procesimit të informacionit.




Grafiku 6: Vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas mësuesve

Si konkluzion, rezulton se mësuesit e shkollave të mesme më shumë i besojnë filozofisë konjitiviste/konstruktiviste dhe më pak filozofisë së procesimit të informacionit.

Tabela 7: Vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas nxënësve

Nr.	Filozofitë e Edukimit	Rezultatet
1	Perenializmi	17.73
2	Esencializmi	16.71
3	Progresivizmi	21.01
4	Rekonstruksionizmi	18.04
5	Procesimi i Informacionit	16.41
6	Biheviorizmi	18.75
7	Konjitivizmi/Konstruktivizmi	19.20
8	Humanizmi	19.75

Duke u bazuar në vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas nxënësve, rezulton se vlera më e lartë i referohet progresivizmit, ndërsa vlera më e ulët i referohet procesimit të informacionit.



Grafiku 7: Vlerat e njehsuara të filozofive të edukimit sipas nxënësve

Si konkluzion, rezulton se sipas nxënësve, mësuesit e shkollave të mesme më shumë i besojnë filozofisë progresiviste dhe më pak filozofisë së procesimit të informacionit.

Duke krahasuar rezultatet e përfthuara nga mësuesit me rezultatet e përfthuara nga nxënësit rezulton se ekzistojnë diferenca relative, por të vogla. Pra, vlera më e lartë sipas mësuesve i referohet filozofisë konjitiviste/konstruktiviste, ndërsa sipas nxënësve i referohen filozofisë progresiviste.

Si përfundim , duke përfshirë si vlerat e përfthuara të tendencës qendrore, ashtu edhe vlerat e njehsuara sipas metodologjisë Cohen (1999), arrihet në përfundim se mësuesit e shkollave të mesme i besojnë më shumë filozofisë perenialiste dhe konjitiviste/konstruktiviste, ndërsa më pak i besojnë filozofisë esencialiste dhe filozofisë së procesimit të informacionit. Ndërsa sipas nxënësve, mësuesit i besojnë më shumë filozofisë progresiviste dhe më pak filozofisë së procesimit të informacionit.

Vlerat mesatare të mësimdhënies së bazuar në filozofitë e edukimit

Pyetja kërkimore # 2:

Cilat janë filozofitë më kryesore mbi të cilat mbështeten mësuesit e shkollave të mesme për të strukturuar mësimdhënien e tyre?


Vlerat e tendencës qendrore të mësimdhënies së bazuar në filozofitë e edukimit

Tabela 8: Vlerat e tendencës qendrore të mësimdhënies së bazuar në filozofitë e edukimit sipas mësuesve

Statistics						
		Mësimdhënie perenialiste	Mësimdhënie esencialiste	Mësimdhënie progresiviste	Mësimdhënie biheavioriste	Mësimdhënie konjitiviste/konstruktiviste
N	Valid	211	211	211	211	211
	Missing	0	0	0	0	0
Mean		4.38	4.28	4.16	3.88	4.18

Median	5.00	4.00	4.00	4.00	4.00
Mode	5	5	4	5	4
Std. Deviation	.780	.942	.835	1.148	.869
Minimum	2	1	2	1	1
Maximum	5	5	5	5	5

Duke u bazuar në vlerat e përftuara të mesatares, por edhe të medianës dhe modës, për sa i përket kampionit të mësuesve, rezulton se përgjithësisht vlerat luhaten ndërmjet shkallëve 3 dhe 5, që nënkuptojnë një interval nga nuk jam dakord deri në jam plotësisht dakord.




Grafiku 8: Vlerat e tendencës qendrore të mësimeve së bazuar në filozofitë e edukimit sipas mësuesve

Duke u bazuar në vlerat e përftuara të mesatares sipas mësuesve, rezulton se vlera më e lartë i përket mësimeve perenialiste, ndërsa vlera më e ulët mësimeve bihevioriste, megjithëse diferencat janë mjaft të vogla. Kjo nënkupton që mësuesit e gjimnazeve e strukturojnë mësimeve të tyre më së shumti bazuar në filozofinë perenialiste dhe më së pakti në filozofinë bihevioriste.

Tabela 9: Vlerat e tendencës qendrore të mësimeve së bazuar në filozofitë e edukimit sipas nxënësve

Statistics						
		Mësimdhënie perenialiste	Mësimdhënie esencialiste	Mësimdhënie progresiviste	Mësimdhënie bihejvioriste	Mësimdhënie konjitiviste/konstruktiviste
N	Valid	1357	1360	1362	1355	1359
	Missing	15	12	10	17	13
Mean		4.24	3.97	4.29	4.08	4.13
Median		4.00	4.00	5.00	4.00	4.00
Mode		5	4	5	4	5
Std. Deviation		1.178	.965	.916	.881	.918
Minimum		1	1	1	1	1
Maximum		32	5	5	5	5

Duke u bazuar në vlerat e përftuara të mesatares, por edhe të medianës dhe modës, për sa i përket kampionit të nxënësve, rezulton se përgjithësisht vlerat luhaten ndërmjet shkallëve 3 dhe 5, që nënkuptojnë një interval nga nuk jam dakord deri në jam plotësisht dakord.



Grafiku 9: Vlerat e mesatares së mësimdhënies të bazuar në filozofitë e edukimit sipas nxënësve

Duke u bazuar në vlerat e përftuara të mesatares sipas nxënësve, rezulton se vlera më e lartë i përket mësimdhënies progresiviste, ndërsa vlera më e ulët mësimdhënies esencialiste, megjithëse diferencat janë mjaft të vogla. Kjo nënkupton që mësuesit e shkollave të mesme, sipas nxënësve, e strukturojnë mësimdhënien e tyre më së shumti bazuar në filozofinë progresiviste dhe më së pakti në filozofinë esencialiste.

Duke krahasuar rezultatet e përfutuara nga mësuesit me rezultatet e përfutuara nga nxënësit rezulton se ekzistojnë diferenca relative, por të vogla. Pra, vlera më e lartë sipas mësuesve i referohet filozofisë perenialiste, ndërsa sipas nxënësve i referohen filozofisë progresiviste.

Si Përfundim, duke u bazuar në vlerat e përfutuara të tendencës qendrore, arrihet në përfundimin se mësuesit e shkollave të mesme e strukturojnë mësimdhënien e tyre më së shumti bazuar në filozofinë perenialiste dhe më së pakti në filozofinë esencialiste. Ndërsa edhe sipas nxënësve, mësuesit e këtyre shkollave e strukturojnë mësimdhënien e tyre më së shumti bazuar në filozofinë progresiviste dhe më së pakti në filozofinë esencialiste.

REFERENCA

- Ainslie, G., 2001. *Breakdown of Will*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Arnold, N. S., 1990. *Marx's Radical Critique of Capitalist Society*, Oxford: Oxford University Press.
- Bates, E., Ellman, J., Johnson, M., Karmiloff-Smith, A., Parisi, D., and Plunkett, K., 1998. "Innateness and Emergentism", in Bechtel and Graham (eds.) 1998.
- Bechtel, W., 1985. "Contemporary Connectionism: Are the New Parallel Distributed Processing Models Cognitive or Associationist?", *Behaviorism*, 13: 53–61. (See Skinner 1977.)
- Bechtel, W., and Abrahamsen, A., 1991. *Connectionism and the Mind*, Oxford: Blackwell.
- Bechtel, W., Abrahamsen, A., and Graham, G., 1998. "The Life of Cognitive Science", in E. Bechtel and G. Graham (eds.) 1998
- Black, M., 1973. "Some Aversive Responses to a Would-be Reinforcer", in H. Wheeler (ed.), *Beyond the Punitive Society*, San Francisco: E. H. Freeman, pp. 125–34.
- Breëer, E. F., 1974. "There is No Convincing Evidence for Operant or Classical Conditioning in Adult Humans", In W. Weiner and D. Palermo (eds.), *Cognition and Symbolic Processes*, Hillsdale, N. J.: Earlbaum.
- Chomsky, N., 1959. "Review of Verbal Behavior," *Language*, 35: 26–58.
- Coëie, F., 1998. *Èhat's Èithin: Nativism Reconsidered*, Oxford: Oxford.
- Day, E., 1976. "The Case for Behaviorism," in M. Marx and F. Goodson (eds.) *Theories in Contemporary Psychology*, New York: Macmillan, pp. 534–45.
- Dennett, D., 1978. "Èhy the Laë of Effect W
- ill Not Go Aëay", in D. Dennett (ed.) *Brainstorms*, Cambridge, MA.: MIT Press/Bradford Books, pp. 71–89.
- Fisher, Tyrus, 2011, "Quine's Behaviorism and Linguistic Meaning: Èhy Quines Behaviorism Is Not Illicit", *Philosophia: Philosophical Quarterly of Israel*, 39(1): 51–59.
- Fulkerson, R. (2000). Four philosophies of composition. In E. Corbett, N. Myers and G. Tate (Eds.), *The èriting teacher's sourcebook* (4th ed.) (pp. 3–8). New York: Oxford University Press.
- Fodor, J., 1981. "The Present Status of the Innateness Controversy", in J. Fodor (ed.), *Representations*, Cambridge, MA.: MIT Press/Bradford Books, pp. 257–316.

- Føllesdal, Dagfinn, 2011, “Developments in Quine's Behaviorism”, *American Philosophical Quarterly*, 48(3): 273-282.
- Ganly, S. *Educational philosophies in the classroom*. Retrieved February 2, 2008, from Associated Content website: <http://www.associatedcontent.com>
- Gallistel, C. R., 1990. *The Organization of Learning*, Cambridge, MA.: MIT Press.
- Graham, G., 1984. “Sensation and Classification”, *Behavioral and Brain Sciences*, 7: 558–559.
- Graham, G. and Horgan, T., 2000. “Mary, Mary, Quite Contrary”, *Philosophical Studies*, 99: 59–87.
- Graham, G. and Valentine, E., 2004. *Identifying the Mind: Selected Papers of U. T. Place*, Oxford: Oxford University Press.
- Graham, G., Horgan, T., and Tienson, J., 2009. “Phenomenology, Intentionality, and the Unity of Mind”, in A. Beckermann and B. McLaughlin (eds.), *Oxford Handbook of Philosophy of Mind*, Oxford: Oxford University Press, pp. 512–37.
- Hempel, C., 1949. “The Logical Analysis of Psychology”, in H. Feigl and W. Sellars (eds.), *Readings in Philosophical Analysis*, New York: Appleton-Century-Crofts, pp. 373-84.
- Honig, E. and J. G. Fetterman (eds), 1992. *Cognitive Aspects of Stimulus Control*, Hillsdale, N. J.: Erlbaum.
- Horgan, T., Tienson, J. and Graham, G., 2006. “Internal-world Skepticism and the Self-Presentational Nature of Phenomenal Consciousness”, in U. Kriegel and K. Illiford (eds.), *Self-Representational Approaches to Consciousness*, Cambridge, MA: MIT, pp. 41-61.
- Kane, R., 1996. *The Significance of Free Will*, Oxford: Oxford.
- Leiteberg, H. (ed.), 1976, *Handbook of Behavior Modification and Behavior Therapy*, Englewood Cliffs, N. J.: Prentice-Hall.
- Levy, N., 2007. *Neuroethics*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Mackenzie, B., 1977. *Behaviorism and the Limits of Scientific Method*, London: Routledge & Kegan Paul.
- Mahoney, M. J., 1974. *Cognition and Behavior Modification*, Cambridge, MA: Ballinger.
- Maloney, C., 1991. “Connectionism and Conditioning”, In T. Horgan and J. Tienson (eds.), *Connectionism and the Philosophy of Mind*, Dordrecht: Kluwer, pp. 167–95.
- Manning, Richard N., 2014, “Sellarsian Behaviorism, Davidsonian Interpretivism, and First Person Authority”, *Philosophia: Philosophical Quarterly of Israel*, 42(2): 433–456.
- Meehl, P. E., 1978. “Theoretical Risks and Tabular Asterisks: Sir Karl, Sir Ronald, and The Slow Progress of Soft Psychology”, *Journal of Consulting and Clinical Psychology*, 46: 806–34.
- Meichenbaum, D., 1977. *Cognitive-Behavior Modification*, New York: Plenum.
- Melser, D., 2004. *The Act of Thinking*, Cambridge, MA: MIT Press.
- Montague, R. and Berns, G., 2002. “Neural Economics and the Biological Substrates of Valuation”, *Neuron*, 36: 265–284.
- Nestler, E. J. and Malenka, R. C., 2004. “The Addicted Brain”, *Scientific American*, 290: 78–85.
- Ornstein, A. and Daniel Levine. (2003). *Foundations of education* (8th ed.). Boston: Houghton Mifflin Company.

- O'Donnell, J., 1985. *The Origins of Behaviorism: American Psychology, 1870–1920*. New York: NYU Press.
- Pedagogy. (n.d.). *Wordnet 3.0*. Retrieved February 3, 2008, from Dictionary.com website: <http://dictionary.reference.com/browse/pedagogy>
- Place, U. T., 2000. “The Causal Potency of Qualia: Its Nature and Its Source”, *Brain and Mind*, 1: 183–192. Reprinted in Graham and Valentine 2004.
- Quine, E., 1960. *Word and Object*, Cambridge, MA.: MIT Press.
- Rachlin, H., 2000. *The Science of Self-Control*, Cambridge: Cambridge University Press.
- Rey, G., 1997. *Contemporary Philosophy of Mind: A Contentiously Classical Approach*, Oxford: Blackwell.
- Rescorla, R. A., 1990. “The Role of Information about the Response-Outcome Relationship in Instrumental Discrimination Learning,” *Journal of Experimental Psychology: Animal Behavior Processes*, 16: 262–70.
- Rimm, D. C. and Masters, J. C., 1974. *Behavior Therapy: Techniques and Empirical Findings*, New York: Academic Press.
- Roberson, T. (2000 September 29). Philosophy of philosophy: making the connection between philosophy and pedagogy for preservice teachers (Paper presented at Meeting for the Society for Philosophy and History of Education, Biloxi, MS 2000)
- Robinson, T. E. and Berridge, K. C., 2003. “Addiction” *Annual Review of Psychology*, 54: 25–53.
- Roediger, H. and Goff, L., 1998. “Memory”, in Bechtel and Graham (eds.) 1998.
- Ross, D., Sharp, C., Vuchinich, R., Spurrett, D., 2008. *Midbrain Mutiny: The Picoeconomics and Neuroeconomics of Disordered Gambling*, Cambridge, MA: The MIT Press.
- Schwartz, B. and Lacey, H., 1982. *Behaviorism, Science, and Human Nature*, New York: Norton.
- Skinner, B. F., 1948. *Walden Two*, New York: Macmillan.
- Smith, L., 1986. *Behaviorism and Logical Positivism: A Reassessment of Their Alliance*, Stanford, CA: Stanford University Press.
- Stich, S., 1984. “Is Behaviorism Vacuous?,” *Behavioral and Brain Sciences*, 7: 647–649.
- Tolman, E. C., 1938, “The Determiners of Behavior at a Choice Point,” *Psychological Review*, 45: 1–41.
- Tripodi, Paolo, 2011, “Revisiting the Myth of Jones: Sellars and Behaviorism”, *History of Philosophy Quarterly*, 28(1):85–105.
website: <http://vnweb.hwwilsonweb.com.proxy.lib.odu.edu/hww/jumpstart.jhtml?recid=0bc05f7a67b1790e1e9c442f93fe94fd3dd814f5b54d3854a715b6e9cc14f3538d830ddf5e8d15a6&fmt=H>
- Wittgenstein, L., 1953/1968. *Philosophical Investigations*, trans. G. E. M. Anscombe, Oxford: Basil Blackwell.
- Zuriff, G., 1985. *Behaviorism: A Conceptual Reconstruction*, New York: Columbia University Press.

SFIDA E RRJETEVE PROFESIONALE MES RISISË DHE TRADITËS NË SISTEMIN PARAUNIVERSITAR

MP. Besjona Dunga (Avdia)

Specialiste në ZV, Kukës

Dr. Blerta Avdia

Kolegji Universitar "LOGOS", Tiranë

ABSTRAKT

Arsimi luan rol kryesor në zhvillimin e shoqërisë dhe është një ndër fushat që influencon në ndryshimet politike, ekonomike, sociale, mjedisore të një vendi. Historia e zhvillimit arsimor në Shqipëri ka pësuar luhatjen e tij paralelisht me periudhën e tranzicionit. Kjo periudhë nxjerr në pah një sërë problematikash të tilla si: metodologjinë e mësimdhënies, teknikat e përdorura gjatë një ore mësimi, përshtatje me teknologjinë dhe nivelin i ulët i kualifikimeve të stafëve pedagogjike etj. Këto bënë të domosdoshëm kualifikimin e stafëve pedagogjike, ku në këtë kuadër u krijuan dhe rrjetet profesionale.

Aktualisht rrjetet profesionale gjenden përballë sfidës se të qenit *risi apo vijimësi e shkëmbimit të eksperiencave?*

Qëllimi i kërkimit është evidentimi i risisë së rrjeteve profesionale në kuadrin e zhvillimit profesional; sfidën që ka për të bërë diferencën mes formave ekzistuese të zhvillimit profesional, problematikën dhe mundësitë e zgjidhjes. Nëse rrjetet profesionale janë risi apo vijimësi e traditës së shkëmbimit të eksperiencave mes mësueseve do të kuptohet gjatë trajtimit të punimit.

Metoda: Për realizimin e punimit u përdoren metodat analizës, krahasuese, intervistës etj. Përmes analizës së evoluimit të zhvillimit profesional të mësueseve në vite, duke evidentuar shkakun dhe pasojën e këtij evoluimi; realizimi i 100 intervistave me mësuesit në arsimin parauniversitar në Qarkun Kukës që kanë punuar në periudha të ndryshme në arsimin bazë për të identifikuar risinë e rrjeteve profesionale në zhvillimin profesional të tyre; në krahasimin e ndryshimit të perceptimit nga institucionet përgjegjëse (përmes legjislacionit) dhe vetë

mësuesit rëndësinë që ka zhvillimi profesional i tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Disa nga gjetjet e kërkimit janë:

1. Rrjetet profesionale nuk kanë të drejtë të japin kredite për mësuesit që trajnojnë, duke ulur interesin e mësueseve për ti ndjekur ato.
2. Takimet e rrjetit profesional zakonisht bëhen pas mësimit dhe mësuesit janë të lodhur dhe humbin interesin për zhvillimin profesional, pjesëmarrjen në diskutime etj.
3. Një pjesë e mësueseve janë të vjetër dhe nuk përdorin teknologjinë, kjo vështirëson shpërndarjen e informacionit dhe realizimin e trajnimeve online.
4. Rrjetet profesionale kanë ekzistuar më parë, por në forma të ndryshme jo kaq të konsoliduara.
5. Risia e rrjeteve profesionale është: a) kalimi nga kualifikimi brendshëm institucional, në kualifikimi përtej institucionit b) rritja e bashkëpunimit mes mësueseve të të njëjtit profil në drejtim të përmirësimit të metodologjisë së mësimdhënies.

Punimi mbyllet me përfundime dhe rekomandimet.

Fjalët kyçe: Arsimi, rrjetet profesionale, shkëmbimi i eksperiencave, staf pedagogjik,

1. HYRJE. GJENDJA/PANORAMA E NIVELIT PROFESIONAL TË MËSUESEVE NË ARSIMIN PARA UNIVERSITAR

Arsimi është një ndër shtyllat kryesore që influencon zhvillimin sociale dhe ekonomik të një vendi. Ndaj, reforma në zhvillimin arsimit merr një rëndësi të veçantë. Roli i arsimit është të përgatisë të rinjtë që zotërojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkohen nga shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe në mirëqenien vetjake e të shoqërisë dhe të përballët në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Megjithatë që të realizohet kjo kërkohet që të kemi mësues të kualifikuar dhe pyetja që ngrihet është: *Si paraqitet niveli i kualifikimit profesional të mësueseve? Sa përputhet përgatitja profesionale me standardet e zhvillimit profesional të mësueseve në shkollat shqiptare?*

Në bazë të Raportit Kombëtar “Identifikimi i nevojave për Trajnimin e Drejtuesve dhe Mësuesve të Shkollave në Arsimin Para universitar” evidentoi faktin se mësuesit dolën më rezultate të ulta në fushën e zhvillimit profesional, ku 35% e tyre kishin nivelin e vlerësimit 1(një) dhe 2 (dy). Rezultatet më të larta i kanë arritur mësueset femra kundrejt rezultateve të mësuesve meshkuj; Nëndrejtorët janë kategoria e punonjësve arsimorë që kanë rezultate më të larta, krahasuar me drejtorët; Rezultatet më të larta i kanë arritur gjimnazet, krahasuar me shkollat e tjera. Kjo vlen si për vlerësimin e përgjithshëm, po ashtu edhe për katër fushat e vlerësimit.¹

Këto janë tregues të rëndësishëm që mësuesit e shkollave shqiptare kanë nivel të ulët të zhvillimit profesional. Në këtë mënyrë ky raport shërbeu si një instrument për hartografimin e nevojave për zhvillim profesional të mësueseve për çdo shkollë, krijimin e një baze të dhënash dhe evidentoi nevojën për kualifikimin e mësueseve.

Në kuadër të rritjes profesionale të mësuesve u krijuan dhe rrjete profesionale nga MASR me udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017. Rrjete profesionale kanë për qëllim zhvillimin profesional të punonjësve të institucioneve arsimore përmes informimit, këshillimit, trajnimit, shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve të natarëve të tij për tematikat e punës së tyre të përditshme.²

Rrjetet profesionale do të luajnë rolin kyç në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punonjësve në institucionin arsimor, do të shërbejnë si një instrument për identifikimin e problematikave dhe sugjerimin e zgjidhjeve praktike në funksion të procesit të mësimdhënies dhe të nxënies.

¹ IZHA “Identifikimi i Nevojave për Trajnimin e Drejtuesve dhe Mësuesve të Shkollave në Arsimin Parauniversitar” Raport Kombetar, Tiranë 2016, fq .10

² MASR “Për funksionin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor” nr.1, dt. 20.01.2017

2. METODA E STUDIMIT

Për realizimin e punimit u përdoren metodat në funksion të qëllimit të temës “ *evidentimi i rrisë së rrjeteve profesionale në kuadrin e zhvillimit profesional; sfidën që ka për të bërë diferencën mes formave ekzistuese të zhvillimit profesional, problematikën dhe mundësitë e zgjidhjes. Nëse rrjetet profesionale janë risi apo vijimësi e traditës*”. Metoda përshkruese për tu njohur me rolin e rrjeteve profesionale dhe pasqyrimin e situatës së zhvillimit profesional në arsimin parauniversitar; metoda e analizës për interpretimin e gjetjeve nga intervistat, metoda krahasuese për krahasimin e ndryshimit të perceptimit nga institucionet përgjegjëse (përmes legjislacionit) dhe vetë mësuesit rëndësinë që ka zhvillimi profesional i tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe nxënies. Forma e grumbullimit të të dhënave ishte nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjorë dhe intervistës së 100 mësuesve në arsimin para universitar në Qarkun e Kukësit që kanë punuar në periudha të ndryshme në arsimin bazë për të identifikuar rrisin e rrjeteve profesionale në zhvillimin profesional të tyre.

3. SFIDA E RRJETEVE PROFESIONALE MES RISISË DHE TRADITËS NË ARSIMIN PARA UNIVERSITAR

Në sistemin arsimor shqiptar gjithmonë i është kushtuar rëndësi zhvillimit profesional të mësuesit. Ky proces, i cili fillon në auditorët e universitetit me praktikat profesionale, marrja e licencës për ushtrimin e profesionit³, trajnimin e vazhdueshme brenda dhe jashtë institucionit arsimor, kualifikimet 5, 10, 20 vjeçare që realizojnë mësuesit.

Për të realizuar sa më mirë procesin e mësimdhënies dhe të nxënies janë përdorur metoda dhe teknika të ndryshme si: shkëmbimi i eksperiencës mes mësuesit të vjetër dhe të rinj, organizimi i orëve të hapura, mësimave autodidakte të mësuesve, miniteste në orën e mësimin për të evidentuar problematikën që ka mësuesi, kurse për kualifikim pas punës apo ndjekja e shkollës part-time.

Pavarësisht formave të ndryshme të kualifikimeve të mësuesve në arsimin para universitar, ato asnjëherë nuk kanë arritur të shpëtojnë nevojën për zhvillim profesional të tyre.

³ Ligji nr. 10171 , date 22.10.2009 Neni 5, Profesionet e rregulluara f.4

Arsyeja e nevojës për kualifikime është e lidhur ngushtë me zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe teknologjisë. Profilizimi i tregut të punës kërkon punonjës me aftësi profesionale, komunikimi dhe etike nga njëra anë dhe stafe pedagogjike të kualifikuar që përgatisin këtë kategori punonjësit që kërkohen nga tregu i punës në anën tjetër.

E thënë ndryshe jo vetëm nxënësit që dalin nga bankat e shkollës duhen të pajisen me aftësi, por dhe mësuesit që përgatisin nxënësit/profesionistët duhet të kenë njohuri, standarde/nivele kualifikimi të njëjte me mësuesit që punojnë në hapësirën evropiane.

Rrjetet profesionale janë një instrument i mirë për arritjen e zhvillimit profesional të mësueseve në arsimin para universitar. Megjithatë rrjetet profesionale duket sikur nuk është diçka e panjohur më parë nga mësuesit. Disa nga format që përdor Rrjeti Profesional për të realizuar qëllimin e tij ishin dhe më parë si: shkëmbimi i përvojave mes mësuesve, trajnimi, këshillimi apo diskutimit mes ekipeve lëndore etj.

Shikuar në këtë këndvështrim rrjetet profesionale janë mes sfidës për të evidentuar risinë që sjellin në zhvillimin profesional të mësueseve pa rënë në përsëritje.

Për të evidentuar këtë u realizuan 100 intervista me mësues që u takojnë periudhave të ndryshme të punës së tyre, të gjitha janë të gjinisë femra, të moshës nga 68 vjeç, 31 vjeç, 30 vjeç, 35 vjeç, 40 vjeç, 20 nga mësueset e intervistuar ishin drejtuese të rrjetit profesional. Kjo përzgjedhje është bërë për të shikuar evoluimin e nevojave për zhvillim profesional në kohë të ndryshme. Mësueset e intervistuar u përkasin këtyre periudhave: a) 1965-2005; b)2008-2018; c)1995-2018; 2023-2025.

Në bazë të përgjigjeve të dhëna nga mësuesit evidentojmë se me kalimin e viteve ka ndryshuar dhe forma e zhvillimit profesional të mësueseve. Ndryshime të cilat i kemi të paraqitura në tabelë. Ajo çfarë identifikohet është fakti se me zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe teknikës janë perfeksionuar/avancuar/ndryshuar format, teknikat e zhvillimit të vazhdueshëm profesional si p.sh. trajnimet në distancë, shkëmbimi i informacionit përmes emaileve etj.

Tab. 1. Zhvillimi në kohë i mënyrës së kualifikimit dhe vlerësimit të mësuesve në arsimin para universitar

Periudha e punës së mësuesve	Kualifikimi	Vlerësimi	Mbështetja	Synimet
1965-2005	Çdo 5 vjet provim kualifikimi	- Mësues i dalluar - Mësues i popullit - Mësues i merituar	- Institutet pedagogjike - Universiteti i Tiranës - Shkolla e mesme pedagogjike - Shkolla part-time - Ministria e Arsimit	- Ushtrimin e profesionit - Në sistemin e kualifikimeve - Ne zhvillimin e vazhdueshëm profesional
2008- dhe 2018	- Bachelor - Master - Çdo 5 vjet provim kualifikimi - Trajnime	- Diploma në Mësuesi - Mësues i Kualifikuar - Mësues Specialist - Mësues Mjeshtër⁴ - Certifikata me apo pa kredite	- Universitet - MASR - IZHA - Qendrat e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin - Institucionet Arsimore	

⁴ Ligj Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 57,58, 59.

2012-2018	• Bachelor • Master • Çdo 5 vjet provim kualifikimi • Trajnime • Licenca • Rrjetet profesionale	• Diploma në mësuesi • Stazhi i Punës • Certifikata e Licencës • Mësues i Kualifikuar • Mësues Specialist • Mësues Mjeshtër • Certifikata me apo pa kredite	• Universitet • AKP • MASR • IZHA • Qendrat e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin • Institucionet Arsimore
1995-2018	• Sistemi katër vjeçar • SHPU • Çdo 5 vjet provim kualifikimi • Trajnime • Licenca • Rrjetet profesionale	• Diploma në mësuesi • stazhi i Punës • Certifikata e licencës • Mësues i Kualifikuar • Mësues Specialist • Mësues Mjeshtër • Certifikata me apo pa kreditë	• Universitet • AKP • MASR • IZHA • Qendrat e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin • Institucionet Arsimore

2023-2025	• Bachelor • Master • Çdo 5 vjet provim kualifikimi • Trajnime • licenca • Rrjetet profesionale	• Diploma në mësuesi • stazhin i Punës • Certifikata e licencës • Mësues i Kualifikuar • Mësues Specialist • Mësues Mjeshtër • Certifikata me apo pa kredite	• Universitet • AKP • MASR • Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit para universitar (ASCAP) • Qendrat e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin • Institucionet Arsimore	
-----------	--	--	--	--

Burimi: të dhëna të përpunuar nga autorët të nga intervistat dhe shqyrtimi i dokumentacionit ligjor mbi zhvillimin profesional të vazhdueshëm.

Në bazë të përgjigjeve (rezultateve) që ata dhanë, u arrit në konkluzion që risia e rrjetet profesionale është:

- Kalimi nga një kualifikim i brendshëm institucional, shkëmbimit të përvojave mes mësuesve brenda institucionit në kualifikim apo shkëmbim përvoja më të gjërë (jashtë institucionit).
- Rritja e bashkëpunimit mes mësuesëve të së njëjtës lëndë (gjuhë-letërsisë apo gjeografisë) në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe metodologjisë së mësimdhënies.
- Hartimi i një plani vjetor të përbashkët veprimi mes mësuesëve të rrjeteve.
- Marrje e informacionit dhe interpretim më të mirë dhe të qartë të vendimeve, udhëzimeve të dala nga MASR.

- Lehtësim i komunikimit dhe shpejtësi të informacionit, duke eliminuar hierarkinë. Drejtuesit e rrjetit kanë mundësi komunikimi direkt me IZHA, QSHA për çështje të ndryshme pa u vonuar në kohë.
- Identifikimit i problematikës nga baza (mësuesit) dhe gjetja e mundësive të zgjidhjes së tyre brenda rrjetit.

4. GJETJET DHE DISKUTIMI

Gjatë analizës së rëndësisë që kanë Rrjetet profesionale u bënë dhe disa gjetje dhe u identifikuan disa problematika, zgjidhja e të cilave do të ndihmonte në efektivitetin e rolit të funksionit të rrjeteve profesionale në kualifikimin e mësuesëve në arsimin para universitar.

Gjetjet janë:

- Rrjetet Profesionale nuk japin kredite dhe mësuesit krahas takimeve të rrjetit u duhet të plotësojnë dhe kriteret e fitimit të një krediti në vit.⁵ Ky fakt i detyron mësuesit t'u drejtohen Qendrave të Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, për zhvillimin profesional të tyre përsëri. *Ku është vlera e rrjeteve profesionale në këtë rast?* Takimet mes rrjetit profesional në këtë drejtim ata e cilësojnë kohë të humbur, një detyrim të shtuar dhe nga ana tjetër rrjete profesionale e zbehin funksionin e tyre.
- Takimet e rrjeteve profesionale organizohen pas orës së mësimi. Mësuesit janë të lodhur duke humbur interesin për zhvillimin e tyre profesional. Kjo dëmton rritjen e vazhdueshme profesionale të mësuesëve që japin mësim në arsimin para universitar.
- Problem në përdorimin e teknologjisë. Një pjesë e mirë e mësuesëve në arsimin para universitar janë të vjetër dhe nuk përdorin dot teknologjinë në procesin e mësimdhënies, apo pjesëmarrjen në trajnimet online, përdorimin e email-it, skype, zoom etj.

⁵ MASR “Për funksionin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor” nr.1, dt. 20.01.2017, neni 6, pika 4

MASR “ Udhëzimi nr.16. datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor “ neni 3,4, 6.

- Infrastruktura fizike është një problem që cenon realizimin e një forme të re të zhvillimit profesional siç janë: trajnimet online, komunikimet mes rrjetit në shpërndarjen e informacionit apo dhe diskutimit për një çështje të caktuar.
- Rrjetet profesionale në vetvete kanë ekzistuar më parë, por në forma të ndryshme

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në fund konkludojmë që rrjetet profesionale është një vazhdimësi e traditës së kualifikimit të brendshëm institucional, por që në ditët e sotme prezantohet si risi. Nisur nga ky konkluzion rekomandojmë që:

- Krijimi i mundësisë që rrjetet profesionale të japin kredite. Kjo do të ndikojë në plotësimin e funksioneve të rrjeteve profesionale dhe mësuesit do ti ndjekin më me interes.
- Të krijohet një grafik pa cenuar procesin mësimor të takimeve të anëtareve të Rrjetit Profesional, ku mësuesit janë të fokusuar tek ky takim.
- Të krijohet mundësia e trajnimeve pa pagesë, kualifikimeve të brendshme të mësuesëve të vjetër që të përdorin teknologjinë në funksion të punës.
- Të krijohen/pajisen laboratorët kompjuterike në çdo shkollë dhe rrjet të vazhdueshëm interneti.

Të gjitha këta do të ndikojnë në evidentimin e rrisë së rrjeteve profesionale në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesëve. Në rast të kundërt ata do të mbetën risi vetëm në letër.

REFERENCA

- IZHA “Identifikimi i Nevojave për Trajnimin e Drejtuesve dhe Mësuesve të Shkollave në Arsimin para universitar” Raport Kombëtar, Tiranë 2016
- MASR “Për funksionin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor” udhëzimi nr.1, dt. 20.01.2017.
- MASR “ Udhëzimi nr.16. datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor “ neni 3,4, 6.
- Ligj Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 57,58, 59.
- Ligji nr. 10171 , date 22.10.2009 neni 5, Profesione të rregulluara f.4

- MASR “Për funksionin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimor” nr.1, dt. 20.01.2017, neni 6, pika 4
- MASH “ Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor para universitar“ Tiranë, 2013
- IZHA “Standardet Profesionale të Formimit Të Përgjithshëm Të Mësuesit Dhe Standardet Profesionale të Mësuesit sipas Fushave Lëndore” Tiranë 2016
- AKAFP “Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ”

TRAJTIMI I FËMIJËVE AUTIKË ME PROGRAME TË EDUKIMIT INDIVIDUAL

Prof. Asoc. Dr. Edo Sherifi

edo_sherifi@yahoo.com

Departamenti Pedagogji- Psikologji, Kolegji Uuniversitar "LOGOS"

ABSTRAKT

Autizmi është një çrregullim neurobihejvioral që karakterizohet nga dëmtime në ndërveprimin social, në komunikim dhe në shfaqjen e sjelljeve steriotipike e përsëritëse të interesave dhe aktivitetit.

Qëllimi i studimit. Të vlerësojë dhe argumentojë efektivitetin e shërbimit psikosocial në aftësimin dhe rehabilitimin e fëmijëve autikë me anë të programeve psiko-edukative, teknikave dhe metodave shkencore..

Metodologjia. Për realizimin e studimit janë përdorur, intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë dhe faktorë që kanë qasje me fëmijët autike. Fokus grupi me specialistë të fushës që krijojnë grupin multidisiplinar. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë me gril vertikal me fëmijët që përbëjnë kampionin e studimit

Rezultatet. Me testin Soner u provua se mosha mendore e fëmijëve të trajnuar u rrit 4 vjeç. Mosha mendore e fëmijëve të pa ushtruar u rrit 2.5-3.1 vjeç. Arritjet e 48 fëmijëve autikë, të trajtuar me Programe Psikosociale Individuale, në sferat e rehabilituara të tyre si vijon: Paraqitja grafike e arritjeve të 48 fëmijëve autikë që u testuan tregon se: Në aftësimin konjitiv 35% arrijnë të progresojnë me ndihmë verbale. Aftësimi gjuhësor është dimension i më i vështirë për të progresuar fëmijët autikë. Arritja më e madhe në këtë sferë aftësimi është : 35 % me ndihmë verbale, niveli i tretë i shkallës Likert. Arritjet e fëmijëve të ushtruar në sferën socializuese rezulton të jenë 25% me ndihmë verbale dhe 25% pjesërisht. Sjelljet rriskuese tek fëmijët e ushtruar përmirësohen 30 % me ndihmë verbale dhe 25% përmirësohen plotësisht

Përfundime. Programet psikoedukative përshpejtojnë zhvillimin psikosocial e psikofizik të fëmijëve me autizëm. Trajtimi dhe rehabilitimi i fëmijëve me çrregullime të spektrit autik, me teknika dhe Programe profesionale, është i vështirë por jo i pamundur. Trajtimi psikologjik i fëmijëve autikë me Programe të Edukimit Individual (PEI) argumentoi përshpejtimin e progresit mendor të fëmijëve autikë.

Fjalët kyçe: Autizëm, rehabilitim, programe, metoda, shërbim psikologjik

I. HYRJE

Autizmi është një çrregullim kompleks i neurozhvillimit që karakterizohet nga dëmtime në fushat e marrëdhënieve sociale, komunikimit dhe sjelljes. (Micheal D. Poëers 2000; Debora Fein & Michel Dunn, 2007; Lynnan, C. Brennan. 2010)

Autizmi shfaqet me çrregullime të rënda të komunikimit në marrëdhëniet sociale dhe sjellje me natyrë përsëritëse e stereotipe. Ai shpesh shoqërohet me prapambetje mendore. Personat me autizëm po shtohen vitet e fundit.

Nga studimet e zhvilluara rezulton se përhapja e çrregullimeve autike është në rritje: Në vitin 1943 raporti i lindjeve të fëmijëve autikë ishte 1/25000, në vitin 1980 1/10000, rreth viteve 2000 lindjet e fëmijëve me autizëm ishin 1/1000, pas vitit 2004 1/150, në vitin 2008 1/88, në vitin 2015 1/68, në vitin 2019 1/55 dhe në vitin 2021 1/54 %. Raporti vajza-djem është 1 me 4.

Në Shqipëri nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi numrin e përgjithshëm të fëmijëve me autizëm. Për shkak të mungesës së studimeve mbi paaftësinë është e vështirë të përcaktohet me saktësi numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara. Mbledhja e statistikave është kufizuar vetëm tek ata të cilët përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar dhe shërbimet në qendrat publike ditore apo rezidenciale. Rada. A. (2013).

Studimi mbi efektivitetin e shërbimit psikosocial në vlerësimin dhe rehabilitimin e fëmijëve autikë u realizua gjatë periudhës: 2021-2024, në Qendrat Komunitare të Shëndetit Mendor Nr.1 dhe Nr.3. Target grupi i studimit janë 48 fëmijë autikë, nga të cilët, 24 janë ushtruar me programe rehabilitimi (PEI), dhe 24 janë përfshirë në grupin e kontrollit. Studimi përfshin edhe një studim

rasti, ku me anë të testit SONE-R vlerësohet mosha mendore e dy fëmijëve autikë të trajtuar me Programe Edukative Individuale(PEI) dhe dy fëmijë të pa trajtuar me këto programe.

Studimi trajton efektivitetin e shërbimit psikosocial në aftësimin dhe rehabilitimin e fëmijëve me çrregullime të spektrit autik (CAS), nëpërmjet aplikimit të PEI, teknikave dhe metodave shkencore psikoedukative. Në studim jepet një panoramë mbi simptomat e shfaqjes, hipotezat e shkaqeve të lindjes dhe funksionimit të çrregullimeve të spektrit autik. Në studim përfshihen metodat dhe terapitë më efikase që trajtohet autizmi aktualisht në vendet perëndimore.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Çfarë është autizmi?

Autizmi është një çrregullim neurobiheviotal që karakterizohet nga dëmtime në ndërveprimin social, në komunikimin verbal, si dhe në shfaqjet e sjelljeve stereotipike dhe përsëritëse lidhur me interesat dhe aktivitetet. (ÇSA)

Sipas DSM-IV (APA, 1994) çrregullimet e spektrit të autizmit (ÇSA) përfshijnë:

Çrregullimin autik ose autizmin klasik; Çrregullimin e Aspergerit; Çrregullimin e Rett-it; Çrregullimin dizintegrativ të fëmijërisë; Çrregullimin pervaziv të zhvillimit. Çrregullimet e tjera të ÇSA konsiderohen variacione të temës së autizmit.

Disa karakteristika dalluese, të cilat janë të ndryshme për fëmijë të ndryshëm.

Fëmijët autikë kanë shumë vështirësi të komunikojnë, ose kanë të folur stereotipike. Kur ushtrohen me programe: Përdorin ekolalinë. Mësojnë më lehtë emrat e objekteve se sa të njerëzve. Nuk i lidhin dot konceptet me njeri tjetrin. Kanë vështirësi të kuptojnë gjuhën. Kanë mungesë empatie.⁶ Fëmijët autikë parapëlqejnë të qëndrojnë vetëm. Kanë mungesë të shprehjes së reciprocitetit emocional. Kanë vështirësi të realizojnë kontaktin me sy. Nuk realizojnë buzëqeshje. Kryejnë

⁶Anderson, G. M., Hoshino, Y. (2015). Neurochemical Studies of Autism. In F.R. Volkmar , R. Paul, A. Klin, & D. Cohen, *Handbook of Autism and Pervasive Developmental Disorders, Volume 1* (p.430-464)Neë Jersey:John Wiley & Sons, Inc.

gjeste të pa pëlqyera. Kryejnë sjellje vetë dëmtuese. Kanë vështirësi për të realizuar një bashkëpunim. Manifestojnë izolim social të theksuar.⁷

Fëmijët autikë nuk reagojnë ndaj thirrjes së emrit të tij, kjo është një shenjë paralajmëruese.⁸ Kur fëmija nuk frikësohet nga personat e panjohur, ende pa i mbushur 1 vjeç dhe nuk vë në vëmendje largimin e së ëmës apo personit të afërt nga vendqëndrimi, prindi duhet të shqetësohet.⁹ Studimet vënë në dukje se incidentet e ndodhura gjatë shtatzënisë apo lindjes, janë më të shpeshta tek fëmijët autikë se tek të tjerët. Këto incidente mendohet se kanë një rol në zhvillimin e këtij çrregullim.¹⁰ Në disa raste shihet një lidhje e fortë midis çrregullimeve autike dhe afeksioneve gjenetike si phenylketonurie, sclerosetube reuse,neurofibromatose, fragile X

Çfarë e shkakton Autizmin?

Shkaqet e autizmit mbeten të papërcaktuara saktësisht. Të dhënat e mbledhura nga shkencat neurologjike dhe nga biologjia tregojnë se ato kanë kryesisht origjinë neurologjike ose gjenetike. Në 50% të rasteve, duket se kemi të bëjmë me një prirje të trashëgueshme. Trajtimi ka për qëllim zhvillimin maksimal të potencialeve të personit.

A.-Origjina gjenetike, B.-Autizmi i shkaktuar nga faktorë mjedisorë. Kërkimet janë përqendruar në faktorët gjenetikë; p.sh., Studimi : “Paris Autism Research International Sibpair study” është një bashkëpunim ndërkombëtar me objektiv: Identifikimin e faktorëve gjenetikë që ndikojnë në autizëm. Këto kërkime janë ndërmarrë nga Marion Leboyer në Francë dhe Christopher Gillberg në Suedi, si dhe shumë qendra klinike të specializuara në Francë, Suedi, Norvegji, Itali, Austri, Belgjike dhe SHBA.

Studimi “Identifikimi i gjeneve të reja që ndikojnë në autizëm dhe në sindromën Asperger”, i bërë nga grupi i Thomas Bourgeron në Institutin “Pasteur” u krye në vitin 2013. Ai identifikoi në dy

⁷ Acquarone, S. (2007). *Signs of Autism in Infants: Recognition and Early Intervention*. London: Karnac Books.Fq.35-2;79-94;140-153

⁸ Batten, A., Corbett, C., Rosenblatt, M., Eithers, L., & Yuille, R. (2006). *Autism and education: The reality for families today*. London: The National Autistic Society.Fq.3-20;34-45;128;141

⁹ Beytien, A.(2011). *Autism Every Day: Over 150 Strategies Lived and Learned by aProfessional Autism Consultant ëith 3 Sons on the Spectrum*. Arlington, Texas: Future Horizons.Fq.34-52;56-71;140-169

¹⁰ Gillberg C, Eïng L.(2000) Autism: Not an extremely rare disorder. Acta Psychiatr Scand 1999;99:399-406. Miles JH, Hillman RE. Value of a clinical morphology examination in autism. Am J Med Genet.Fq;91:245-53.

familje, mutacione të kombinuara me dy gjene të vendosura në kromozomin X që ndikojnë në formimin e sinapseve. Një mutacion shfaqet në gjenin neuroligin 4 (NLGN4). Në një familje ishin dy djem, njeri me autizëm dhe tjetri me sindromin asperger. Ky mutacion ka qenë i transmetuar nga nëna. Mutacioni i gjenit NLGN4 ndikon në formimin e një proteine, e cila ndikon në formimin e sinapseve gjatë zhvillimit të trurit.¹¹

Në një familje tjetër, dy vëllezër ishin të prekur, njeri nga autizmi dhe tjetri nga sindroma asperger për shkak të një mutacioni të ndodhur në gjenin neuroligin 3 (NLGN3). Këto gjene kodifikojnë informacionin në proteinat, të cilat ndodhen në nivelin e sinapseve. Studiuesit kanë identifikuar zona specifike në kromosome që mund të shkaktojnë sindromën e autizmit tek fëmijët.

Espertët vlerësojnë se mund të jenë 10-50 gene që dikojnë në shfaqjen e autizmit që lokalizohen në kromozomin X. Studiuesit kanë vëzhguar se është një gjen i kromozomit X si shkaktori më i madh i autizmit. Mutacionet në shumë gjene të kromozomit C janë shkaktarë të çrregullimeve autike ose të vonësës mendore.¹²

Studiuesit kanë evidentuar edhe gjenet e sindromit X të brishtë dhe sindromave, Ret, NLGN3, NLGN4, ARX, CDKL5 dhe SLC6A8. Njëkohësisht mendohet se sindroma shkaktohet edhe nga mjedisi. Pra fëmija lind normal, por bëhet autik.

Hipotezat e shkaqeve të autizmit të influencuara nga mjedisi janë: infeksione nga çrregullimi i metabolizmit, mosha e nënës mbi 35 vjeç, dhe e babait mbi 45 vjeç, ushqimet e gazuara, ushqimet me gluten, helmet, kimike dhe vaksina e trefishtë, që përdoren kundër fruthit, rubeolës dhe sarmonelës¹³.

Në vaksina ekziston Thimorosal. Ky produkt përmban një sasi të madhe të merkurit, element që ndikon në nerva. Trupi i autistëve nuk sekreton merkurin e tepërt, si rrjedhim shkaktohet çrregullimi i zhvillimit. Prej shumë kohësh thuhet se autizmi është shkaktuar nga “nënat e ftohta” si dhe nënat në karrierë, të cilat nuk u japin fëmijëve dashuri të mjaftueshme dhe kujdes. Kjo teori është hedhur

¹¹ Michael D. Poërs (2000). Fëmijët me autizëm (udhëzim për prindërit). Shtëpia botuese Fondacioni Fëmijët Shqiptarë “Domenick Scaglione”. ILAR. Tiranë, Fq. 3-42; 175-201; 272 – 293

¹² Debora Fein & Michel Dunn, (2007). Autizmi në klasën tuaj. Shtëpia botuese : Fondacioni Fëmijët Shqiptarë “Domenick Scaglione” Shypshkronja ILAR. Tiranë. Fq. 3-110; 112-195; 198-263.

¹³ Lynn, Cohen Brennan. (2010) Shtëpia botuese : Fondacioni Fëmijët Shqiptarë “Domenick Scaglione” Shtypshkronja ILAR. Tiranë. Fq. 2-55; 58-110; 120-242.

poshtë. Mjaft studime janë kryer e vazhdojnë të kryhen për të gjetur gene problematikë dhe disa zona të trurit që nuk funksionojnë normalisht.¹⁴

Studimet vënë në dukje se incidentet e ndodhura gjatë shtatzënisë apo lindjes, janë më të shpeshta tek fëmijët autikë se tek të tjerët. Këto incidente mendohet se kanë një rol në zhvillimin e këtij çrregullimi. Në disa raste shihet një lidhje e fortë midis çrregullimeve të spektrit të autizmit dhe afeksioneve gjenetike si phenylketonurie, scleroetu bereuse, neurofibromatose, fragileX¹⁵

III. METODOLOGJIA

Qëllimi i studimit. Të vlerësojë dhe argumentojë efektivitetin e shërbimit psikologjik në vlerësimin dhe rehabilitimin e fëmijëve autikë me anë të programeve psiko-edukative dhe teknikave terapeutike.

Instrumentet : Mbledhja dhe përdorimi i informacionit për personat me autizëm, u realizua me anë të instrumenteve të më poshtme:

- a. Vëzhgimi;
- b. Fokus grupi;
- c .Intervistat gjysmë të strukturuar.

Testet : që nxjerrin në pah rezultatet e autizmit janë: SCQ -Pyetësi i komunikimit “M-CHAT”; CAST–Testi i sindromit Asperger në fëmijëri ESAT-Ekzaminimi i hershëm i autizmit; BINET; GRIFTH. Nëpërmjet Testit SONE-R - përcaktova moshën mendore të fëmijëve autikë dhe rekomandova sipas moshës mendore Programet psikosociale (PEI) të fëmijëve autikë.

Limitet e studimit. Mendoj se studimi ka si limite : **a.** Numrin e reduktuar të kampionit të studimit; **b .numrin e institucioneve ku diagnostikohen fëmijët autikë.**

IV. REZULTATET E STUDIMIT


¹⁴ Saqellari.S.(2015).Autizmi në këndvështrimin psikoedukative.Sh. Botuese.Onufri.Tiranë.Fq15-63;65-120;127-166.

¹⁵ Dhamo.M.(2010).Çrregullimet dhe Terapitë e të folurit. Shtëpia botuese. Pegi.Fq.127-144.199-237.

Arritjet e 48 fëmijëve autikë, të trajtuar me Programe Psikosociale Individuale, në sferat e rehabilituara të tyre si vijon:


Paraqitja grafike e arritjeve të 48 fëmijëve autikë që u testuan tregon se: Aftësimin konjitiv u arrit 37% të progresojnë me ndihmë verbale. Aftësimi gjuhësor është dimensiononi që ka angazhuar me shume profesionalisht grupin multidisciplinar të kryesuar nga psikologu dhe punonjësi social për të progresuar fëmijët autikë me anë të Programeve të Edukimit Individual. . Arritja më e madhe në këtë sferë aftësimi është: niveli i tretë i shkallës Likert me 42 %. (Ndihmë Verbale) Arritjet e fëmijëve të ushtruar në sferën socializuese rezultojnë 25% me ndihmë verbale dhe 25% pjesërisht Sjelljet rriskuese tek fëmijët e ushtruar përmirësohen 30 % me ndihmë verbale dhe 25% përmirësohen plotësisht

Figura. Nr.1. Aftësimi konjitiv.




Në figurën nr.1 tregohet se Fëmijët autikë të trajtuar me PEI, arrijnë që 37% të rubrikave të Programit të zhvillimit konjitiv t'i realizojnë në nivelin Ndihmë verbale dhe 25 % e rubrikave t'i realizojnë plotësisht.

Figura Nr.2. Aftësimi Gjuhësor.



Në Grafikun, nr-3, fëmijët autikë arrijnë të kryejnë 42% të rubrikave në nivelin ndihmë verbale, 15% te rubrikave i realizojnë me ndihmë fizike dhe 15% të rubrikave në nivelin plotësisht.

Figura. Nr. 3. **Sjelljet Socializuese**




Në Grafikun nr. 3 tregohet se fëmijët autikë kryejnë 35 % e rubrikave në nivelin pjesërisht, 25 % të rubrikave të aftësisht social i kryejnë me ndihmë verbale.

V. STUDIM RASTI

Rezultatet janë si vijon:


Fëmijët e trajtuar me programe edukative rehabilituese.

Paraqitja grafike e moshës mendore të O.O Në vitin-2021-2.5vjec; 2024. 6.5vjec




O.O. Aftësimi konjitiv

Aspak.0%. Ndihmë fizike.5% . Ndihmë verbale.10% ; Pjesërisht.35% Plotësisht.50%.




O.O. Aftësimi gjuhësor

Aspak. 0%. Ndihmë fizike 5%. Ndihmë verbale 5% ; Pjesërisht 55 Plotësisht 30%




Paraqitja grafike e moshës mendore të S.S. Në vitin-2021- 2.5 vjeç; 2024. 6.3vjeç




S. S. Aftësimi konjitiv.

Aspak 0%,Ndihmë fizike10%,Ndihmë verbale. 20%. Pjesërisht 25%,Plotësisht 55%




S.S .Aftësimi gjuhësor.

Aspak 0%, Ndihmë fizike 10%, Ndihmë verbale 20 %, Pjesërisht 25% ,45% Plotësisht




Fëmijë të pa ushtruar me Programe të Edukimit Individual(PEI)

Paraqitja grafike e moshës mendore të I.L; Në vitin 2021 - 2.5 vjeç; 2024 - 3.1 vjeç;




I.L. Aftësimi konjitiv.

Aspak 69%,Ndihmë fizike31%,Ndihmë verbale 0%. Pjesërisht 0%.Plotësisht 0%.




I.L. Aftësimi gjuhësor


Aspak.55%, Ndihmë fizike35%. Ndihmë verbale 0%. Pjesërisht 0%.Plotësisht 0%



Paraqitja grafike e moshës mendore të E.A; Në vitin 2021 - 2.5 vjeç;. 2024- 3.5 vjeç.




E.A. Aftësimi konjitiv.Aspak73%,Ndihmë verbale 0%. *Pjesërisht 0%. Plotësisht 0%*



E.A. Aftësimi gjuhësor

Aspak 66%,Ndihmë fizike34%.Ndihmë verbale.0%. Pjesërisht. 0%,Plotësisht



VI. PËRFUNDIME

- Mungon një data bazë me të dhëna epidemiologjike. Mungon diagnostikimi në kohë, i fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit.
- Të evidentohen çrregullimet me testin depistues të Denverit për moshat 0-6.5, dhe i elementeve të spektrit të autizmit në moshë sa më të hershme.
- Diagnostikim i çrregullimit i referuar sistemit ndërkombëtar të klasifikimit sipas DSM-4 dhe DSM-5, pas majit 2013 të bëhet nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit, pyetësor të strukturuar dhe standardizuar për prindërit, për mjekët, me teste diagnostikimi për çrregullimin dhe gravitetin e ADOS.
- Vendosja e diagnozës të bëhet nga ekipe multidisciplinare të trajnuara me psikiatër, psikologë.
- Ndërhyrjet terapeutike të zhvillohen sa më të herët, individuale, afatgjatë me (PEI)
- Fëmijët autikë të integrohen në struktura psikoedukative parashkollore, dhe në struktura normale akademike në arsimin gjithëpërfshirës.

REFERENCA

- Acquarone, S. (2017). *Signs of Autism in Infants: Recognition and Early Intervention*. London: Karnac Books.Fq.35-42;69-74;130-143.
- Anderson, G. M., Hoshino, Y. (2015). Neurochemical Studies of Autism. In F.
- R. Volkmar, R. Paul, A. Klin, & D. Cohen, *Handbook of Autism and Pervasive Developmental Disorders, Volume 1* (p. 231- 262).
- Batten, A., Corbett, C., Rosenblatt, M., Withers, L., & Yuille, R. (2016). *Autism and education: The reality for families today*. London: The National Autistic Society.Fq.9-10; 24-26; 98-111.
- Beytien, A. (2011). *Autism Every Day: Over 150 Strategies Lived and Learned by a Professional Autism Consultant ëith 3 Sons on the Spectrum*. Arlington, Texas: Future Horizons.Fq.14-22;46-61;150-159.
- Dhamo.M.(2010).Çrregullimet dhe Terapitë e të folurit. Shtëpia botuese. Pegi.Fq.127-144.159-163.
- Gillberg C, Wing L.(2010) Autism: Not an extremely rare disorder. *Acta Psychiatr Scand* 1999;99:399-406. Miles JH, Hillman RE. Value of a clinical morphology examination in autism. *Am J Med Genet*.Fq; 85-89:142-153.

- Munib, H. Wiley, J & Sons, Inkorporuar (2019). ABC e Autizmit.ISBN: Numri ISBN: 9781119317258, numri ISBN: 9781119317272. SERIA: ABC Ser.
- Michael D.Poëers (2010).Fëmijët me autizëm (udhëzim për prindërit).Shtëpia botuese Fondacioni Fëmijët Shqiptarë “Domenick Scaglione”.ILAR.Tiranë, Fq.13- 22;195-201; 172–178.
- *Debora Fein & Michel Dunn, (2007).Autizmi në klasën tuaj. Shtëpia botuese : Fondacioni Fëmijët Shqiptarë“Domenick Scaglione” Shtypshkronja ILAR.Tiranë.Fq.3-10; 12-19;20-26.*
- *Lynnan,Cohen Brennan.(2010) Shtëpia botuese: Fondacioni Fëmijët Shqiptarë “Domenick Scaglione” Shtypshkronja ILAR.Tiranë.Fq.22-35; 98-110; 120-142.*
- Saqellari.S.(2015).Autizmi në këndvështrimin psikoedukative.Shtëpia botuese. Onufri. Tiranë. Fq.18-23; 95-100;127-129.
- Rada.A.(2013).Fëmijët me autizëm dhe aspekti social (Ndikimi i familjes).Disertacion. Tiranë.Faqe.3-9
- Siegel, B(2007). Ndhmoni Fëmijët me Autizëm të Mësojnë: Qasjet e Trajtimit për Prindërit dhe Profesionistët; Oxford University Press USA - OSO 2007.ISBN: Numri ISBN: 9780195138115, numri ISBN: 9780198031598
- Sue, A. Allen, M. (2020).Shkrim-leximi emocional në vitet e para: Ndhmoni fëmijët të ekuilibrojnë trupin dhe mendjen. ISBN: Numri ISBN: 9781912611201, numri ISBN: 9781912611386. SERIA: Hapat e vegjël Ser.

WEBSITE:

- <http://www.amazon.com/Children-Autism-MichaelD. Powers dp/1890627046>
- <http://www.amazon.com/Best-Sellers-Books-Autism-Aspergers.Syndrome/zgbs /books /282950>
- (<http://www.autisminternetmodules.org/>)
- <http://www.google.com/#hl=en&source=hp&q=Autism+Diagnostics+Observation+Schedule&>
- <http://www.learnersdictionary.com/definition/autism>,
- Nacional Autistic Society ,(London) <https://www.autism.org.uk/about/ëhat-is/asd.aspx> Autizmi, <http://www.autizmi-ks.net/>
- Autism Society <https://www.autism-society.org/> Autism Speaks <https://www. autismspeaks.org/ëhat-causes-autism> Autism Spectrum.Disorders<https://www.helpguide.org/articles/aut learningdisabilities/autism-> <http://www.judyendoë.com/autistic-behavior/autism-and-consequences/> <http:// www.ishp.gov.al> <http://www.th-living-media.com:www.rki.de> <http:www 2.health.vic.gov.au>

**MARTESA KANONIKE ORTODOKSE NË RAPORT ME DISPOZITAT E
LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË FUQI**

Dr (proc.). Vlash Plepi

Akademia Teologjike “Ngjallja e Krishtit”

vlashplepi@gmail.com

ABSTRAKT

Hyrje

Martesa është një institucion i rëndësishëm i shoqërisë, që reflekton vlerat, normat dhe traditat e saj. Martesa në konceptin social-ligjor sot në Shqipëri konsiderohet si një bashkim i lirë, vullnetar dhe i qëndrueshëm i një burri dhe një gruaje, bazuar në të drejta të barabarta, në dashuri, në respekt dhe ndihmë të ndërsjellë të bashkëshortëve. Bashkëshortët pritet të plotësojnë në mënyrë të barabartë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga familja. Në trajtimin e kësaj teme e cila ka një rëndësi të madhe e të veçantë, si shpirtërore ashtu edhe shoqërore, jemi përpjekur të kemi një qasje me shumë këndvështrime (*pa pretenduar se e kemi ezauruar*) ndaj problematikave që kanë të bëjnë me lidhjen midis burrit dhe gruas në martesë, dhe krijimin e një familjeje sipas Kishës Ortodokse. Kjo qasje, përpos një vështrimi të shkurtër historik, bazohet dhe në burimet e të Drejtës Familjare ortodoksë të cilat kryesisht janë: Shkrimi i Shenjtë, Tradita e Shenjtë e Kishës (Kanonet e Shenjta) dhe praktika kishtare. Sigurisht, kjo qasje është e mbështetur edhe në vendimet e Sinodit të Shenjtë dhe të Madh të Kishës ortodokse mbledhur në Kolimbari të Kretës, në Qershor 2016. Shpeshherë, për të qenë edhe në korrent me realitetin ku jetojmë, e shohim atë edhe në raport me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Të tilla p.sh. janë çështjet që kanë të bëjnë me fejesën, shkallët e

afërsisë, birësimi, kujdestaria, patronazhi, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martese, zgjidhja e martesës etj.

Fjalë kyçe: Martesa, tradita kanonike, legjislacioni, shkallët e afërsisë.

Martesa

Martesa midis burrit dhe gruas është një institucion i krijuar nga Zoti, e cila zë fill me krijimin e njeriut.¹⁶ Kështu, që nga fillimi i njerëzimit e në vazhdimësi, bashkimi i gruas dhe i burrit në martesë ka pasur një rëndësi të jashtëzakonshme në të gjitha kohët, në shoqëri të ndryshme dhe në kultura të ndryshme, duke u trajtuar gjithmonë me solemnitet.

Sipas juristit të famshëm romak Herennius Modestinus të fillimit të shekullit të tretë “Nuptiae sunt coniunctio maris et feminae et consortium omnis vitae, divini et humani iuris communicatio”, që do të thotë “martesa është bashkim i burrit dhe gruas dhe lidhje për gjithë jetën, shoqëri e së drejtës hyjnore dhe njerëzore”. Martesa e së Drejtës Romake ishte një akt që konsistonte në faktin e lidhjes së dy personave të gjinive të ndryshme me predispozicionin e një lidhje bashkëjetese monogame të qëndrueshme.

Edhe në përkufizimet më serioze bashkëkohore të martesës, ajo shihet si një lidhje e qëndrueshme dhe jo e përkohshme. Veçse ajo që duhet të theksojmë është se martesë është një shoqërizim dhe bashkëjetesë që i përket kësaj jete këtu mbi tokë dhe nuk shtrihet edhe në jetën tjetër. Këtë e sqaron vetë Zoti Krisht në përgjigjen që i jep pyetjes së saduqejeve (në lidhje me gruan që ishte martuar me shtatë vëllezër kur i thonë se: “në ngjallje pra gruaja e kujt do të jetë nga këta të shtatë”¹⁷), se: “në ngjallje as martohen, as martojnë, por janë si engjëj të Perëndisë në qiell”.¹⁸ Edhe Apostulli Pavli e thekson këtë kur thotë: “Sepse gruaja e martuar është e lidhur nga ligji me burrin derisa ky është i gjallë; po në vdektë burri, lirohet nga ligji i burrit. Kur rron pra burri, në u bashkëftë me

¹⁶ Zanafilla. 2: 23.

¹⁷ Matheu. 22:28.

¹⁸ Matheu. 22:30.

tjetër burrë, do të jetë kurorëshkelëse; po në vdektë burri, është e çliruar nga ligji”.¹⁹ Në një vend tjetër thotë se: “Gruaja është e lidhur nga ligji për sa kohë rron burri i saj”.²⁰ Kështu pra martesë është një bashkim i qëndrueshëm midis burrit dhe gruas në këtë jetë këtu mbi tokë që nuk shtrihet edhe në jetën tjetër të përtejme.

Misteri i Martesës nuk bën pjesë në Misteret e detyrueshme, të cilët janë të domosdoshëm për qëndrimin dhe përparimin e të krishterit brenda Kishës, megjithëse edhe ky Mister u jep një ndihmesë vendimtare bashkëshortëve të krishterë në këtë perspektivë. Sipas Shkrimit të Shenjtë martesë e krishterë (Misteri) është imazh i bashkimit të Krishtit me Kishën.²¹ Ashtu si Kisha në thelb është Trupi i Krishtit e bashkuar pandashmërisht me Të, edhe martesë e burrit me gruan nuk është thjesht një akt konvencional apo një event social, por është një Mister i shenjtë i dashurisë, një bashkim dashuror superior dhe i pazgjidhshëm. Nëpërmjet martesës kristiane bëhet e mundur ndihma reciproke që bashkëshortët i japin njëri-tjetrit në përmbushjen e qëllimit final të jetës së tyre që është arritja e “sipas ngjashmërisë”.²² Nëpërmjet saj, mbi këtë lidhje dhe komunikim, vjen hiri i Perëndisë dhe bekimi i Kishës. Mitropoliti i Korçës, Imzot Joani thekson se: “Të bashkuar me Perëndinë ajo bëhet jo vetëm thjesht një lidhje natyrale konvencionalë, për të siguruar vazhdimësinë e jetës së gjindjes njerëzore, por edhe një bashkim shpirtëror e një forcë krijuese shpirtërore, për të siguruar themelin mbi të cilin mund të ndërtohet institucioni i shenjtë i familjes”. Më tej duke folur mbi kujdesin dhe përgjegjësinë që prindërit duhet të kenë për shpëtimin e fëmijëve të tyre, Hirësia e tij do të referonte dy etër të shenjtë të Kishës, Shën Joan Gojartin dhe Shën Tihonin e Zadonskut duke thënë: “Moskujdesja për fëmijët është më i madhi i të gjitha mëkateve, meqenëse ai të çon në pabesinë ekstreme. ... Nuk ka shfajësim për ne, nëse fëmijët tanë janë të prishur”. “Një atë i vërtetë nuk është ai që ka lindur fëmijë, por ai që i rrit dhe i mëson mirë ata”.²³ Në këtë drejtim përkujdesi i prindërve të krishterë duhet të jetë i vazhdueshëm dhe i

¹⁹ Romakëve. 7: 2-3.

²⁰ 1 Korinthianëve. 7: 39.

²¹ Efesianëve. 5: 22-23.

²² Zanafilla. 1:26.

²³ Imzot Joani Mitropolit i Korçës, *Martesa dhe familja në Kishën Orthodhokse*, Ngjallja, Shkurt 2016, fq. 3-4.

pandërprerë në mënyrë që t'i rrisin ata sipas Krishtit. Apostulli i kombeve thotë gjithashtu se: “Do të shpëtojë me anë të lindjes së fëmijëve, në qoftë se qëndrojnë në besim dhe në dashuri e në shenjtërim me urtësi”.²⁴ Sipas vendimeve të Sinodit të Shenjtë dhe të Madh të Kishës (Kretë 2016), “Mbrotjtja e shenjtërisë së Misterit të Martesës ka qenë gjithmonë e një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e Familjes, e cila rrezaton shoqërinë e personave bashkëshortë si në Kishë, ashtu edhe në shoqërinë në tërësi. Kështu, shoqëria e personave që është arritur nëpërmjet Misterit të Martesës, funksionon jo thjesht si një marrëdhënie konvencionale natyrore, por si një fuqi shpirtërore dhe krijuese nëpërmjet institucionit të shenjtë të Familjes. Kjo siguron mbrojtjen dhe formimin e fëmijëve si në misionin shpirtëror të Kishës, ashtu edhe në jetën e shoqërisë”.²⁵ Duket qartë pra, se Misteri i Martesës ka një rëndësi të madhe si për bashkëshortët dhe fëmijët e lindur prej tyre, ashtu edhe për shoqërinë dhe Kishën në tërësi. Martesa sipas mësimit të krishterë përbën gurin e qoshes për një shoqëri të përgjegjshme që ecën drejt perspektivës së Mbretërisë qiellore. Kjo u pa qartë edhe në paragrafin e mësipërm por që, një përmbledhje të saj e gjejmë sërish edhe në enciklikën e këtij Sinodi ku shprehet se: “Kisha ortodokse e shikon lidhjen e pazgjidhshme dashurore midis burrit dhe gruas si një “mister të madh” ... për Krishtin dhe për Kishën²⁶ dhe familjen që buron prej kësaj, e cila përbën garancinë e vetme për lidhjen dhe rritjen e fëmijëve në përputhje me planin e Ekonomisë Hyjnore, e shikon si “një Kishë të vogël”,²⁷ duke i dhënë asaj mbështetjen e nevojshme baritore”.²⁸

Fatkeqësisht sot ekziston një klimë e sëmurë në shoqëri që nuk e favorizon familjen e krishterë. Kjo klimë “moderne” promovon modele të cilat në thelb minojnë vlerat e vërteta të familjes, që

²⁴ 1 Timotheut. 2, 15.

²⁵ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, I. Martesa Orthodhokse, paragrafi 5.

²⁶ Efesianëve. 5: 32.

²⁷ Joan Gojarti, Komentari i letrës drejtuar Efesianëve, 20, PG 62, 143.

²⁸ Kërkim 14. (2016). Enciklika e Sinodit të Shenjtë dhe të Madh të Kishës Orthodhokse III, Familja: Ikona e Dashurisë së Krishtit për Kishën, paragrafi 7.

është celula primare e shoqërisë. Ekzistenca e kësaj krize kërkon edhe një angazhim serioz baritor të Kishës për përballimin dhe kurimin e saj. Për këtë arsye Sinodi i Shenjtë dhe i Madh thekson: “Çështja që shtrohet sot në shoqëri është Martesa, e cila është qendra e Familjes dhe Familja justifikon Martesën. Presioni që ushtrohet në botën bashkëkohore, për të pranuar forma të reja bashkëjetese përbën një kërcënim konkret për të krishterët ortodokse. Kriza e shumëllojshme e institucionit të Martesës dhe e Familjes shqetëson thellë Kishën ortodokse jo vetëm për shkak të pasojave negative në strukturën e shoqërisë, por edhe për shkak të kërcënimit ndaj marrëdhënieve të veçanta brenda gjirit të Familjes tradicionale”.²⁹ Prishja e Institucionit të shenjtë të Martesës prish kështu edhe familjen (divorcet, abortet) që është celula e shoqërisë, duke e rrënuar atë. Për këtë gjë Sinodi i Shenjtë dhe i Madh pak më poshtë shprehet se: “Pasojat tejet të rënda të kësaj krize shprehen përmes rritjes së rrezikshme të numrit të divorceve, të aborteve dhe mjaft problemeve të tjera të jashtme në jetën familjare. Pasojat në fjalë janë një sfidë e madhe për misionin e Kishës në botën bashkëkohore, prandaj edhe barinjtë e Kishës duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme për përballimin e këtyre problemeve. Kisha ortodokse fton në dashuri bijtë e saj dhe të gjithë njerëzit me dëshirë të mirë që të mbrojnë besnikërinë në shenjtërinë e Familjes”.³⁰

Kushtet dhe pengesat e Martesës

E Drejta Familjare Kishtare bën dallim midis kushteve dhe pengesave për Martesë, megjithëse që të dyja konvergojnë në vlerësimin kanonik të Martesës, në mënyrë që bashkimi i burrit dhe i gruas në Martesë të jetë “sipas Zotit dhe jo sipas dëshirës njerëzore”.³¹

Kushtet dhe pengesat e Martesës në terma të përgjithshëm janë tërësia e kërkesave që Kisha parashtron dhe që duhet të (*mos*)ekzistojnë ose të përmbushen prej bashkëshortëve të ardhshëm në

²⁹ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, I. Martesa Orthodhokse, paragrafi 8.

³⁰ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, Martesa Orthodhokse, paragrafi 11.

³¹ Ignat Hyjmbajtësi, Letra drejtuar Polikarpit të Smirnës, ΒΕΠΕΣ, v. 2, fq. 283-284.

mënyrë që Misteri i Martesës të jetë kanonikisht i vlefshëm, pra i orientuar në perspektivën soteriologjike. Sinodi i Shenjtë dhe i Madh Ortodoks duke perifrazuar frymën e menaxhimit ndër shekuj prej Kishës në këtë perspektivë të Martesës, shprehet se “Kisha i ka trajtuar gjithmonë me rreptësinë e nevojshme dhe ndjeshmërinë e duhur baritore, sipas shembullit të përdëllimit të apostullit të kombeve, Pavlit,³² si parakushtet pozitive (ndryshimi në gjini, moshë ligjore etj.), ashtu edhe parakushtet negative (afërsi gjaku dhe martesë, afërsi shpirtërore, martesë ekzistuese, ndryshim në fe etj.) për lidhjen e Martesës. Ndjeshmëria baritore ishte e nevojshme jo vetëm ngaqë tradita biblike përcakton marrëdhënien e lidhjes së martesës natyrore me Misterin e Kishës, por edhe ngaqë praktika kishtare nuk përjashton adoptimin e disa parimeve për martesën të së drejtës natyrore greko-romake, të cilat paraqesin lidhjen e martesës midis burrit e gruas si “shoqëri e së drejtës hyjnore dhe shoqërore” (Modestini) dhe që janë në përputhje me shenjtërinë që Kisha i atribuon Misterit të Martesës”.³³

Parakushtet pozitive

Parakushtet pozitive janë disa kërkesa të përgjithshme, me ngarkesë pozitive, të cilat nuk kërkojnë një procedurë të veçantë nga ana e Kishës, por që rrjedhin natyrshëm në jetën dhe veprimtarinë e saj baritore. Për këtë arsye quhen edhe parakushte pozitive.

1. Heteroseksualiteti

Kusht për Martesën është që t’i përkasin dy gjinive të ndryshme (burrë dhe grua) që nga lindja. Homoseksualiteti është i ndaluar dhe konsiderohet si një nga mëkatet më të rënda si nga Shkrimi i Shenjtë³⁴ ashtu edhe nga Kanonet e Shenjta.³⁵

³² Romakëve. 7: 2-3; 1; Kornthianëve. 7: 12-15, 39 etj.

³³ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, I. Martesa Orthodhokse, paragrafi 6.

³⁴ Shih: Romakëve. 1: 24-27.

³⁵ Shih: Vasili i Madh. Kan. 7, 62; Grigori i Nisës. Kan. 4.

Që në gjenezë njeriu u krijua nga Perëndia mashkull dhe femër, që të bashkohen njëri me tjetrin, si dy gjini të ndryshme të shtohen dhe të shumohen e të kenë bekimet e Perëndisë.³⁶ Në Shkrimin e Shenjtë homoseksualiteti konsiderohet si mëkat “sodomist”.³⁷ Sa herë që Shkrimi i Shenjtë flet për Martesën i referohet çiftit burrë-grua.³⁸ Kushtin e ekzistencës së gjinive të ndryshme e pamë edhe në përkufizimin e juristit të famshëm romak në fillimin e shekullit të tretë Modestinit ku thuhet se “Martesa është bashkim i burrit dhe gruas ...” (...maris et feminae ...). Në legjislacionin tonë familjar diversiteti i seksit nuk është i përcaktuar në mënyrë të veçantë, por përfshihet brenda dispozitës së kushtit të moshës ku thuhet se: “Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje ...”,³⁹ që sipas rendit tonë juridik, mosekzistenca e këtij diversiteti e bën një martesë të tillë absolutisht të pavlefshme. Pra flitet për një martesë të paqenë, sepse cenohet një parim i rëndësishëm që përbën thelbin e martesës që është: parimi i heteroseksualitetit.⁴⁰

Ndryshimi i seksit (transeksualiteti) është pengesë për lidhjen e martesës, sepse organi seksual në këtë rast vetëm improvizohet, por në realitet mbetet organi gjenetik seksual që kishte edhe para operacionit. Kështu që transeksualiteti mund të konsiderohet një vepër edhe më e rëndë se homoseksualiteti, sepse jo vetëm që keqpërdor, vepron turpshëm me atë që Zoti ka dhënë, por tenton edhe ta zhbëjë atë.

2. Moshë ligjore

Kisha ortodokse nuk e ka të përcaktuar me Kanon kishtar moshën e duhur për martesë, duke ndjekur kështu ligjet e secilit shtet në të cilin ajo ndodhet. Ky veprim kishtar mbështetet tek fragmenti i Apostullit: “Çdo shpirt le t’i nënshtrohet pushteteve që janë mbi të; sepse nuk ka

³⁶ Zanafilla. 1: 27-28; Matheu. 19: 4.

³⁷ Zanafilla. 19: 1-29; Levitiku. 18: 22, 22: 10-21; Isaia. 1: 7-31, 6: 9-13; 1 Timotheut. 1: 10; Romakëve. 1: 26.

³⁸ Matheu. 19: 3-6.

³⁹ Shih: LIGJI Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 7.

⁴⁰ Shih: Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Aejana Fullani, *E Drejta Familjare*, Tiranë 2006, fq. 116-118.

pushtet veç nga Perëndia”.⁴¹ Sigurisht, këtu bën fjalë për ato ligje të cilët nuk bien ndesh me fjalën e Zotit, sepse edhe te Veprat e Apostujve shohim që të thuhet: “Duhet t’i bindemi Perëndisë më tepër se njerëzve”.⁴² Gjithashtu edhe Kanoni 42 i Shën Vasilit të Madh thotë: “Martesat që bëhen pa pëlqimin e atyre që kanë autoritet mbi ta janë të paligjshme”. Në Kishën tonë në Shqipëri kjo gjë është e përcaktuar dhe në Statutin e saj, ku kusht për celebrimin e Martesës në Kishë është edhe certifikata e celebrimit nga Gjendja Civile – përderisa kjo lloj Martese është e detyrueshme në Shqipëri.⁴³ Sipas ligjeve të shtetit shqiptar “Mosha e lidhjes së martesës, midis një burri dhe një gruaje është e lejuar për ata që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Gjykata e vendit ku lidhet martesa, në raste të veçanta dhe për arsye serioze, mund të lejojë martesën edhe përpara kësaj moshe”.⁴⁴

3. Pëlqim i lirë dhe i pa imponuar

Veprimi i lirë dhe i pa imponuar i bashkëshortëve të ardhshëm përbën kusht për kurorëzimin e Martesës në Kishën ortodokse. Kanonet e Shenjta ndalojnë rreptësisht përdorimin e çdo forme dhune apo rrëmbimi të përdorur me pretekst martesën.⁴⁵ Madje Kisha veprimin e lirë të personit në martesë e kushtëzon edhe për martesën e dytë.⁴⁶ Në pajtim me kanonet e mësipërm Sinodi i Shenjtë dhe i Madh Ortodoks, bashkimin me vullnet të lirë midis burrit dhe gruas e konsideron

⁴¹ Romakëve. 13: 1.

⁴² Veprat. 5: 29.

⁴³ Shih: Statuti i KOASH 2006, neni 67.

⁴⁴ Shih: LIGJI Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 7.

⁴⁵ Ankira. Kan. 11; Vasili i Madh. Kan. 22, 30, 38, 42, 53; Sinodi IV Ekumenik. Kan. 27; Sinodi Pesë-Gjashtë. Kan. 92.

⁴⁶ Laodikea. Kan. 1.

kusht të domosdoshëm për martesën.⁴⁷ Pëlqimi i lirë dhe i pa imponuar për martesë është i përcaktuar edhe në Legjislacionin Shqiptar.⁴⁸

4. Leja e Episkopit

Leja për Martesë jepet nga episkopi i zonës ose prej përfaqësuesit të tij. Episkopi që në kishën e hershme paraqitet si epiqendra e unitetit të Kishës. Sipas letrave të Shën Ignat Hyj mbajtësit, episkopi është “imazh i Atit”⁴⁹ dhe në “vend”⁵⁰ të Jisu Krishtit, përngjasohet me kapitenin e anijes ku gjithçka duhet të bëhet me pëlqimin e tij, syresh edhe martesa, që të jetë sipas Krishtit. Kësisoj Sinodi i Kretës (2016) shprehet se “..., tipologjia Kristocentrike e Misterit të Martesës shpjegon bekimin prej episkopit ose priftit të lidhjes së shenjtë nëpërmjet një urate të posaçme (Shërbesa e Kurorëzimit), prandaj dhe Shën Inat Hyj mbajtësi, në letrën e tij drejtuar Polikarpit të Smirnës, theksonte se ata që vijnë për lidhje martesore, duhet “ta kryejnë bashkimin me pëlqimin e episkopit, që martesa të jetë sipas Zotit dhe jo sipas dëshirës njerëzore. Gjithmonë për nder të Perëndisë duhet të bëhen”.⁵¹ Kështu, si shenjtëria e lidhjes së hyj themeluar, ashtu edhe përmbajtja shpirtërore e bashkimit martesor shpjegojnë kërkesën, në mënyrë që të theksohet fakti se “martesa duhet të jetë e ndershme për të gjithë dhe shtrati i panjolllosur”,⁵² prandaj dhe konsiderohej i papranueshëm çdo cenim i papastërtisë së saj⁵³.⁵⁴ Në Statutin e Kishës sonë ortodokse Autoqefale

⁴⁷ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, I. Martesa Orthodhokse, paragrafi 1.

⁴⁸ Shih: LIGJI Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 8.

⁴⁹ Letra e shën Ignatit drejtuar Tralianëve, III, 1. ΕΠΕ, v. 4 fq. 103-111.

⁵⁰ Letra e shën Ignatit drejtuar Magnesianëve, VI, 1.

⁵¹ Ignat Hyjmbajtësi, Letra drejtuar Polikarpit të Smirnës, ΒΕΠΕΣ, v. 2, fq. 283-284.

⁵² Hebrenjve. 13:4.

⁵³ Efesianëve. 5: 2-5; 1 Thesalonikasve. 4:4; Hebrenjve. 13: 4 etj.

⁵⁴ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, Misteri i Martesës dhe pengesat e saj, I. Martesa Orthodhokse, paragrafi 3.

të Shqipërisë leja e episkopit ose e përfaqësuesit të tij është vendosur si parakusht për kryerjen e Shërbesës së Kurorëzimit. Për dhënien e lejes kërkohet:

- a) Certifikatë Pagëzimi
- b) Deklaratë me shkrim e të fejuarve se nuk ekziston ndonjë lloj pengese që mund të shkaktojë shtyrje ose anulim të martesës,
- c) Vërtetimi i saj prej dy dëshmitarëve ortodokse të besuar
- d) Certifikatë celebrimi nga Gjendja Civile – përderisa kjo lloj martese është e detyrueshme në Shqipëri.⁵⁵

5. Zhvillimi normal psikik dhe mendor

Edhe në këtë rast Kisha lypset që të marrë parasysh dhe të ndjekë ligjet e shtetit.⁵⁶ Kështu kandidati për bashkëshort duhet të ketë një zhvillim normal psikik dhe mendor. Duhet pasur kujdes se jo çdo sëmundje mendore përbën ndalesë për martesë. Në rastin në fjalë veçohen rastet kur njëri nga bashkëshortët e ardhshëm vuan nga një sëmundje e rëndë psikike ose mendore të atillë që e bën atë të paaftë për të kuptuar qëllimin e martesës.⁵⁷

6. Aftësia fizike për marrëdhënie seksuale

Paaftësia për të kryer marrëdhënie seksuale bën të pamundur jo vetëm lindjen e fëmijëve, por edhe ndihmën reciproke për të kënaqur dhe kuruar dëshirën seksuale të bashkëshortëve. Pavarësisht kësaj, kjo paaftësi nuk konsiderohet pengesë për martesë, (as nga E Drejta Kanonike dhe as nga E

⁵⁵ Statuti i KOASH 2006, neni 67.

⁵⁶Shih: Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq. 98. Shih dhe: Nikodim Milash, *Το Εκκλησιαστικόν Δίκαιον της Ορθοδόξου Ανατολικής Εκκλησίας*, përkthim në greqisht nga Apostolopoulos Meletios, Sakellariou, Athinë 1906, fq. 832.

⁵⁷ Shih: Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 12.

Drejta Familjare Civile). Sigurisht dashuria e vërtetë kërkon që kandidatët për martesë t’ua bëjnë të ditur bashkëshortëve të ardhshëm këtë sëmundje apo cen fizik.⁵⁸

7. Leja e organeve kompetente shtetërore

Është e nevojshme që të jenë pajisur me leje të organeve kompetente shtetërore, sipas asaj që parashikon ligji shtetëror në fuqi i vendeve në të cilët gjendet Kisha Autoqefale përkatëse. Në vendin tonë sikurse e pamë më lart Kisha për kryerjen e Shërbesës së Kurorëzimit kërkon paraprakisht certifikatën e celebrimit nga Gjendja Civile – përderisa kjo lloj martese është e detyrueshme në Shqipëri.⁵⁹

8. Shpallja e martesës

Publikimi ose shpallja e martesës është një akt paramartesor me qëllim evidentimin e ndonjë pengese për martesë ose të një martese klandestine dhe lënien e hapësirës së nevojshme kohore për kundërshtimin e saj. Kanoni 1 i Sinodit të Laodikeas shprehet qartë se martesa duhet të jetë “e lirë dhe e ligjshme dhe jo një bashkim klandestin”. Për ligjin civil, shpallja e martesës, është një kusht, pa plotësimin e të cilit, të paktën 10 ditë nga e nesërmja e shpalljes, martesa nuk mund të lidhet. Shpallja e martesës është e përcaktuar në ligjin shqiptar në fuqi, nga pesë nene të Kodit të Familjes.⁶⁰

Pengesat ose parakushtet negative

Pengesat ose ndalesat janë ato parakushte konkrete me ngarkesë negative ekzistenca e të cilave e bëjnë martesën të pavlefshme. Pengesat kanë të bëjnë me një rast konkret dhe me një person të caktuar, prandaj duhet që të shqyrtohen rast pas rasti. Pengesat e martesës në vetvete ndahen në

⁵⁸ Παπαγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq. 98.

⁵⁹ Statuti i KOASH 2006, neni 67.

⁶⁰ Shih: Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 15-19.

absolute dhe relative. Pra, nuk mund të themi prerazi që ekzistenca e tyre e bën martesën apriori të pavlefshme. Ka raste që, për sa kohë qëndrojnë këto pengesa, e pamundësojnë celebrimin e martesës. P.sh. ekzistenca e një pengese e bën martesën të pamundur me një person të caktuar, por jo edhe me çdo person tjetër. Duke parë me kujdes rëndësinë e veçantë dhe brishtësinë e kësaj çështje, Sinodi i Shenjtë dhe i Madh i Kretës (2016) vendosi që: “Mundësia e zbatimit të ekonomisë kishtarë në lidhje me pengesat e martesës duhet të trajtohet nga Sinodi i Shenjtë i çdo Kisha Autoqefale ortodokse sipas parimeve të Kanoneve të Shenjtë, me frymë dallimi baritor, me qëllim shpëtimin e njeriut”.⁶¹

1. Dorëzimi

Sinodi i Shenjtë dhe i Madh (2016) përcakton se: “Priftëria, në vetvete, nuk përbën pengesë për martesë, por gjithsesi, sipas traditës kanonike në fuqi,⁶² ndalohej martesë pas dorëzimit”.⁶³ Në Kishën ortodokse martesë e klerikëve të rëndeve superiore klerikale nuk mund të bëhet pas dorëzimit të tyre,⁶⁴ ndërsa për klerikët e rëndeve inferiore klerikale (hirothesi) të anagnostit dhe psaltit martesë është e lejuar.⁶⁵ Kanoni 6^{-të} i Sinodit Pesë-Gjashtë Ekumenik (691 m.b.K.) thotë: “Sipas asaj që është përcaktuar në Kanonet Apostolike, të cilët vendosin që: *“Nga klerikët e pamartuar, të drejtën për t’u martuar e japim vetëm për anagnostët dhe psaltët”, edhe ne duke respektuar këtë vendosim se që tani e tutje asnjë nëndhjakon, dhjakon ose prift nuk do të ketë të drejtë të martohet pas dorëzimit. Ai që guxon ta bëjë këtë, le të çhirotoniset. Nëse ndonjë nga ata që duan të futen në kler dëshiron të bashkohet me një grua në një martesë të ligjshme, le ta bëjë këtë përpara dorëzimit të tij në nëndhjakun, dhjakun ose prift”. Në të njëjtën linjë shprehet edhe Kanoni 26 Apostolik: “Ndër ata që u futën në klerin e shenjtë të pamartuar, të drejtën për t’u*

⁶¹ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, “II. Pengesat e martesës dhe zbatimi i ekonomisë” 5/b.

⁶² Kanoni 3 i Sinodit Pesë-Gjashtë në Kupolë.

⁶³ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, “pengesat e martesës dhe zbatimi i Ekonomisë” paragrafi 4.

⁶⁴ Shih: Παντελεήμονος Ροδόπουλος, *Μαθήματα Κανονικού Δικαίου*, Selanik 1980, fq. 226-231.

⁶⁵ Sinodi IV Ekumenik. Kan. 4.

martuar, nëse ata dëshirojnë, e japim vetëm për anagnostët dhe psaltët”. Gjithashtu Kanoni 1 i Sinodit të Neocesarisë (319 mb.K.) thotë: “Nëse një prift martohet, ai duhet të nxirret jashtë rangut të tij. Nëse kurvëron apo kryen kurorë shkelje, le të përjashtohet nga kungimi dhe t’i nënshtrohet pendimit”.

2. Pohimi i virgjërisë

Në bazë të Kanoneve të Shenjtë, ndalohet rreptësisht sipas “saktësisë kanonike”, martesë pas qethjes murgjërore.⁶⁶ Murgu ose murgesha i përkushtohet vetëm Perëndisë. Ai ose ajo kur braktis botën dhe futet në jetën murgjërore konsiderohet i/e martuar shpirtërisht me Krishtin dhe “kujdeset për punët e Zotit, si t’i pëlqejë Zotit”.⁶⁷ Sinodi i Katërt Ekumenik (451 mb.K.) e përcakton qartë se murgjësia përbën ndalesë për martesë dhe thotë se: “Në qoftë se një virgjëreshë ia ka dedikuar vetveten Perëndisë, ose një burrë bëhet murg, pas kësaj nuk mund të martohet më”.⁶⁸ Gjithashtu Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik (691 mb.K.) përcakton edhe qortimet respektive kur ky betim shkelet: “Murgu që shpallet fajtor - për kurvëri ose se ka marrë një grua për t’u martuar apo bashkëjetuar me të, t’i nënshtrohet qortimeve të përcaktuara nga kanonet”.⁶⁹ Në sinkron me kanonin e mësipërm është edhe Kanoni 19 i Sinodit të Ankirës (314 mb.K.): “Të gjithë ata që premtuan të qëndronin të virgjër, por e shkelën premtimin e tyre, të trajtohen si bigamët”.⁷⁰

3. Afërsia e lidhjes së gjakut (farefisnia)

⁶⁶ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, “II. Pengesat e martesës dhe zbatimi i ekonomisë” 3.

⁶⁷ 1 Korinthianëve. 7:32.

⁶⁸ Sinodi IV Ekumenik. Kan. 16.

⁶⁹ Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 16; 44.

⁷⁰ Shih dhe. Sinodi I Ekumenik. Kan.3; Vasili i Madh. Kan. 6, 18, 19, 20, 60; Sinodi IV Ekumenik. Kan. 16.

Afërsia e gjakut që ndryshe njihet edhe si afërsi natyrore quhet lidhja midis dy a më shumë personash e krijuar nëpërmjet lindjes. Lindja konsiderohet baza e afërsisë së gjakut që rrjedh nga martesë. Afërsia e gjakut ndahet në dy lloje:⁷¹

a) Lidhje gjaku në vijë të drejtpërdrejtë (*linea recta*), quhet lidhja që ekziston midis stërgjyshit, gjyshit, babait, djalit, nipit, pra midis të paralindurit dhe të paslindurit. Vija e drejtpërdrejtë mund të jetë hipëse ose zbritëse. Hipëse (*accidentalis*) shkon duke u ngjitur nga personi në fjalë drejt të paralindurit. Zbritëse (*descententalis*) kur shkon duke zbritur nga personi në fjalë drejt të paslindurit. Në lidhjen e drejtpërdrejtë martesë është e ndaluar pa kufi.

b) Lidhje gjaku në vijë të tërthortë (*linea transversales ose collaterales*), quhet lidhja e krijuar midis personave që megjithëse janë pjesë e të njëjtit trung familjar,⁷² d.m.th. kanë të njëjtin paraardhës të përbashkët, por nuk zbresin prej njëri-tjetrit.

Numri i lindjeve që të largon nga paraardhësi i përbashkët përcakton edhe shkallën e afërsisë (pra largësia nga një lindje në tjetrën është një shkallë afërsie). Në llogaritjen e shkallës së afërsisë zbresim gjithmonë një njësi që është trungu familjar. Martesë është e ndaluar deri në shkallën e katërt të afërsisë.⁷³

Kanonet e Kishës që flasin mbi lidhjen e gjakut janë të shumtë, por më i spikaturi ndër ta është Kanoni 54 i Sinodit Pesë-Gjashtë Ekumenik (691 m.b.K.): “*Duke patur parasysh faktin që Shkrimi i Shenjtë na mëson qartë ‘Asnjë nga ju të mos i afrohet ndonjë të afërmi nga gjaku për të zbuluar lakuriqësinë e tij’*”,⁷⁴ Shën Vasili i hyj inspiruar na numëroi në kanonet e tij të shenjta disa raste martesash të ndaluara, duke anashkaluar në heshtje një numër të madh të tyre dhe duke na treguar me të dyja se çfarë është e dobishme. Për të shmangur numrin e madh të emërtimeve të pahijshme dhe për të shmangur ndotjen e ligjërit të tij me fjalë të tilla, i përmblodhi ndyrësitë në terma të përgjithshëm përmes të cilëve ai tregoi rastet e martesave të paligjshme. Por meqenëse

⁷¹ Termat specifike të përdorur në këtë temë interpretohen duke i konsideruar ato në fokusin e të Drejtës Kanonike Kishtare. Paralelisht do të shohim përdorimin e tyre në hapësirën civile duke iu referuar kryesisht Kodit të Familjes.

⁷² Trungu familjar formohet nga dy prindërit ose bashkëshortët dhe lindjet që rrjedhin prej tyre dhe prej pasardhësve të tyre.

⁷³ Shih: Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq. 102.

⁷⁴ Levetiku. 18: 6.

natyra njerëzore për shkak të kësaj heshtjeje dhe të moskuptimit se cilat martesë janë të ndaluara si të paligjshme, ka filluar të ngatërrojë gjithçka, ne kemi vendosur të flasim hapur për këtë, duke porositur se që tani e tutje kushdo që do të martohet me kushërirën e tij të parë, ose babai dhe djali që do të martohen me nënën dhe vajzën, ose babai dhe djali që do të martohen me dy motra, ose nënë e bijë që do të martohen me dy vëllezër, ose dy vëllezër që do të martohen me dy motra, të shpëputen qartë nga kjo bashkëjetesë e paligjshme dhe t'i nënshtrohen qortimit kanonik për shtatë vjet”.

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë duket se është në pajtim me praktikën e kishës sa i përket afërsisë së lidhjes së gjakut. Kështu sipas tij, martesat në lidhjen e gjakut në vijë të tërthortë janë të ndaluara deri në shkallën e katërt.⁷⁵ Legjislacioni shqiptar në Kodin e Familjes në nenin 10 të Ligjit 9062 vendos se: “Nuk mund të lidhin martesë midis tyre të paralindurit dhe të paslindurit, vëllai dhe motra, ungji dhe mbesa, emta dhe nipi, si dhe fëmijët e vëllezërve dhe të motrave”.⁷⁶

4. Afërsia e lidhjes së krushqisë (lidhja afinitive)

Afërsia e krushqisë ka për bazë martesën ndërmjet burrit dhe gruas duke krijuar dy trungje familjare. Kështu si rezultat i një martese krijohet një marrëdhënie krushqie midis dy familjeve. Llogaritja e afërsisë së krushqisë është e njëjtë në logjikë, sikurse llogaritja e afërsisë së lidhjes së gjakut.

Meqenëse burri dhe gruaja të martuar konsiderohen si një trup i vetëm atëherë prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat e njërit konsiderohen si prindërit, fëmijët, vëllezërit dhe motrat edhe të tjetrit. Për këtë arsye martesë e të afërmeve të bashkëshortit/es me të afërmit e të bashkëshortit/es të krijuar si rezultat i lidhjes së gjakut në vijë të drejtpërdrejtë është e ndaluar pa kufizim, sikurse dhe afërsia e lidhjes së gjakut në vijën e tërthortë ndalohet deri në shkallën e tretë, e në raste të veçanta deri në shkallën e katërt.⁷⁷

⁷⁵ Shih: Arta Mandro-Balili, Vjollca Meçaj, Tefta Zaka, Aejana Fullani, *E Drejta Familjare*, Tiranë 2006, fq. 108.

⁷⁶ Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 10.

⁷⁷ Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Αθinë 1992, fq.103.

Gjithashtu ndalohet martesë e të afërmit në lidhje gjaku të shkallës së dytë të farefisnisë të njërit nga bashkëshortët me farefisnin në lidhje gjaku deri në shkallën e dytë të bashkëshortit tjetër.⁷⁸ Afërsia e krijuar si rezultat i krushqisë vazhdon edhe pas zgjidhjes së martesës. Gjithashtu ndalohet martesë e të afërmit në lidhje gjaku të shkallës së dytë të farefisnisë të njërit nga bashkëshortët me farefisnin në lidhje gjaku deri në shkallën e dytë të bashkëshortit tjetër. Të shumtë janë kanonet që i referohen pengesave për martesë në lidhjen e gjakut dhe në lidhjen e krushqisë, por më kryesorët ndër ta janë Kanoni 54 i Sinodit Pesë-Gjashtë Ekumenik, Kanoni 19 Apostolik, Kanoni 2 i Neofesarisë⁷⁹ si dhe një sërë kanonesh të Shën Vasilit të Madh⁸⁰ që i përmendëm më lart. Sipas Legjislacionit shqiptar “Nuk mund të lidhin martesë midis tyre vjehrrit dhe nusja, vjehrra dhe dhëndri, njerku dhe thjeshtër, njerka dhe thjeshtër, pavarësisht se martesë që ka krijuar këtë lidhje është shpallur e pavlefshme, ka pushuar ose është zgjidhur”.⁸¹

5. Lidhja shpirtërore

Lidhja shpirtërore quhet ajo lidhje e krijuar nëpërmjet Misterit të Shenjtë të Pagëzimit. Kjo lidhje shpirtërore e krijuar përbën pengesë për martesë të nunit/ës me të pagëzuarin/ën dhe prindit të saj/tij të mbetur të ve. Kanoni 53 i Sinodit Pesë-Gjashtë Ekumenik thotë: *“Meqenëse lidhja shpirtërore qëndron më lart se ajo fizike dhe meqenëse jemi bërë me dije që në disa vende, disa që janë bërë nun, si rezultat i pagëzimit të shenjtë dhe shpëtimtar, më pas janë martuar me nënat e tyre që kanë mbetur të veja, urdhërojmë që kjo të mos ndodhë më. Nëse ka ndonjë që pas daljes së këtij kanoni, kapet duke bërë një diçka të tillë, para së gjithash duhet ta prishë këtë martesë të paligjshme dhe më pas t’i nënshtrohet qortimeve kanonike të vendosura për kurvarët”*. Profesori i

⁷⁸ Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 54 “dy vëllezër nuk mund të martohen me dy motra”

⁷⁹ Shih: Sinodi në Neofesari (~319). Kan. 3, 7; Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 3, 26.

⁸⁰ Vasili i Madh. Kan. 23, 27, 68, 75, 76, 77, 78, 79, 87.

⁸¹ Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 11.

të Drejtës Kanonike z. Panagiotis Bumis shprehet se në kanone nuk përmendet shprehimisht që midis të pagëzuarve nga i njëjti nun krijohet afërsi shpirtërore që të përbëjë pengesë për martesë.⁸²

6. Birësimi

Megjithëse afërsia e krijuar si rezultat i birësimit nuk përmendet në Kanonet e Shenjta, profesor Bumis shprehet se në tekstet kanonike kishtare, birësimin si pengesë për martesë, e gjejmë të përmendet në interpretimin që kanonologu i famshëm bizantin Theodhor Balsamon (shek. XII) i bën kanonit 53 të Sinodit të Pesë-Gjashtë Ekumenik. Edhe në këtë interpretim ai i referohet dekreteve (Novellae 24) të Leonit IV i mbiquajturi i Urti (886-912.).⁸³ Kisha edhe në këtë rast ndjek dispozitat ligjore në fuqi mbi këtë çështje. Sipas Legjislacionit Shqiptar “Ndalohej martesa midis birësuesit e të birësuarit dhe pasardhësve të tyre, të birësuarit dhe bashkëshortit të birësuesit, midis birësuesit e bashkëshortit të të birësuarit, midis të birësuarve, si dhe midis të birësuarit dhe fëmijëve të birësuesit. Me birësimin nuk zhduket shkaku që ndalon martesën midis të birësuarit dhe gjinisë së tij të parashikuar nga neni 10^{te} i këtij Kodi”.⁸⁴

Sa i përket kushteve të birësimit ato janë parashikuar në legjislacionin shqiptar përmes neneve përkatëse të “Kodit të Familjes”.⁸⁵

Komisioni i ligjeve i Kuvendit të Shqipërisë në mbledhjen e datës 28 shtator 2021 hartoi një projektligj për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes” të ndryshuar. Ndaj këtyre ndryshimeve në Kodin e Familjes dhe duke insistuar për mos ndryshimin e konceptit të martesës dhe bashkëjetesës... si Burrë dhe Grua nga lindja, Këshilli Ndër fetar i Shqipërisë ka reaguar në mbrojtje të familjes dhe fëmijës si interesi më i madh që duhet mbështetur në shoqërinë shqiptare, duke depozituar disa propozime Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë ku citohet se:

⁸² Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq.104.

⁸³ Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq.105.

⁸⁴ Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 14.

⁸⁵ Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, Nenet 241, 242.

1. **Lidhur me ndryshimin e nenit 241 të Kodit të Familjes mendojmë se:**

Në propozimin për ndryshim të nenit 241, ku përcaktohen kushtet e birësimit, thuhet se: “Ka të drejtë për të birësuar personi që ka mbushur moshën 21 vjeç dhe ka zotësi të plotë për të vepruar.”

Këshilli Ndër fetar i Shqipërisë propozon rritjen e moshës së birësuesit. Në mbështetje të kërkesës sonë mund të shërbejë dhe Kodi Civil Italian, i cili parashikon që ka të drejtë të birësojë personi që ka mbushur moshën 35 vjeç dhe në raste të rralla 30 vjeç.

E nënvizojmë këtë kërkesë si të domosdoshme për përgjegjësinë, që do të marrë birësuesi dhe cilësitë (shkollimi, punësimi, të ardhurat nga punësimi etj.), që duhet të mbart për të rritur dhe edukuar një fëmijë të përgjegjshëm.

2. **Lidhur me ndryshimin e nenit 242 të Kodit të Familjes mendojmë se:**

Neni 242 aktualisht është:

I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë. Birësimi i ri lejohet pas vdekjes së birësuesit ose të birësuesve apo pas vdekjes së njërit prej birësuesve, në qoftë se kërkesa është paraqitur nga bashkëshorti i ri i birësuesit.

Neni 242 ndryshohet, si më poshtë vijon:

I mituri mund të birësohet nga një person i vetëm ose nga persona që janë bashkëshortë ose bashkëjetues sipas përcaktimeve të nenit 163, të këtij Kodi, që kanë bashkëjetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për të paktën 3 vjet.

Propozojmë të bëhet:

“I mituri mund të birësohet nga një person i vetëm ose nga persona që janë bashkëshortë ose bashkëjetues vetëm kur provohet se ai apo ata janë të lidhur në martesë apo bashkëjetesë sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 163 të këtij Kodi, dhe që kanë bashkëjetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për të paktën 3 vjet.”

Propozimi i mësipërm ka vlerë vetëm nëse nenet 7 dhe 163 të Kodit të Familjes mbeten të pandryshuar pra të jenë:

Neni 7

Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Neni 163

Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.

Këshilli Ndër fetar i Shqipërisë insiston për mos ndryshimin e konceptit të martesës dhe bashkëjetesës, duke u përcaktuar pjesëmarrësit në këto institute si Burrë dhe Grua nga lindja.⁸⁶

7. Marrëdhëniet e kujdestarisë

Megjithëse Kanonet e Kishës nuk shprehen në mënyrë të veçantë për një pengesë të tillë, Kisha vepron duke ndjekur edhe këtu ligjet e shtetit.⁸⁷ Marrëdhëniet e kujdestarisë sipas ligjeve në fuqi kanë karakter të përkohshëm dhe shtrihen deri në kohën që kujdestaria mbaron.⁸⁸ Sipas Ligjit në fuqi “Ndalohet martesa midis kujdestarit dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria”.⁸⁹

8. Kurorë shkelja (adulterium)

⁸⁶ Ngjallja, Nëntor 2021, fq. 1.

⁸⁷ Πάλλης Γ. – Ποτλής Μ, Σύνταγμα των θείων και Ιερών Κανόνων, vol. VI, fq. 139.

⁸⁸Shih: Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 306.

⁸⁹Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 13.

Është e ndaluar martesë midis dy personave që kanë rënë në mëkatën e tradhtisë bashkëshortore midis tyre.⁹⁰ Kisha bazuar në mësimin e Shkrimit të Shenjtë,⁹¹ që në shekujt e parë e ka konsideruar shkeljen e kurorës bashkëshortore si një krim edhe më të rëndë nga kurvëria.⁹² Është një mosrespektim i urdhërimit të Zotit i dhënë në Dhiatën e Vjetër e i përsëritur në Dhiatën e Re,⁹³ është mosrespektim i dinjitetit të personit dhe të familjes. Prandaj edhe Kanonet e shenjtë e dënojnë këtë mëkat duke parashikuar qortime të rënda kanonike dhe duke ndaluar martesën e cila vjen nga një marrëdhënie kurorëshkelëse.⁹⁴

9. Ekzistenca e një fejese të rregullt

Ekzistenca e një fejese të pazgjidhur ligjërisht në rastet e parashikuara në ndonjë legjislacion të ndonjë vendi përbën pengesë për fejesë apo martesë tjetër.⁹⁵

Shkrimi i Shenjtë i konsideron të fejuarit si burrë e grua. Në Dhiatën e vjetër Moisiu, vajzën e virgjër të fejuar e quan bashkëshorte, “gruan e të afërmit”.⁹⁶ Dhiata e Re nënën e Perëndisë, e cila ishte e fejuar me Josifin, e quan “gruan” e tij dhe Josifin, “burrin” e saj.⁹⁷

⁹⁰ Παναγιώτης Μπούμης, *Ο Κανονικός Γάμος*, Athinë 1992, fq.106.

⁹¹ Matheu. 5:27-28, 32. 19: 7-9; Marku. 10: 11-12; Llukai. 16:18; Romakëve. 7: 3.

⁹² Παναγιώτης Παναγιωτάκος, *Εγχειρίδιον περι των κωλυμάτων του γάμου*, Athinë 1959, fq. 134.

⁹³ Të Dalët. 20:14; Ligji i Përtërirë. 5: 18; Llukai. 18: 20.

⁹⁴ Kanonet e Apostujve. Kan. 48, 60; Ankira. Kan. 20; Neoqesaria. Kan. 8; Vasili i Madh. Kan. 9, 21, 26, 36, 37, 39, 48, 58, 77; Timotheu i Aleksandrisë. Kan. 15; Grigori i Nisës. kan. 4; Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. kan. 87.

⁹⁵ Kodi i Familjes në Shqipëri nuk e parashikon fejesën.

⁹⁶ Ligji i Përtërirë. 22: 23, 23.

⁹⁷ Matheu. 1: 18-20.

Fejesa në të Drejtën Romake ishte një premtim që bashkëshortët e ardhshëm i jepnin njëri-tjetrit. Këtë premtim Kisha e vendosi përpara Zotit duke i dhënë asaj bekimin e Tij.⁹⁸ Në kanonet e Shën Vasilit të Madh (†378) është e shprehur qartë se fejesa duhet të ruhet rreptësisht, dhe se ka karakter të detyrueshëm.⁹⁹ Perandori bizantin Aleks Komneni (1081-1118) ndaloi që fejesa dhe kurorëzimi të kryheshin njëherazi.¹⁰⁰ Koha midis fejesës dhe martesës nuk ishte e përcaktuar as nga shteti dhe as nga Kisha, por lihej në dorën e bashkëshortëve të ardhshëm. Më vonë, për të shmangur përplasjet me Kanonin e Sinodit Pesë-Gjashtë Ekumenik që thotë se: “ai që martohet me një grua të fejuar, ndërkohë që i fejuari i saj është gjallë, është përgjegjës për krimin e kurorë shkeljes”,¹⁰¹ filloi të praktikohet që bekimi i fejesës të kryhet bashkë me misterin e kurorëzimit.¹⁰² Meqenëse edhe në praktikën e sotme kishtarë shërbesa e fejesës i është bashkangjitur shërbesës së kurorëzimit, kjo pengesë tashmë praktikisht nuk merret në konsideratë.

10. Ekzistenca e një martese të pazgjidhur (të parë ose të dytë)

Ekzistenca e një martese të pazgjidhur përbën pengesë për një martesë të re.¹⁰³ Sinodi i Shenjtë dhe i Madh i Kretës vendosi se: “Për sa i përket martesës së zgjidhur në mënyrë jo të parevokueshme, ose asaj të anuluar, të një të trete para ekzistuese qëndron në fuqi fakti se përbëjnë pengesa absolute për lidhje martesore, sipas Traditës Kanonike ortodokse, e cila dënon në mënyrë kategorike bigaminë dhe martesën e katërt”.¹⁰⁴

⁹⁸ Ignat Hyymbajtësi, Letra drejtuar Polikarpit të Smirnës, 4:1-2; Tertuliani, De pudicita, 4: 1-5: Ad uxorem, 2:9.

⁹⁹ Shih.: Kanonin 69 të Vasilit të Madh si dhe interpretimin e Balsamonit, Πάλλης Γ. – Ποτλής Μ, Σύνταγμα των Θείων και Ιερών Κανόνων. Vol. IV, fq. 225.

¹⁰⁰ Aleks Komneni e ndaloi këtë nëpërmjet dy dekreteve të nxjerra në vitet 1084 dhe 1092, PG. 104, fq. 1180.

¹⁰¹ Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 98.

¹⁰² Shih: Νικόδημος Μίλας, Το Εκκλησιαστικόν Δίκαιον, Τύποις Σακελαρίου, Athinë 1906, fq. 837-840.

¹⁰³ Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 93.

¹⁰⁴ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, “II. Pengesat e martesës dhe zbatimi i ekonomisë”, 2.

Në Kishën ortodokse Autoqefale të Shqipërisë “Për zgjidhjen përfundimtare të martesës edhe shpirtërisht, kërkohet më parë paraqitja e vendimit të gjykatës civile, me anën e së cilës kryhet ndarja nëpërmjet zgjidhjes martesore. Shkresa përfundimtare e Autoritetit Kishtar nënshkruhet prej Kryepriut”.¹⁰⁵ Sipas Kodit Civil zgjidhja e martesës bëhet edhe për shkak të vdekjes së shpallur,¹⁰⁶ sepse ajo barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë.¹⁰⁷ Kisha ortodokse nuk e pranon martesën e katërt, ndërkohë që martesën e dytë e pranon duke ushtruar “Ekonominë kishtare” dhe martesën e tretë nëpërmjet ushtrimit ekstrem të “Ekonomisë kishtare”.¹⁰⁸

11. Martesa me heterodoksët

Martesa e një të krishteri me një heterodoks është kanonikisht e ndaluar, përveç rastit kur ai premtan se do të kalojë në Besimin Ortodoks. Kanoni 14 i Sinodit të Katërt Ekumenik (451 mp.K.) përcakton: *“Meqenëse në disa eparki, anagnostëve dhe psaltëve u është lejuar të martohen, sinodi i shenjtë vendosi që të mos u lejohet të marrin për grua një heretike. Të gjithë ata që kanë tashmë fëmijë nga një martesë e tillë, në qoftë se i kanë pagëzuar këta fëmijë tek heretikët, duhet që t’i sjellin në “kungim” me Kishën katolike. Në qoftë se nuk janë pagëzuar të mos i pagëzojnë tek heretikët, as t’i martojnë me një heretik, jude apo pagan nëse personi heretik që martohet me ortodoks nuk deklaron se do të kalojë në besimin ortodoks. Në qoftë se dikush shkel këtë kanon të sinodit të shenjtë, t’i nënshtrohet qortimeve kanonike”*.¹⁰⁹ Sinodi i Shenjtë dhe i Madh, në trajtimin e çështjes delikate të pengesave të martesës, bazuar në Saktësinë kanonike dhe Ekonominë kishtare, në perspektivën e përkujdesjes baritore Kishtare drejt shpëtimit të njeriut shprehet :

¹⁰⁵ Statuti i KOASH 2006, neni 68/2.

¹⁰⁶ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, Mars 2017, neni 22.

¹⁰⁷ Shih: Ligji Nr. 9062 dt. 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, neni 9.

¹⁰⁸ Παντελεήμονος Ροδόπουλος. *Κανονικό Δίκαιο*, Κυριακίδη, Selanik 1996, fq. 227.

¹⁰⁹ Shih: Laodikea. Kan. 10, 31; Kartagjena. Kan. 29; Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 72.

“Lidhur me martesat e përziera mes ortodoksëve dhe heterodoksëve dhe jo të krishterëve, u arrit në vendimin, sipas të cilit:

- a. Martesa mes ortodoksëve dhe heterodoksëve ndalohet sipas Saktësisë kanonike.¹¹⁰
- b. Mundësia e zbatimit të Ekonomisë kishtare në lidhje me pengesat e martesës duhet të trajtohet nga Sinodi i Shenjtë i çdo Kishe Autoqefale ortodokse sipas parimeve të Kanoneve të Shenjtë, me frymë dallimi baritor, me qëllim shpëtimin e njeriut”.¹¹¹

12. Koha e zisë kishtare

Në përputhje me Kanonin 52 të Sinodit të Laodikeas (380 mp.K.) që thotë se: “*Gjatë Kreshmëve të Mëdha nuk duhet të festohet martesa ...*”, sepse kjo periudhë konsiderohet nga Kisha jonë e shenjtë si periudhë trishtimi, zie dhe pendimi në të cilën duhet të intensifikojmë përpjekjen dhe luftën tonë shpirtërore dhe të përgatitemi për ngjarjen e madhe të Pashkës së shenjtë, Ngjalljen. Përveç periudhës të Kreshmëve të Mëdha kurorëzimet nuk kryhen edhe në periudhat e kreshmëve të tjera, megjithëse kjo nuk është vendosur me kanon nga Sinodet Ekumenike.¹¹² Përgjashtim bëhet vetëm për raste serioze të veçanta me lejen e episkopit të zonës.

PËRFUNDIME

Martesa midis burrit dhe gruas sipas të gjitha përkufizimeve serioze dhe të civilizuara është një lidhje e qëndrueshme dhe jo e përkohshme.

Në perspektivën e krishterë ortodokse ajo është një bashkim që kalon përmes bekimit të Perëndisë me anë të Misterit të Martesës brenda Kishës dhe që vazhdon për aq kohë sa ata janë në këtë jetë. Martesa është një bashkim i qëndrueshëm midis burrit dhe gruas në këtë jetë këtu mbi tokë që nuk shtrihet edhe në jetën tjetër të përtejme.

Mbrojtja e shenjtërisë së Misterit të Martesës ka qenë gjithmonë e një rëndësie të veçantë për mbrojtjen e Familjes në funksion të një shoqërie më të mirë.

¹¹⁰ Sinodi Pesë-Gjashtë Ekumenik. Kan. 72.

¹¹¹ Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë, “II. Pengesat e martesës dhe zbatimi i ekonomisë” 5.

¹¹² Παναγιώτης Μπούμης, *Κανονικόν Δίκαιον*, Athinë 2000, fq.135.

Martesa sipas mësimit të krishterë përbën gurin e qoshes për një shoqëri të përgjegjshme që ecën drejt perspektivës së Mbretërisë qiellore.

Në kohën tonë vërehet se ekziston një klimë e sëmurë në shoqërinë e gjërë që nuk e favorizon familjen e krishterë dhe promovon modele që minojnë vlerat e vërteta të familjes.

Kjo krizë sikurse thekson me forcë edhe Sinodi i Shenjtë dhe i Madh i Kishës ortodokse mbajtur së fundmi në Kretë 2016, kërkon angazhim serioz të Kishës për ta përballuar dhe kuruar atë. Sinodi e konsideron gjithashtu si një sfidë të madhe për misionin e Kishës në botën bashkëkohore duke i ftuar bijtë e saj dhe të gjithë njerëzit me dëshirë të mirë që t'i qëndrojnë besnik shenjtërisë së Familjes.

REFERENCA

- Dhiata e Re, <https://orthodoxalbania.org/2020/lexo-biblen/>
- Kërkim 14. (2016). Sinodi i Madh dhe i Shenjtë.
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare, Tiranë, Mars 2017.
- Kodi i Familjes, 2003.
- Mandro A., Meçaj V., E Drejta Familjare, Tiranë 2006.
- Ngjallja, Shkurt 2016, Nëntor 2021.
- Statuti i KOASH 2006.
- PG. (Patrologia Graeca), v. 62, 143.
- Milash N., Το Εκκλησιαστικόν Δίκαιον της Ορθοδόξου Ανατολικής Εκκλησίας, bot. Σακελαρίου, Athinë 1906.
- ΒΕΠΕΣ,. (Βιβλιοθήκη Ελλήνων Πατέρων και Εκκλησιαστικών Συγγραφέων), v. 2, 4, 5.
- Γ.Ράλλης-Μ.Ποτλής, Σύνταγμα των Θείων και Ιερών Κανόνων, v. 2, 5, 6, Athinë 1852-1859.
- Μπούμης Π., Ο Κανονικός Γάμος, Athinë 1992.
- Παναγιωτάκος Π., Εγχειρίδιον περι των κωλυμάτων του γάμου, Athinë 1959.
- Ροδόπουλος Π., Μαθήματα Κανονικού Δικαίου, Selanik 1980.

**VLERËSIMI I TIPAREVE LEKSIKORE TEK FËMIJËT SHQIP- DHE
GREQISHTFOLËS: TESTI MATËS I FJALORIT SI MJET VLERËSIMI GJUHËSOR**

Dr (proc.). Aida ZOTO

Departamenti i Gjuhës Greke, Fakulteti i gjuhëve të huaja ,

Universiteti i Tiranës

aida.zoto@unitir.edu.al

ABSTRAKT

Bilinguizmi, si një fenomen kompleks dhe shumëdimensional, ndikon në aspekte të shumta të sjelljes njerëzore, duke përfshirë afërsinë gjuhësore, funksionimin e trurit, sjelljen sociale, organizimin e shoqërisë dhe sistemet arsimore. Si një dukuri në rritje në nivel global, ai nuk studiohet vetëm në lidhje me individët bilingualë, por edhe në raport me sistemet gjuhësore të përfshira.

Një aspekt i rëndësishëm i bilinguizmit është zhvillimi i leksikut. Studimet tregojnë se fëmijët bilingualë mund të zotërojnë një fjalor ekuivalent ose edhe më të pasur krahasuar me fëmijët monolingualë, për shkak të ekspozimit të tyre ndaj dy ose më shumë gjuhëve. Por cilat janë tiparet kryesore të leksikut të fëmijëve bilingualë, dhe më konkretisht, si shfaqet ky fenomen tek fëmijët shqip-greqishtfolës?

Në këtë kuadër, u hartua Testi Matës i Fjalorit, si pjesë e projektit kërkimor mbi bilinguizmin "Thalis Project, Bilingual Acquisition & Bilingual Education: The Development of Linguistic & Cognitive Abilities in Different Types of Bilingualism" (I. Tsimpli). Ky test u përkthye dhe u

përshtat në gjuhën shqipe nga E. Kapia dhe u aplikua tek fëmijët me zhvillim normal kognitiv dhe fizik, me qëllim matjen dhe vlerësimin e aftësive të tyre leksikore.

Si një mjet vlerësimi gjuhësor i besueshëm, Testi Matës i Fjalorit ofron një metodë të saktë për të matur kompetencat leksikore të fëmijëve bilingualë të moshës 6-12 vjeç. Ky test shërben si një mjet i vlefshëm për studiuesit dhe profesionistët në fushën e gjuhësisë dhe edukimit, duke kontribuar në kuptimin e rrjedhës së zhvillimit gjuhësor dhe në identifikimin e mundshëm të patologjive gjuhësore.

Në përfundim të studimit, do të paraqiten dhe krahasohen rezultatet e matjeve gjuhësore midis fëmijëve bilingualë dhe monolingualë, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi ndikimin e bilinguizmit në zhvillimin e fjalorit.

Assessment of Lexical Features in Albanian- and Greek-speaking Children: The Word Finding Vocabulary Test as a Linguistic Assessment Tool

Abstract

Bilingualism, as a complex and multidimensional phenomenon, influences various aspects of human behavior, including linguistic proximity, brain function, social behavior, societal organization, and educational systems. As an increasingly prevalent phenomenon worldwide, it is studied not only in relation to bilingual individuals but also in the context of the linguistic systems involved.

One crucial aspect of bilingualism is vocabulary development. Research indicates that bilingual children may possess an equivalent or even richer vocabulary compared to monolingual children due to their exposure to two or more languages. However, what are the key characteristics of the lexicon of bilingual children, and more specifically, how does this phenomenon manifest in Albanian-Greek-speaking children?

Within this framework, the Word Finding Vocabulary Test was developed as part of the research project on bilingualism "Thalis Project, Bilingual Acquisition & Bilingual Education: The Development of Linguistic & Cognitive Abilities in Different Types of Bilingualism" (I. Tsimpli). This test was translated and adapted into Albanian by E. Kapia and was administered to children with normal cognitive and physical development to measure and assess their lexical abilities.

As a reliable linguistic assessment tool, the Word Finding Vocabulary Test provides an accurate method for evaluating the lexical competence of bilingual children aged 6 to 12 years. This test serves as a valuable resource for researchers and professionals in the fields of linguistics and education, contributing to the understanding of language development and the potential identification of linguistic pathologies.

At the conclusion of the study, the results of linguistic assessments between bilingual and monolingual children will be presented and compared, providing a clear overview of the impact of bilingualism on vocabulary development.

Bilinguizmi

Gjuha përbën mjetin themelor të komunikimit përmes të cilit individët që flasin të njëjtën gjuhë hyjnë në kontakt dhe shprehin mendimet e ndjenjat e tyre. Bilinguizmi, një fenomen në rritje në nivel global, përfshin situata ku një në tre persona është bilingual ose multilingual (Wei, 2000). Ky fenomen shfaqet kur individë ose komunitete me kode të ndryshme gjuhësore kërkojnë të ndërveprojnë, duke u mundësuar pjesëmarrësve shkëmbimin e mesazheve përmes një kodi të përbashkët komunikimi.

Për të kuptuar në mënyrë të plotë këtë dukuri, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh, si mosha e përvetësimit të gjuhës së dytë, kompetenca gjuhësore, zhvillimi kognitiv, mjedisi gjuhësor dhe socio-kulturor i folësit bilingual, perceptimi i gjuhëve nga komunitetet përkatëse (dominante/pakicë) dhe, së fundi, miratimi ose refuzimi i identiteteve kulturore të lidhura me gjuhën e folësit bilingual (Σελλά-Μάζη, 2001).

Në bazë të këtyre komponentëve, bilinguizmi mund të klasifikohet sipas kriterëve të ndryshme. Sipas mënyrës së përvetësimit të gjuhës së dytë, ai mund të jetë i njëkohshëm ose i vazhdueshëm, i hershëm ose i vonshëm, si dhe natyral ose kulturor (Τριάρχη - Hermann, 2000). Nga ana tjetër, bazuar në kriteret gjuhësore, ai mund të jetë i kombinuar ose i drejtuar, i koordinuar, sintetik apo i varur, ndërveprues ose i balancuar (Τριάρχη - Hermann, 2000). Gjithashtu, sipas kriterëve psiko-sociale dhe gjuhësore, ai mund të klasifikohet si aditiv ose subtraktiv, apo si semilingualizëm i dyfishtë (Τριάρχη - Hermann, 2000; Τριάρχη - Hermann, 2005; Cummins, 2005; Baker, 2001; Σκούρτου, 2011). Së fundmi, sipas kriterëve individuale dhe sociale, bilinguizmi mund të jetë

individual ose shoqëror, si dhe i elitës ose i shumicës (Τριάρχη - Hermann, 2000; Τριάρχη - Hermann, 2005; Σελλά-Μάζη, 2001; Δαμανάκης, 1998).

Nga sa më sipër, mund të konkludohet se nuk ekziston një përkufizim universal për bilinguizmin që të përfshijë të gjitha karakteristikat e tij dhe të ketë vlefshmëri të përgjithshme. Megjithatë, elementi i përbashkët që buron nga të gjitha përkufizimet është përvetësimi dhe përdorimi i më shumë se një gjuhe nga një individ.

Fëmija bilingual

Studimet sistematike mbi bilinguizmin e fëmijëve datojnë rreth një shekull më parë, duke filluar me kërkimin e Ronjat (1913) dhe më pas me studimin monumental të Leopold (1939-1949). Një nga çështjet kryesore që ka tërhequr vëmendjen e studiuesve lidhet me pyetjen nëse një fëmijë bilingual apo multilingual arrin të performojë në secilën prej gjuhëve të tij në të njëjtin nivel si një monolingual. Hoffmann (1991) argumenton se në fazat e hershme të zhvillimit gjuhësor, fëmija bilingual krijon një sistem gjuhësor universal ku ndërthuren elemente nga të dyja gjuhët, ndërsa me kalimin e kohës dhe përmirësimin e kompetencave gjuhësore, ai fillon t'i dallojë dhe t'i veçojë sistemet e ndryshme gjuhësore.

Studime të shumta mbi gamën e fjalorit të fëmijëve bilingualë dhe monolingualë tregojnë se fëmijët bilingualë kanë një prirje për të përdorur një larmi më të madhe fjalësh sesa bashkëmoshatarët e tyre monolingualë. Gjatë rrëfimit të tregimeve të tyre të preferuara, ata nuk ripërdorin fjalë stereotipe, por i zëvendësojnë me sinonime ose struktura të tjera të ndryshme gjuhësore. Kjo pasuri leksikore, e mbështetur në njohjen e dy sistemeve gjuhësore, u mundëson atyre të jenë më të lirë në shprehje dhe më origjinalë në interpretimin dhe përdorimin e fjalëve.

Megjithatë, një karakteristikë e zakonshme e fëmijëve bilingualë është se ata shpesh kanë një fjalor më të kufizuar në secilën prej gjuhëve të tyre, krahasuar me fëmijët monolingualë. Kjo mund të ndodhë si rezultat i ekspozimit të ndarë ndaj secilës gjuhë në situata të ndryshme komunikimi. Megjithatë, kur të dy fjalorët kombinohen dhe përkthimet ekuivalente llogariten si një tërësi (fjalor konceptual), atëherë fëmijët bilingualë mund të kenë një fjalor ekuivalent ose edhe më të pasur sesa monolingualët (Pearson, Fernandez & Oller, 1993).

Testi Matës i Fjalorit

Testi Matës i Fjalorit është rezultat i një përpjekjeje të gjatë për zhvillimin e mjeteve matëse që vlerësojnë zhvillimin gjuhësor të fëmijëve bilingualë. Ky test përfaqëson versionin shqip të Word Finding Vocabulary Test të Catherine Renfrew (botimi i IV), i cili u publikua për herë të parë në vitin 1968 në gjuhën angleze dhe është ribotuar disa herë që nga ajo kohë, me botimin më të fundit në vitin 1995. Pas përkthimit dhe përshtatjes për gjuhën shqipe, ky test u publikua nga Kapia (2013) nën emërtimin Testi Matës i Fjalorit.

Testi përbëhet nga 50 vizatime-fotografi bardhë e zi, të cilat paraqesin emra dhe janë përzgjedhur me kujdes për t'u klasifikuar sipas një shkalle vështirësie. Konceptet e përfshira burojnë nga objektet e përditshme, kategori të njohura të objekteve, përrallat e fëmijëve dhe programet televizive për fëmijë. Shumica e imazheve nuk kanë përgjigje alternative, gjë që e bën të mundur matjen e shpejtë dhe të saktë të përgjigjeve të fëmijëve.

Zgjedhja e këtij testi është e justifikuar për disa arsye kryesore. Së pari, nuk ekziston një test ekuivalent në gjuhën shqipe, duke e bërë këtë mjet një burim të vlefshëm për vlerësimin e fjalorit ekspresiv të fëmijëve. Së dyti, testi është i lehtë për t'u administruar dhe siguron rezultate të sakta brenda një kohe të shkurtër. Së treti, rezultatet e tij mund të ndihmojnë specialistët të përcaktojnë moshën zhvillimore të fjalorit shprehës të individit të testuar.

Për më tepër, Testi Matës i Fjalorit përfaqëson një ekuivalent moshe për fjalorin ekspresiv dhe, nëse përdoret në kombinim me mjete të tjera vlerësimi, mund të ndihmojë në identifikimin e vonësive në zhvillimin e fjalorit ose të vështirësive specifike në gjetjen e fjalëve. Ky test shërben si një mjet i vlefshëm për studiuesit dhe profesionistët që merren me vlerësimin e zhvillimit gjuhësor të fëmijëve bilingualë dhe monolingualë.

STUDIMI

Qëllimi: Ky studim kërkimor ka si qëllim vlerësimin dhe analizën sasiore e cilësore të tipareve leksikore të fëmijëve bilingualë (shqip dhe greqishtfolës) të moshave 6-12 vjeç. Fokus kryesor i tij është kuptimi dhe emërtimi i objekteve dhe koncepteve të realitetit shqiptar, me qëllim përcaktimin e nivelit të fjalorit shprehës në këtë grupmoshë dhe në kategori të ndryshme të fëmijëve bilingualë.

Koha dhe ambientet: Eksperimenti u realizua gjatë periudhës dhjetor 2013 – janar 2014, në ambientet e Kolegjit Greko-Shqiptar "Arsakeio e Tiranës" në Shqipëri. Testimi u zhvillua gjatë orëve të mëngjesit, pasi në këtë kohë nxënësit ishin më të qetë dhe më të përqendruar, duke krijuar kushtet optimale për matjen e fjalorit të tyre shprehës.

Subjektet: Në këtë eksperiment morën pjesë gjithsej 55 fëmijë, përkatësisht 23 djem dhe 32 vajza, të moshave 6-12 vjeç. Përzgjedhja e subjekteve u bë në mënyrë të rastësishme, me kushtin që fëmijët të kishin zhvillim normal mendor dhe fizik dhe të ishin të ekspozuar ndaj gjuhës shqipe dhe greke në mënyrë paralele, duke përmbushur kështu kriterin e bilinguizmit.

Fëmijët e përfshirë në studim i përkisnin tri kategorive kryesore:

- a) Fëmijë që janë pjesë e minoritetit grek në Shqipëri
- b) Fëmijë nga familje shqiptare bilinguale
- c) Fëmijë nga familje monolinguale, të cilët kanë mësuar gjuhën e dytë përmes shkollimit në këtë kolegji

Ky studim synon të japë një pasqyrë të detajuar mbi zhvillimin e fjalorit tek fëmijët bilingualë dhe të vlerësojë ndikimin e ekspozimit ndaj dy gjuhëve në aftësitë e tyre shprehëse.

PËRFUNDIME

Bazuar në studimin e mësipërm, rezulton se fëmijët bilingualë, në përgjithësi, kanë arritur të dallojnë dhe të emërtojnë saktë shumicën e imazheve të paraqitura në test. Megjithatë, pas imazhit të 35-të, disa fëmijë, veçanërisht ata të sapo riatdhesuar, hasën vështirësi në emërtimin e saktë të objekteve. Në disa raste, ata nuk arritën të konceptonin saktë imazhin, duke e ngatërruar me një objekt tjetër, duke e përshkruar përmes një fraze ose fjalie, apo duke e emërtuar atë në gjuhën greke.

Gabimet e regjistruara gjatë testimit mund të klasifikohen në disa kategori kryesore:

- Gabime verbale ose totale – zëvendësim i fjalës së kërkuar me një tjetër pa lidhje semantike, p.sh. "domino" me "frigorifer".
- Gabime semantike – zëvendësim i fjalës së kërkuar me një fjalë tjetër të së njëjtës klase semantike, p.sh. "pirun" me "lugë".
- Gabime fonematike ose neologjizma – krijimi i fjalëve të reja përmes shtimit, heqjes ose shkëmbimit të fonemave, p.sh. "filxhan" me "flixhan" (Sarno, 1991).

- Përdorimi i fjalëve të pacaktuara – përdorimi i fjalëve jo-specifike për të emërtuar një objekt, p.sh. "filxhan" me "gjë".
- Krijimi i fjalëve të reja – formimi i termave të rinj për të përshkruar objektin, p.sh. "shtëpi" me "shtëpi dy katëshe" (Martin, 1997).
- Zgjerimi i koncepteve – përdorimi i një termi më të përgjithshëm për një koncept të kufizuar, p.sh. "patkoi" me "mjete kali" (Sarno, 1991; Martin, 1997).
- Zvogëlimi i koncepteve – përdorimi i një termi më të kufizuar për të përfaqësuar një koncept më të gjerë, p.sh. "bizhuteri" me "varëse" (Sarno, 1991; Martin, 1997).

Përveç këtyre llojeve të gabimeve, u vu re gjithashtu ndërhyrja e gjuhës greke në procesin e emërtimit, ku disa fëmijë përdorën termat greqisht në vend të termave shqip. Për shembull, në vend të fjalës shqipe "kaçavidë", disa fëmijë përdorën fjalën "κατσαβίδι" (kacavidha) nga greqishtja, ndërsa në vend të "kangur", u përdor fjala "κavγούπο" (kanguro).

Këto gjetje tregojnë se fëmijët bilingualë kanë një repertor më të gjerë konceptual dhe leksikor, por gjithashtu shfaqin ndikimin e gjuhës së dytë në përvetësimin dhe përdorimin e fjalorit të tyre në gjuhën shqipe.

Performanca leksikore midis fëmijëve bilingualë dhe monolingualë

Ky seksion paraqet krahasimin e përgjigjeve të 50 imazheve të shfaqura në Testin Matës të Fjalorit, duke analizuar performancën e fëmijëve bilingualë dhe monolingualë. Krahasimi bazohet në të dhënat e përftuara nga ky studim për bilingualët dhe në rezultatet përkatëse të fëmijëve monolingualë¹¹³.

